



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit /
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of
Education, Science, Technology and Innovation*

**KATALOGU I PROGRAMEVE TË APROVUARA PËR
ZHVILLIM PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE DHE
PUNONJËSVE ARSIMOR**

EDICIONI I SHTATË



Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

**KATALOGU I PROGRAMEVE TË APROVUARA PËR ZHVILLIM PROFESIONAL TË
MËSIMDHËNËSVE DHE PUNONJËSVE ARSIMOR**

EDICIONI I SHTATË

Prishtinë, 2024

KATALOGU I PROGRAMEVE TË APROVUARA PËR ZHVILLIM
PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE DHE PUNONJËSVE

Botues:

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)

Përgatitur nga:

Osman Beka

Enver Mekolli

Katalogu i programeve të aprovuara nga MASHTI-i për zhvillim profesional të mësimit dhe punonjësve arsimor është në dispozicion për shkarkim në uebfaqe të MASHTI-it:

<http://www.masht-gov.net>

Nr	Titujt e programeve të aprovuara të katalogut të edicionit të shtatë 2024 për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve dhe Punonjësve Arsimit	Organizata	Faqe
1	Administrim, Menaxhim dhe Udhëheqje në Arsim	QAPA	10
2	Arsimi gjithëpërshirës, vlerësimi sipas klasifikimit ndërkombëtar të klasifikimit KNF dhe Plani Individual i Arsimit	Këshilli i Evropës	19
3	Aftësimi për profesionistët e arsimit në mbështetjen e procesit të mësimit të shkrim leximit për nxënësit e shurdhër dhe me dëmtime në dëgjim	Këshilli i Evropës	26
4	Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie	SBASHK	31
5	Bashkëpunimi cilësor edukator - prind në institucione edukative	Instituti Pedagogjik i Kosovës	36
6	Bibloteka digjitale e mësimdhënësit	DokuFest	38
7	CARE International në partneritet me Qendra për Këshillim, Shërbime, Sociale dhe Hulumtime –	SIT Y (Rinia)	41
8	Cultivating critical thinking skills through English Shoqata Kosovare e	Mësimdhënësve të Gjuhës Angleze- KETNET	45
9	Edukimi i fëmijëve me dëmtime në të parë në arsimin parashkollor	Shoqata e të Verbërve të Kosovës	48
10	Edukimi medial	KEC	51
11	Edukimi seksual dhe shëndeti riprodhues	Kosova Population Foundation	54
12	Edukimi Teator	Mute Fondation	61
13	Edukimi matematik përmes një veprimtarie komplekse të zgjidhjes së problemeve - Fusha "Matematikë	Albas	65
14	Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social	SBASHK	69
15	Gjithë përfshirja Edukimi dygjuhës i te shurdhërve, Bilingualizmi	Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim "Nene Tereza" Prizren	72
16	Gjithëpërfshirja në edukimin fizik, lojërat dhe sportet për nxënës me aftësi të kufizuara	Komiteti Paralimpik i Kosovës (KPK)	75
17	Gjithëpërfshirja në sistemin arsimor në Kosovë, integrimi i fëmijëve të verbër	"Qendra Burimore për mësim dhe këshillim "Xheladin Deda"	78
18	Gjithëpërfshirja dhe Individualizimi i mësimit për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore – PIA	Eko - Protection	80
19	Identifikimi i problemeve shëndetësore të fëmijëve në kopsht dhe në shkollë	Qeht "Konica"	83

20	Kontekstualizimi i Qasjes Reggio Emilia në Kosovë. Perspektiva dhe dialogu	Instituti Për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA) – Fakulteti I Edukimit – UP	85
21	Krijimi i Komunitetit të të nxëniet demokratik dhe gjithëpërfshirës	Këshilli i Evropës	89
22	Krijimi, zbatimi dhe monitorimi isuksesshëm i PIA-së për të përmirësuar mësimnxënien e nxënësve me nevoja	QPGJ – OJQ	92
23	Integrimi i edukimit për qëndrueshmëri në klasa	Instituti Për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA) – Fakulteti I Edukimit – UP	96
24	Intervenimi i hershëm te fëmijët e verbër dhe me dëmtime pamore	” Qendra Burimore për mësim dhe këshillim “Xheladin Deda”	99
25	Komunikimi jo i dhunshëm	KEC	101
26	Lions Quest - Shprehitë për adoloshencën	Lions International-Lions Club Peja	104
27	Menaxhimi i klasës dhe disiplina	Qeht “Konica”	107
28	Mësimi i shkrimit braj	Qendra Burimore për mësim dhe këshillim “Xheladin Deda”	109
29	Metodologji interaktive e mësimdhënies moderne	Qeht “Konica”	112
30	Maximising Learning through Project-Based Learning -	Shoqata Kosovare e Mësimdhënësve të Gjuhës Angleze KETNET	114
31	Mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi	KEC	116
32	Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet edukimit, artit dhe medias - scream	KEC	119
33	Menaxhimi i sjelljeve dhe gjithëpërfshirja	Albas	123
34	Mësimdhënia dhe të nxëniet e shkencave natyrore në klasat 1-5	Instituti Për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA) – Fakulteti I	126

		Edukimit – UP	
35	Mësimdhënia e Gjuhës shqipe dhe letërsisë në kurrikulën me kompetenca, gërshetimi me teknologjinë.	Albas	128
36	Mësimdhënia Online në Nivelin e Duhur Kosova	Center for Digital Education (KCDE) - Mëso Online	130
37	Metodologjia Montessori për edukimin në fëmijërinë e hershme (mosha 0-6 vjeç)	Instituti Për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA) – Fakulteti I Edukimit – UP	133
38	Mësimdhënia cilësore në edukim dhe arsim gjithëpërfshirës	QBMK “Përparimi” Prishtinë	135
39	Mësimdhënia dhe nxënia e integruar	IHPKO	139
40	Ndihmë psiko-edukative nxënësve me sjellje të papërshtatshme	Eko - Protection	145
41	Ngritja e Kapaciteteve në Udhëheqjen Arsimore	Instituti Për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA) – Fakulteti I Edukimit – UP	149
42	Ngritja e kapaciteteve për rishikim dhe përmirësim të teksteve shkollore	EU KosED	152
43	Ofrimi i mbështetjes për mësimdhënësit e arsimit fillor për përmirësimin e aftësive të nxënësve në shkrim-lexim	Instituti Pedagogjik i Kosovës	156
44	Parimet dhe puna profesionale përmes ABA me nxënësit me spektrin e AUTIZMIT: Metodot dhe strategjitë e avancuara për zhvillimin funksional të nxënësve me nevoja të veçanta	QPGJ – OJQ	160
45	Planifikimi i mësimdhënies produktive	Qeht "Konica"	164
46	Plani individual i arsimit	Qendra Burimore për mësim dhe këshillim “Xheladin Deda”	166
47	PLAYDAGOGY- Diskriminimi në bazë të gjinisë	Play International Kosova	168
48	PLAYDAGOGY- Diskriminimi në bazë të komunitetit	Play International Kosova	171
49	Praktika pedagogjike e bazuar në dëshmi	EU KosED	174

50	Promovimi i qytetarisë globale dhe përgjegjësisë shoqërore përmes mësimdhënies së gjuhës angleze	Shoqata Kosovare e Mësimdhënësve të Gjuhës Angleze- KETNET	177
51	Puna dhe përkrahja profesionale për fëmijët me VËSHTIRËSI NË TË NXËNË: Metodrat dhe strategjitë e avancuara për zhvillim funksional të nxënësve me nevoja të veçanta	QPGJ – OJQ	179
52	Përdorimi dhe përshtatja e teknologjisë informative për të verbër	Qendra Burimore për mësim dhe këshillim “Xheladin Deda”	183
53	Përdorimi i TIK në edukim	Albas	185
54	Përgatitja dhe përdorimi i materialeve mësimore	Instituti Pedagogjik i Kosovës	188
55	PIA- Planifikimi sipas nevojave të nxënësit (nxënës me nevoja të veçanta). Hartimi i planit individual i Arsimit	Edumen-K	191
56	Përgatitja e Edukatorëve për Përkrahjen dhe Zhvillimin e Potencialit të Fëmijëve përmes Lojës dhe Kreativitetit	Instituti Pedagogjik i Kosovës	194
57	PIA për nxënësit me dëmtim dëgjimi	Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nene Tereza” Prizren	196
58	Qasja dhe Mësimdhënia e Diferencuar	Edunen-K	199
59	Realizimi i kompetencave kyçe dhe ato të fushave të Arsimit Fillor, nëpërmjet rikonceptimit të procesit mësimor me në qendër nxënësin	Albas	202
60	Rinia në punë	Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)	205
61	Sistemet e Menaxhimit të Mësimit (SMM)	GIZ	208
62	Shkolla për të gjithë -II- Gjithë përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe të folur	“ Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim” Nene Tereza” Prizren	210
63	Të gatshëm për të mësuar	Save the Children Kosova	213
64	Të mësuarit përmes teknologjisë – përdorimi i programeve aplikative	Qeht “Konica”	216
65	Trajnimi i mësimdhënësve për edukim në karrierë	GIZ	218

66	Trajnimi i mësimitdhënësve për kompetencë digjitale	GIZ	220
67	Trajnimi i Avancuar "Shkolla për të gjithë – I - (Gjithë përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe te folur	" Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim" Nene Tereza" Prizren	223
68	Teaching 21st Century Skills in the English Classroom	Shoqata Kosovare e Mësimitdhënësve të Gjuhës Angleze- KETNET	227
69	Trajnimi për orientim dhe mobilitet	Qendra Burimore për mësim dhe këshillim "Xheladin Deda"	230
70	Trajnim për Mësimdhënës në Arsim Gjithëpërfshirës	OJQ Autizmi Flet	232
71	Udhëheqja e Institucioneve Arsimore në Kosovë (UIAK)	Kosovo Center for International Cooperation (KCIC)	238
72	Vështirësitë në të nxënë - përkufizimi, identifikimi dhe përkrahja arsimore	Eko – Protection	242
73	Vlerësimi përmblendhës i nxënësve: Hartimi i testit	Instituti Për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA) – Fakulteti I Edukimit – UP	245
74	Vlerësimi i nxënësve sipas kurrikulës bazuar në kompetenca	Qeht "Konica"	248
75	Vlerësimi nga kolegët	EU KosED	250
76	Zhvillimi i të menduarit kritik dhe kreativ tek nxënësit në arsimin fillor	Edumen -K	253

HYRJE

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), në përputhje me UA 12/2023, për kriteret dhe procedurat e aprovimit të programeve për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe punonjësve arsimor, ka aprovuar ofertuesit dhe programet për zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Bazuar në të dhënat në dispozicion të MASHTI, përkatësisht Divizionit për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve dhe Këshillit Shtetëror të Licencimit të Mësimdhënësve (KSHLM), është përgatitur botimi i katalogut të programeve trajnuese.

Në këtë katalog janë përfshirë ofertuesit e aprovuar dhe programet e aprovuara në vitin 2024.

Katalogu ofron një përshkrim të përgjithshëm të ofertuesve të programeve trajnuese duke përfshirë kontaktin dhe adresën e tyre. Ndërsa, programet trajnuese të secilit ofertues janë përshkruar në mënyrë më specifike, sipas formularit të caktuar nga MASHTI dhe të plotësuar nga ofertuesit e programit, disa prej ofertuesve nuk i kanë dërguar të dhënat e plotësuara në formularin e përgatitur nga kryetari i KSHLM, për ofertuesit të cilët nuk i kanë dërguar të dhënat të kërkuara me kohë për disa herë duke kontaktuar edhe me telefon, kësaj radhe në shtojcën e katalogut do të publikohen vetë vendimet me vretje që herave tjera të dhënat e kërkuara të dërgohen me kohë për tu publikuar në katalogun i cili do të përgatitet nga MASHTI, dhe sipas UA. 12/2023 Katalogu më nuk do të shtypet në kopje fizike por Katalogu do tu dërgohet DKA-ve në formë elektronike pasi të publikohet në faqe të MASHTI-t, DKA-t kanë obligim të përcjellin katalogun në formë elektronike në çdo shkollë të Republikës së Kosovës për tu informuar mësimdhënësit se cilat programe janë të aprovuara nga MASHTI. *Përshkrimi i programeve përmban: tipin e programit, ofertuesin, kohëzgjatjen, përfituesit, rezultatet e pritura, përmbajtjen, metodologjinë dhe procesin e certifikimit, numrin e trajnerëve dhe datën e aplikimit.* Të gjitha këto informacione janë të rëndësishme sepse me rastin e licencimit, rilicencimit apo avancimit në karrierë mësimdhënësit duhet të ofrojnë dëshmi për përfundimin me sukses të programeve themelore dhe atyre plotësuese për zhvillim profesional.

Kërkesat dhe kriteret për përfundimin me sukses të trajnimeve në programe bazike apo plotësuese janë përcaktuar me UA- 12/2023 për sistemin e licencimit dhe zhvillimin në karrierë të mësimdhënësve. Përmbajtja e programeve të trajnimit do të ndihmojë mësimdhënësit të identifikojnë programet, vijueshmëria e të cilave do të ndihmojë ata/o të avancohen gjatë karrieres dhe të arrijnë standardet e mësimdhënies të përcaktuara me *Kornizën strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë, 2017.*

Përfundimi me suksese i programeve themelore dhe plotësuese do të ndikojë në rritjen e nivelit të performancës së mësimdhënësve.

Titulli i Programit:	Administrim, Menaxhim dhe Udhëheqje në Arsim
Titulli i organizatës:	Qendra për Avancimin e Performancës së Arsimit
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	Qendra për Avancimin e Performancës së Arsimit
Adresa:	Cagllavice- Prishtinë- Ferizaj km i 5-të, 10000
E-mail:	qapa.rks@gmail.com
Telefoni:	048-750-751
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr. 78/2024 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	Nr. 78/2024 26.02.2025
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr. 78/2024 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr. 78/2024 26.02.2025
Kohëzgjatja e programit(orë)	150 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e karrierës, Mësimdhënësit mentor, mësimdhënësit e merituar, Drejtorët e institucioneve arsimore

Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25-30
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Të gjithë pjesëmarrësit në trajnimin të aftësohen për administrim, menaxhim dhe udhëheqje të shekullit XXI, në mënyrë që institucionet edukative dhe arsimore të arsimit para-universitar të Kosovës, t'i shndërrojnë në ORGANIZATA TË FUQISHME TË NXËNIT, TË PRODHIMIT TË DIJEVE TË REJA, JO TË DHUNSHME E HUMANE DHE EKO – INSTITUCIONE/ INSTITUCIONE EKOLOGJIKE ME PERFORMANCË TË LARTË</p> <p><u>MODULI-I: HYRJE NË SHKENCAT E ADMINISTRIMIT, MENAXHIMIT & TË UDHËHEQJES</u></p> <p>Pas përfundimit të këtij moduli të trajnimit pjesëmarrësit e trajnimit do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të demonstrojnë dije, aftësi, shprehje, vlera dhe kompetenca për shkencat e administrimit, menaxhimit, dhe udhëheqjes në shekullin XXI; • Të bëjnë dallimet ndërmjet administrimit, menaxhimit dhe të udhëheqjes; • Të përshkruajnë profilin e drejtorit të shekullit XXI; • Të bëjnë dallimet ndërmjet shkollave tradicionale dhe të shkollave të shekullit XXI • Të përshkruajnë tipat e shkollave tradicionale dhe të shkollave të shekullit XXI • Të përkufizojnë kulturën shkollore dhe klimën shkollore, si dhe të bëjnë dallimet ndërmjet tyre • Të dallojnë tipat e ndryshme të kulturave shkollore. • Të përshkruajnë strukturën kibernetike të sistemit edukativ arsimor në mënyrë që të jenë në gjendje të avancojnë inputet/kushtet; procesimin/ zhvillimin; outputet/ rezultatet; informacionin kthyes/feedback-un dhe impaktin/ ndikimin e edukimit dhe të arsimit në zhvillimin e individit dhe të shoqërisë; • Të përshkruajnë itinerarin e shndërrimit të shkollave tradicionale në shkolla dhe institucione të shekullit XXI, • Të identifikojnë tipat e ndryshëm të drejtorëve të arsimit para-universitar • Të përshkruajnë karakteristikat e udhëheqësit të suksesshëm <p><u>MODULI-II: MENAXHMENTI NË EDUKIM DHE ARSIM</u></p>

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë gjendje:

- Të përshkruajnë arsyet, pse është paraqitur nevoja për menaxhment në fushën e edukimit dhe të arsimit;
- Të përshkruajnë natyrën dhe detyrat e menaxhmentit;
- Të përshkruajnë menaxhmentin shkollor;
- Të përshkruajnë hierarkinë dhe aftësitë e menaxherëve sipas niveleve të menaxhimit
- Të përshkruajnë funksionet e menaxhimit;
- Të demonstrojnë dije të thella për deontologjinë, etikën dhe moralin e menaxherëve;
- Të shpjegojnë rolin dhe rëndësinë e inteligjencës etike të menaxherëve në edukim dhe arsim;
- T'i përshkruajnë tipat e menaxherëve sipas moralit;
- T'i përshkruaj parimet etike me të cilat duhet të udhëhiqet menaxheri në arsim
- T'i përshkruajnë faktorët që ndikojnë nxitjen e moralit institucional
- Të përshkruajnë rolet menaxheriale të drejtorëve me profil të shekullit XXI
- Të dallojnë menaxhimin nga administrimi

MODULI- III: UDHËHEQJA, DREJTORI ME PROFIL TË SHEKULLIT XXI, MENAXHON ME HEMISFERËN E MAJTË TË TRURIT DHE UDHËHEQË ME HEMISFERËN DJATHTË TË TIJ

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë gjendje:

- Të përshkruajnë sfidat e udhëheqjes;
- T'i caktojnë dhe t'i përshkruajnë nivelet udhëheqjes;
- Të bëjnë dallimin ndërmjet administrimit dhe të udhëheqjes;
- Të bëjnë dallimin ndërmjet menaxhimit dhe të udhëheqjes;
- Të përshkruajnë stilet e udhëheqjes,
- Të përshkruajnë modelet e udhëheqjes,
- Të demonstrojnë aftësi për përdorimin e pesë metodave të udhëheqjes me

theks të veçant të metodave: transformues, ekipore dhe autentike.

MODULI-IV: PLANIFIKIMI. TË DËSHTOSSH NË PLANIFIKIM DO TË THOTË TË PLANIFIKOSH DËSHTIMIN

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë gjendje:

- Të demonstrojnë aftësi në përkufizimin e konceptit të planifikimit dhe të llojeve të planeve e të planifikimeve;
- Të tregojnë aftësi për përdorimin e Ligjit të Paretos;
- Të demonstrojnë aftësi për menaxhimin e kohës sipas Ligjit të Paretos;
- Të përshkruajnë katër etapat e menaxhimit të kohës;
- Të demonstrojnë aftësi për përdorimin e 7 zakoneve të njerëzve të suksesshëm;
- Të demonstrojnë aftësi për përdorimin e planifikimit strategjik;
- Të argumentojnë pse drejtori pa vizion nuk është drejtor me profil të shekullit XXI;
- Të demonstrojnë aftësi për formulimin e misionit, objektivave zhvillimore, masave , aktiviteteve dhe të rezultateve;
- Të tregojnë aftësi për përdorimin e Sinergjisë Humane Ndërkombëtare;
- Të përshkruajnë tipat e drejtorëve sipas studiuesve dhe të etapave të zhvillimit të institucionit;
- Të përshkruajnë detyrat e drejtorit të shekullit XXI
- Të përshkruajnë standardet që duhet t'i plotësojnë drejtorit e shekullit XXI
- Të demonstrojnë aftësi për hartimin e planeve strategjike, zhvillimore , vjetore, kuartale, dhe ditore

MODULI-V: MENAXHIMI I NDRYSHIMEVE NË EDUKIM DHE ARSIM-DREJTORI I SHEKULLIT XXI KAMPION I NDRYSHIMEVE

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë gjendje:

- Të argumentojnë pse drejtori i shekullit XXI, duhet të jetë kampion i ndryshimeve në edukim dhe arsim;
- Të argumentojnë pse drejtori i shekullit XXI gjatë gjithë kohës duhet të jetë i hapur ndaj ideve të t reja;
- Të përshkruajnë pengesa dhe rezistencat e njerëzve ndaj ndryshimit si dhe mënyrat e tejkalimit të tyre
- Të përshkruajnë dhe të definojnë tipat e ndryshimeve si dhe tipat e njerëzve

sipas mënyrave të reagimit ndaj ndryshimeve

- Të demonstrojnë aftësi për krijimin e rrethanave për zbatimin optimal të ndryshimeve,
- Të demonstrojnë aftësi në përcaktimin e qëllimit moral të ndryshimeve,
- Të jenë në gjendje të përshkruaj etapat e zbatimit të ndryshimeve,
- Të përshkruajnë katër tipat e modeleve bashkëkohore të zbatimit të ndryshimeve në edukim dhe arsim.

MODULI-VI: TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE E KOMUNIKIMIT NË EDUKIM DHE ARSIM- DETYRË MADHORE E DREJTORIT TË SHEKULLIT XXI

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë gjendje:

- Të përshkruajnë konceptin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në edukim dhe në arsim
- Të përshkruajnë format e përdorimit të kompjuterëve në mësimdhënie, dhe në të nxënë

MODULI-VII: NJERËZIT, VLERA MË E RËNDËSISHME E DREJTORIT ME PROFIL TË SHEKULLIT XXI

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë gjendje:

- Të argumentojnë pse drejtori i shekullit XXI duhet të jetë “nxënës” i përjetshëm;
- Të demonstrojnë aftësi për të shpjeguar konceptin dhe natyrën e zhvillimit profesional të personelit mësimor edukativ;
- Të demonstrojnë aftësi në zhvillimin profesional të personelit mësimor edukativ,
- T’i përshkruajnë parimet e zhvillimit profesional,
- Të argumentojnë pse drejtori me profil të shekullit XXI duhet të jetë i jashtëzakonshëm.

MODULI-VIII: ORGANIZIMI SHKENCOR I PUNËS EDUKATIVE DHE ARSIMORE- DETYRË E DREJTORIT TË SHEKULLIT XXI

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë gjendje:

- Të përshkruajnë llojet, hierarkinë dhe sistemin e organizimit shkencor të punës në institucione edukative – arsimor,
- Të përshkruajnë pesë modelet e Organizimit Shkencor të Punës,

	<ul style="list-style-type: none"> • Të argumentojnë pse edukimi dhe arsimit duhet të jenë prioritet zhvillimor i shoqërisë, • Të përshkruajnë itinerarin e lëvizjes nëpër pesë blloqet kryesore të shoqërisë me qëllim të zhvillimit të saj. • Të argumentojnë pse edukimi në fëmijërinë e herëshme dhe gjithpërfshirja janë faktorë kyç i avancimit të cilësisë së edukimit dhe të arsimit në Kosovë. <p>MODULI-IX: KOMUNIKIMI DHE VERBOZITETI VEGLA TË RËNDËSISHME TË DREJTORIT TË SHEKULLIT XXI</p> <p>Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të argumentojnë konceptin dhe rëndësinë e komunikimit; • Të emërtojnë dhe të dallojnë elementet dhe llojet e komunikimit; • Të demonstrojnë aftësi për interpretimin dhe shpjegimin e kulturës dhe të llojeve të dëgjimit; • Të përshkruajnë aftësitë e komunikimit; <p>Të demonstrojnë aftësi në zgjidhjen e konflikteve.</p>
<p>Përmbajtja:</p>	<p>Konceptet themelore, çfarë duhet të jetë një udheheqës dhe si të bëheni udheheqës I suksesshem, pse udheheqësi duhet të ketë ndikim, si krijohet ndikimi, etapat e menaxhimit, udheheqjes dhe të administrimit: puna me prioritete – çelës I suksesit, pse menaxheri, udheheqësi dhe administrator duhet të jenë të ndryshëm, ndryshimet positive attribute të domosdoshme të menaxhimit, udheheqjes dhe të administrimit: stilet e udheheqjes: cili është roli I “ GRUSHTIT DREJTUES”: cilat janë fazat e zhvillimit të institucioneve para – universitare, cilat janë tiparet e udheheqësve sipas fazave të zhvillimit të institucionit.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Planifikimi në arsim: Konceptet, llojet, metodat; Metodatat e planifikimit rrjetor, Metodatat e Kornizes Logjike, Metodologjia e planifikimit me skenar 2. Efikasiteti dhe efektiviteti I institucioneve arsimore; Koncepti I efikasitetit, resurset njerezore, koncepti I efektivitetit- cilesise në arsim, kapitali njerëzor, kapitali I dijeve, karakteristikat e shkollës efektive, vlerësimi në arsim, kultura dhe klima shkollore 3. Menaxhimi I ndryshimeve në arsim : Koncepti I ndryshimit, ç’ mund të jetë object ndryshimi, cili mund të jenë agentët e ndryshimit, cilat janë karakteristikat e njerëzve që sjellin ndryshim, si mund të realizohet

- ndryshimi, fazat dhe stadet e ndryshimit.
4. Shkolla dhe komuniteti: Shkolla dhe komuniteti dy sistemi të ndërlikuara: shkolla dhe komuniteti nga këndi I Teorisë së Përgjithshme të sistemeve, ç'ndihmë ka shkolla nga idetë dhe energjia e jashtme, krijimi I Rrjetit të Merimanges së partneritetit, nevoja për partneritet dhe partnerët e mundshëm, planifikimi I partneritetit.
 5. Cilat janë detyrat e drejtorit të shkollës së shekullit XXI:
Planifikimi, puna analitike studiuuese – PAS, Puna instructive- pedagogjike – PIP (me mësimdhënës, nxënë dhe prindër) : Puna këshilldhënëse e drejtorit – PKD (me mësimdhënës, nxënës, prindër dhe bashkëpunëtorë professional) Puna në inovimin dhe avancimin e performancës së shkollës – PIAP, Bashkëpunimi e komunitetin arsimor- BKA: Avancimi professional dhe fuqizimi I stafit shkollor- APSSh: Monitorimi, mbikqyrja, vlerësimi dhe vlerësim I performancës së shkollës dhe të arritjeve të nxënësve – MMVVPSH, Mbajtja, klasifikimi, kategorizimi dhe arkivimi I dokumentacionit pedagogjik dhe shkollor – INDOK – SISTEMI
 6. Tiparet dhe veçoritë e drejtorit të suksesshëm; Veçoritë fizike dhe shëndetësore; veçoritë dhe tiparet mentale; veçorite dhe tiparet emocionale: Veçoritë dhe tiparet konative: Veçoritë dhe tiparet sociale punues.
 7. Metodologjitë dhe strategjitë e mësimdhënies dhe të nxënësve të shekullit XXI
 8. Vecorite fizike dhe psiko- sociale të drejtorit të shekullit XXI

Konceptet e menaxhimit, udhëheqjes dhe të administrimit : Konceptet themelore , çfarë duhet të jetë një udhëheqës dhe si të bëheni udhëheqës i suksesshëm, pse udhëheqësi duhet të ketë ndikim, si krijohet ndikimi, etapat e menaxhimit, udhëheqjes dhe të administrimit; puna me prioritete –çelës i suksesit, pse menaxheri , udhëheqësi dhe administratori duhet të jenë të ndershëm, ndryshimet pozitive attribute të domosdoshme të menaxhimit, udhëheqjes dhe të administrimit; stilet e udhëheqjes; cili është roli i “GRUSHTIT DREJTUES”; cilat janë fazat e zhvillimit të institucioneve para-universitare , cilat janë tiparet e udhëheqësve sipas fazave të zhvillimit të institucionit

1. **Planifikimi në arsim :**Konceptet, llojet, metodat) ; Metodatat e planifikimit

rrjetor, Metoda e Kornizës Logjike, Metodologjia e planifikimit me skenar

2. Efikasiteti dhe efektiviteti i institucioneve arsimore: Koncepti i efikasitetit, resurset njerëzore, koncepti i efektivitetit- cilësisë në arsim, kapitali njerëzor, kapitali i dijeve, karakteristikat e shkollës efektive, vlerësimi në arsim, kultura dhe klima shkollore)

3. Menaxhimi i ndryshimeve në arsim: Koncepti i ndryshimit; ç' mund të jetë objekt ndryshimi, cilët mund të jenë agjentët e ndryshimit, cilat janë karakteristikat e njerzëve që sjellin ndryshim, si mund të realizohet ndryshimi, fazat dhe stadet e ndryshimit)

5. Shkolla dhe komuniteti: Shkolla dhe komuniteti dy sisteme të ndërlikuara; shkolla dhe komuniteti nga këndi i Teorisë së Përgjithshme të sistemeve, ç' ndihmë ka shkolla nga idetë dhe energjia e jashtme, krijimi i Rrjetit të Merimangës të partneritetit, nevoja për partneritet dhe partnerët e mundshëm ; planifikimi i partneritetit)

6. Cilat janë detyrat e drejtorit të shkollës së shekullit XXI: Planifikimi, puna analitike studiuere- PAS, Puna instruktive – pedagogjike –PIP (me mësimdhënës, nxënë dhe prindër) ; Puna këshilldhënëse e drejtorit- PKD (me mësimdhënës, nxënës, prindër dhe bashkëpunëtor profesional): Puna në inovimin dhe avancimin e performancës së shkollës-PIAP, Bashkëpunimi me komunitetin arsimor –BKA; Avancimi profesinol dhe fuqizimi i stafit shkollor – APSSh; Monitorimi, mbikëqyrja, vlerësimi dhe vlerësimi i performancës së shkollës dhe të arritjeve të nxënësve – MMVVPSH, Mbajtja , klasifikimi, kategorizimi dhe arkivimi i dokumentacionit pedagogjik dhe shkollor –INDOK -SISTEMI)

1. Tiparet dhe veçoritë e drejtorit të suksesshëm: Veçoritë fizike dhe shëndetësore; veçoritë dhe tiparet mentale; veçoritë dhe tiparet emocionale; Veçoritë dhe tiparet konative ; Veçoritë dhe tiparet sociale – punuese)

8. Testimi i shkollës së aftësisë të pjesëmarrsëve me qëllim të certifikimit mbi bazat e arritshmërisë së treguar (testimi, kontrollimi i testeve, shpallja e rezultateve dhe certifikimi

Metodat e realizimit të programit	<p>Zhvillimi i trajnimit do të udhëhiqet me thënien e më sipërme të psikologut të shquar KurtLevinit. Gjatë trajnimit 60% e kohës do të jetë punë teorike dhe 40 % e kohës praktike. Do të përdoren metodologjitë e më poshtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënia përmes zgjidhjes së problemeve • Mësimdhënia algoritmike • Mësimdhënie përmes përdorimit të TIK-t <p>Zhvillimi I Mendimit Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit, dhe</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënia autentike • Metodologjia e mësimdhënies kooperative dhe ndërvepruese • Metoda e demonstruese, <p>Me qëllim të lidhjes së TEORISË DHE PRAKTIKËS gjatë një dite do të vizitohen dy shkollat me drejtor efikas dhe efektiv.</p> <p>Trajnim me ndërprerje gjatë ditëve të vikendit. Metoda akromatike, erotematike, demonstruese, metodologjia e zhvillimit të mendimit kritik gjatë leximit dhe shkrimit, Metodologjiaa e mesimdhënies kooperative dhe ndërvepruese. Me qëllim të vleresimit të arritjeve do të përdoren teste të standardizuara.</p>
Certifikimi	
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	5 Halim Hyseni, Bujar Thaçi, Fahrije Ratkoceri, Azem Guri, Mentor Sahiti
Data e aplikimi	17.05.2024

Titulli i Programit:	Arsimi gjithëpërfshirës, vlerësimi sipas klasifikimit ndërkombëtar të klasifikimit KNF dhe Plani Individual i Arsimit
Titulli i organizatës:	Këshilli i Evropës
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	Këshilli i Evropës
Adresa:	Bedri Pejani 17/18 Prishtinë
E-mail:	coe.pristina@coe.int
Telefoni:	+383 (0) 38 407 750 dhe +383 (0) 38 407 751
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	N/A
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	N/A
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr 131/2023 10.05.2023
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr 131/2023 10.05.2026
Kohëzgjatja e programit(orë)	70 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit/et e shkollave të rregullta, edukatorët/et, psikologët/et dhe personeli tjetër mësimdhënës i shkollës.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	30
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Arsimtarët dhe edukatorët pas trajnimit marrin njohuritë themelore për konceptet bazë të arsimit gjithëpërfshirës, për rëndësinë që ka zhvillimi profesional në arsimin gjithëpërfshirës, me përcaktimin e kompetencave për mësimdhënësin gjithëpërfshirës, njohja me paragjykimet që ndikojnë në veprimet e tyre dhe pjesëmarrësit zhvillojnë vizionin për mësimdhënësin gjithëpërfshirës.

	<p>Pjesëmarrësit po ashtu marrin njohuri për rëndësinë e komunikimit në marrëdhënie midis njerëzve, marrëdhëniet profesionale, fokusimin në bashkëpunim, kufizimet në pjesëmarrje dhe strategjitë për identifikimin e kufizimeve të pjesëmarrjes.</p> <p>Pjesëmarrësi njihen edhe me KNF-në (Klasifikimi ndërkombëtar i funksionimit) dhe strategjive të ndryshme për zgjidhjen e problemeve duke vendosur pjesëmarrjen e individit në qendër dhe duke e analizuar atë sipas perspektivës zhvillimore, të shëndetit, të marrëdhënieve dhe të kurrikulit. KNF në këtë trajnim ofrohet në aspektin pedagogjik dhe nuk ka për qëllim të fokusohet në aspektin mjekësor të aftësisë së kufizuar të individit.</p> <p>Pjesëmarrësit do të njihen edhe me mjediset që ndihmojnë të nxënit e individualizuar, me mënyrat e hartimit të objektivave afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata, si të ndërthuren objektivat me situatat e të nxënit, mënyrat si të përmirësohet pjesëmarrja në klasë dhe si të hartohen plane individuale në të nxënë.</p> <p>Gjatë trajnimit i cili është mjaft ndërveprues jepen edhe instrumente të cilat më pas pjesëmarrësit e trajnimit mund t'i shfrytëzojnë në punën e tyre për ta bërë mësimdhënien e tyre më ndërveprues dhe më të individualizuar për të plotësuar nevojat individuale të ndryshme të nxënësve.</p> <p>Përveç kësaj pjesëmarrësit e trajnimit do të njihen edhe me formën dhe metodologjinë e hartimit të planit individual të arsimit PIA. Po ashtu pjesëmarrësit do të kenë mundësi të kalojnë dhe e provojnë vet të mbushin secilën pikë të planit individual të arsimit.</p>
<p>Përmbajtja:</p>	<p>Trajnimi zgjatë 10 ditë Janë gjithsejte katër (4) module.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Moduli i parë: Arsimi gjithëpërfshirës, vizioni, teoria dhe konceptet - 2 ditë - Moduli i dytë: Puna së bashku për krijimin e shkollave gjithëpërfshirëse dhe vlerësimi KNF – 3 ditë - Moduli i tretë: Mjediset që ndihmojnë të nxënit e individualizuar – 3

ditë

- Moduli i katërt; Plani Individual i arsimit – PIA – 2 ditë

Pra, trajnimi zgjatë 10 ditë dhe ka gjithsejtë 70 orë trajnimi. Si më poshtë po japim shtrirjen e orëve dhe temave gjatë ditëve të trajnimit.

Dita e parë:

Moduli i parë: Arsimi gjithëpërfshirës, vizioni, teoria dhe konceptet

- Hyrje në arsimin gjithëpërfshirës
- Krijimi i një bashkësie të nxënit gjithëpërfshirës në kuadër të grupit të trajnimit
- Analiza e përbashkët e gjendjes së arsimit gjithëpërfshirës
- Shpjegimi i të kuptuarit dhe përkufizimi i fillestar i arsimit gjithëpërfshirës
- Roli i mësimdhënësit si promotor i ndryshimit
- Të kuptuarit e rëndësisë që ka zhvillimi profesional për arsimin gjithëpërfshirës
- Përcaktimi i kompetencave për arsimin gjithëpërfshirës
- Ndërgjegjësimi rreth paragjytimeve që ndikojnë në veprimet tona në lidhje me diversitetin
- Njohja e disa prej dallimeve ndërmjet mësimdhënësve fillestarë, mësimdhënësve me përvojë dhe mësimdhënësve profesionistë

Dita e dytë:

- Zhvillimi i vizionit personal për mësimdhënësin gjithëpërfshirës
- Të kuptuarit e paragjytimeve, brenda grupit, jashtë grupit (favorizimi brenda në grup) dhe si lidhet kjo me etiketimin
- Njohja e përmasave më të rëndësishme të larmisë
- Të kuptuarit e ciklit të cenimit të drejtave dhe cikli personal i fuqizimit
- Të menduarit si njohuritë për etiketimet, paragjykimet, cenimin e të drejtave dhe fuqizimin mund të jenë të dobishme për shkollën tuaj
- Përkrahja e të gjithë nxënësve
- Pikënisja nga mënyrat vetjake të reflektimit rreth të nxënit dhe arritjes
- Njohja me modelin që mund të ndihmoj të kuptuarit e situatave të

nxënit;

- Të nxënit si rezultat i pjesëmarrjes e jo vetëm arritje
- Të kuptuarit dhe organizimi i kushteve të ndryshme dhe zbatimi në praktikë
- Puna me të tjerët, me komunitetin për një shkollë gjithëpërfshirëse
- Krijimi i vizionit për arsim gjithëpërfshirës për të planifikuar veprimet së bashku me kolegët, nxënësit dhe me komunitetin
- Reflektimi i gjithë modulit të parë dhe identifikimi i nevojave për informata dhe shpjegime shtesë.

Dita e tretë:

Moduli i dytë: Puna së bashku për krijimin e shkollave gjithëpërfshirëse dhe vlerësimi KNF

- Të menduarit për rëndësinë e komunikimit në marrëdhëniet mes njerëzve
- Përpilimi i skicës së marrëdhënieve profesionale personale
- Të kuptuarit e komunikimit si një veprimtari e përbashkët
- Fokusimi në bashkëpunimin që nxitë pjesëmarrjen
- Të kuptuarit e kufizimeve të pjesëmarrjes
- Përdorimi i perspektivave të ndryshme për analizimin e kufizimeve të pjesëmarrjes
- Zhvillimi i strategjive që mund të përdoren për hulumtimin e kufizimeve të pjesëmarrjes

Dita e katërt

- Njohja e KNF - Klasifikimit ndërkombëtar të funksionimit (ICF) si një kornizë e zakonshme e bashkëpunimit (Konteksti i shëndetit dhe mirëqenies).
- Zhvillimi i strategjive të bashkëpunimit krahas ciklit për zgjidhjen e problemeve
- Përdorimi i 'Instrumenteve për vlerësimin pedagogjik të funksionimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsim
- Rritja e shkëlqimit të planifikimit të shërbimeve që duhet t'iu ofrohen shkollave pas çdo vlerësimi
- Njohja dhe krijimi i mjeteve që ndihmojnë jetësimin e këtyre strategjive

Dita e pestë

- Krijimi i ekipeve dhe komuniteteve të gjithëpërfshirjes

- Arritja e të kuptuarit të qëllimeve dhe aktiviteteve të ekipit gjithëpërfshirës
 - Shqyrtimi i njohurive të mësuara deri më tani dhe si e ndihmon kjo formimin e ekipit gjithëpërfshirës
 - Zhvillimi i strategjive për të ndërtuar komunitetet gjithëpërfshirëse të nxënit
 - Shqyrtimi dhe reflektimi për njohuritë e marra në modulën e dytë dhe njohuritë tjera që pjesëmarrësit janë të interesuar t'i marrin
- Dita e gjashtë
- Moduli i tretë: Mjediset që ndihmojnë të nxënit e individualizuar
- Zbatimi i njohurive të marra deri më tani për analizën e situatave të nxënit
 - Të mësohet analiza e situatës nga perspektiva e mësimit dhe nga ajo e nxënësve
 - Praktika e fokusimit në situata në vend se të fokusohemi në karakteristika të nxënësve
 - Zhvillimi i objektivave kuptimplote të nxënit
- Dita e shtatë
- Zbatimi i qasjes ndaj ciklit të jetës gjatë hartimit të objektivave
 - Ndërtimi i kapaciteteve për hartimin e objektivave kuptimplota afatshkurta, afatmesme dhe afatgjatë
 - Mësimi si të ndërthuren objektivat me situatat e të nxënit
 - Njohja e mënyrave si mund të përmirësohet pjesëmarrja në klasë
- Dita e tetë
- Zbatimi i asaj që është mësuar deri më tani për të hartuar plane individuale në të nxënë
 - Zhvillimi i strategjisë për bashkëpunim që do të zbatohet në shkollën tuaj
 - Krijimi i projekt instrumenteve e metodave që mund t'i zbatoni në shkollën tuaj
 - Zhvillimi i strategjive për arritjen e arsimit gjithëpërfshirës
 - Reflektimi mbi njohuritë e marra në të gjitha modulet
- Dita e nëntë
- Çka është Plani individual i arsimit (PIA)
 - PIA është?

	<ul style="list-style-type: none"> • Elementet që e përcaktojnë PIA si proces dhe si produkt? • Si ndërlidhet PIA me Kurrikulën? • Vlerësimi dhe vendimi mbi arsimin me nevoja të veçanta arsimore? • Arsyet për vendimin për arsim me nevoja të veçanta arsimore, hartuesit e PIA <p>Dita e dhjetë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Korniza e PIA-së • Pjesa administrative • Pjesa pedagogjike • Pjesa e rehabilitimit (në rastet kur fëmija merr shërbime rehabilituese) • Pjesa e tranzicionit (faza kalimtare) • PIA si mjet i rëndësishëm për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë tjerë
<p>Metodat e realizimit të programit</p>	<p>Janë gjithsejtë 4 module të trajnimit të cilat organizohen në një periudhë me pauzë në mes midis moduleve. Pas secilit modul jepet nga një detyrë për pjesëmarrësit e trajnimit për të zgjedhur elemente të trajnimit të cilat pjesëmarrësit e trajnimit mund t'i zbatojnë në punën e tyre.</p> <p>Secili modul i ka pjesën teorike të gërshetuar me punën në grupe. Ka mjaft sesione reflektimi ku pjesëmarrësit e trajnimit vihen në pozita të reflektimit për tema të caktuara që kanë të bëjnë me punën e tyre dhe teoritë e reja që propozohen në trajnim. Pjesëmarrësit vihen në situatat të diskutimit me koleget e tyre dhe me trajnerin për tema të ndryshme.</p> <p>Pjesëmarrësit e trajnimit gjithashtu duhet të përgatisin prezantime në flipchart në punën grupore dhe të prezantojnë në grupe për tema të ndryshme. psh. Një nga temat në modulën e dytë mjaft me rendësi është Kufizimi i pjesëmarrjes në të nxënë për nxënës që kanë vështirësi të marrin pjesë në aktivitetet të nxënës që zhvillohen në klasë. Aty jepet mundësi dhe ofrohen instrumente për të vlerësuar perspektivat e kufizimeve të pjesëmarrjes në të nxënë. Ajo shëndetësore, e marrëdhënieve, e kurrikulit dhe ajo zhvillimore.</p>

	<p>Shpesh mësimdhënësit i analizojnë kufizimet e nxënësve në të nxënë nga perspektiva shëndetësorë dhe harrojnë perspektiven e marrëdhënies dhe atë kurrikulare. Kjo qon në analizë të gabueshme dhe veprime të gabueshme nga ana e mësimdhënësve që nuk qon në rritjen e pjesëmarrjes në të nxënë.</p> <p>Ideja me këtë është që mësimdhënësve t'iu hapet mendja dhe të kenë idenë se ka edhe perspektiva të tjera nga të cilat mund të analizohen kufizimet e pjesëmarrjes në të nxënë, jo vetëm të nxënësve me aftësi të kufizuar, po të gjithë nxënësve që kanë vështirësi të marrin pjesë në aktivitetet e të nxënit.</p>
Certifikimi	Secili kandidat që ka ndjekur së paku 7 ditë trajnimi apo 49 orë trajnimi mund të pajiset me certifikatë
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	Tetë (Gazmend Tahiraj, Remzije Krasniqi, Alida Thaqi, Indire Huruglica, Hana Zylfiu-Haziri, Lirije Bytyqi, Armen Mustafa, Vllaznim Balidemaj)
Data e aplikimi	09.03.2023

Titulli i Programit:	Aftësimi për profesionistët e arsimit në mbështetjen e procesit të mësimit të shkrim leximit për nxënësit e shurdhër dhe me dëmtime në dëgjim
Titulli i organizatës:	Këshilli i Evropës
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	Këshilli i Evropës
Adresa:	Bedri Pejani 17/18 Prishtinë
E-mail:	coe.pristina@coe.int
Telefoni:	+383 (0) 38 407 750 dhe +383 (0) 38 407 751
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	N/A
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	N/A
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr 133/2024 16.01.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr 133/2024 16.01.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	21 orë
Përfituesit:	Profesionistët arsimorë (mësimdhënës/e, edukatorë/e, interpretë/e të gjuhës së shenjave dhe stafi tjetër arsimor) në QB Nëna Terezë dhe të tjerë që janë të angazhuar në mësimdhënien e shkrimit/leximit për nxënësit e shurdhër dhe/apo me dëmtime në dëgjim.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	30
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pjesëmarrësit do të: <ul style="list-style-type: none"> • Pajisen me metodologjitë e mësimdhënies të bazuara në përvojat ndërkombëtare; • Aftësohen për të mbështetur shkollat e rregullta në mësimdhënien e

	<p>fëmijëve që nuk dëgjojnë dhe vijojnë mësimin aty;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbështetësin shkollën në angazhimin aktiv ndaj proceseve të zhvillimit, me idenë e ndërtimin të një kulture demokratike dhe gjithëpërfshirëse në shkollë dhe realizimit të një procesi zhvillimor me pjesëmarrje; • Ndërgjegjësohen për rolin dhe përgjegjësitë që kanë rreth arsimit gjithëpërfshirës; • Marrin rol aktiv në mësimdhënien e fëmijëve që nuk dëgjojnë <p>Arsimtarët dhe edukatorët, dhe pjesëtarët e tjerë të grupit të synuar, pas trajnimit marrin njohuritë specifike për mësimdhënien e shkrim leximit për fëmijët e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim, që është bazë e arsimit gjithëpërfshirës për këtë komuniteti. Poashtu ata zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale në arsimin gjithëpërfshirës, si dhe thyejnë barrierat për qasje në arsim cilësor gjithëpërfshirës dhe rritje të pjesëmarrjes për komunitetin e të shurdhërve në treg të punës si pjesëtarë aktiv.</p> <p>Pjesëmarrësit po ashtu marrin njohuri për rëndësinë e komunikimit në marrëdhënie midis njerëzve, marrëdhëniet profesionale, fokusimin në bashkëpunim, kufizimet në pjesëmarrje dhe strategjitë për identifikimin e kufizimeve të pjesëmarrjes.</p> <p>Pjesëmarrësit do të njihen edhe me mjediset që ndihmojnë të nxënit e individualizuar, me mënyrat e hartimit të objektivave afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata, si të ndërthuren objektivat me situatat e të nxënit, mënyrat si të përmirësohet pjesëmarrja në klasë dhe si të hartohen plane individuale në të nxënë.</p> <p>Gjatë trajnimit i cili është mjaft ndërveprues jepen edhe instrumente të cilat më pas pjesëmarrësit e trajnimit mund t'i shfrytëzojnë në punën e tyre për ta bërë mësimdhënien e tyre më ndërveprues dhe më të individualizuar për të plotësuar nevojat individuale të ndryshme të nxënësve.</p>
<p>Përmbajtja:</p>	<p>Dita e I - NJËSIA 1: Pikat e nisja: Mbështetja e mësimin të shkrimit dhe leximit të nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim</p> <p>Kjo njësi fillon me rishikimin e temave të çdo njësie të modulit të parë: 1. Teoritë dhe supozimet e gjuhës, 2 . Dygjuhësia e shurdhër, dhe 3.</p>

Arsimimi bilingual: burimet për mësimin e gjuhës. Kjo vendos themelet për ndërtimin e metodologjive dhe aktiviteteve konkrete që mbështetsin nxënësit e orientuar vizuelisht në procesin e mësimin të shkrimit dhe leximit.

Burimet e materiale vizuale dhe të përshtatura janë vendimtare kur u mësohet shkrimi dhe leximi nxënësve të shurdhër dhe atyre me vështirësi të dëgjimit. Përderisa nxënësit që dëgjojnë bazohen në dekodim fonetik gjatë të mësuarit të leximit dhe shkrimit, ata të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim i lidhin praktikën vizuale dhe ato të mësuara (të tilla si njohja e fjalëve vizuale apo shenjzimi me gishta) kur i dekodejnë kuptimet e formave të shkruara të gjuhës.

Pjesëmarrësit inkurajohen t'i shqyrtojnë mënyrat e tyre të lexuarit dhe të shkruarit. Do të diskutohet se në çfarë shkalle mund t'i aplikojmë përvojat tona me tekstet në përvojat e nxënësve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim. Meqë nxënësit që dëgjojnë mund të mësojnë shkrim leximin përmes deshifimeve fonetike, nxënësit vizualë mund të kenë mënyra alternative për të deshifuar kuptimet e fjalëve dhe teksteve të shkruara. Për këtë arsye, në këtë njësi shqyrtohen disa korniza alternative për të kuptuar se si nxënësit e shurdhër mund t'i zhvillojnë aftësitë e tyre në shkrim leximit.

Njësi do t'u prezantojë pjesëmarrësve metodat përmes të cilave nxënësit e shurdhër zhvillojnë aftësitë e tyre në shkrim dhe lexim. Pjesëmarrësit ftohen të gjejnë karakteristikat e përbashkëta të tyre dhe t'i lidhin ato me metodat e tyre të mjedisit të mësuarit, ndërveprimet e përditshme si dhe materialet konkrete mësimore. Në fund, pjesëmarrësit ua prezantojnë materialet e tyre edukative njëri tjetrit. Ata inkurajohen të flasin se si mund të përdoret të përmirësohet materiali i përbashkët si dhe të prezantojë ide të reja për materiale dhe aktivitete.

Dita e 2 - NJËSIA 2: Krijimi i hapësirës për të mësuarit shkrimin dhe leximin

Në këtë njësi, ne do eksplorojmë mënyrat për të rritur vizualisht materialet arsimore për nxënësit e shurdhër dhe atyre me vështirësi në të dëgjuar. Kjo përfshinë teknika të ndryshme për të nxjerrë në pah strukturën gramatikore në tekste dhe metoda për të përmirësuar të kuptuarit e leximit. Ne do të eksplorojmë veçoritë e tekstit të shkruar që mund të jenë

shpjegohet përmes gjuhës së shenjave, si dhe ndikimin potencial nga privimi nga gjuha.

Fokusi kryesor tek kjo njësi është tek materialet dhe praktiket konkrete arsimore në arsimin shumëgjuhësh dhe multimodal të mësimin të shkrimit dhe leximit. Për të përdorur dhe zhvilluar në mënyrë efektive materialet edukative dhe metodat, është thelbësore të njihen dhe vlerësohen praktiket e shkrim-leximit brenda komunitetit të të shurdhërve.

Lidhja zinxhirore do të prezantohet si një strategji efektive që përdoret zakonisht në arenat vizuale për të nxjerrë në pah ekuivalencat ose distancat ndërmjet burimeve gjuhësore ose modale. Ne do eksplorojmë të lidhje ndërmjet drejtshkrimit të gishtave dhe gjuhëve të shkruara, të shkruara dhe të folura duke analizuar kërkimin letërsi dhe duke marrë pjesë në praktike grup ushtrime.

Ne gjithashtu do të eksperimentojmë me teknika të ndryshme të mësimdhënies përmes leximit dhe shkrimit. Do të përdoren materiale vendore që të sigurohemi që ky trajnim të aplikohet në mënyrë efektive në praktikë.

Dita e 3 - Njësia 3: Aktivitete specifike për shkrim/lexim të fortë dhe të gjithanshëm

Në Njësinë 3, ne do të vazhdojmë të eksplorojmë dhe zhvillojmë materiale dhe praktika konkrete edukative në mësimin multimodal dhe shumëgjuhësh të shkrimit dhe leximit. Pjesëmarrësit do angazhohen në aktivitete gjatë të cilave do të përsërisim temat e Moduleve 1 dhe 2 përmes ushtrimeve praktike.

Ne do të shqyrtojmë situatat dhe mjediset e përditshme dhe do të reflektojmë se cilat tekste të njohura, situatat ndërvepruese dhe hapësira mund të lehtësojnë zhvillimin e shkrim leximit tek nxënësit. Gjithashtu do të eksplorojmë dhe diskutojmë strategji të ndryshme motivuese për nxënësit që të angazhohen në leximin e teksteve të ndryshme.

Gjatë Modullit 1, ne kemi mësuar për llojet e foljeve dhe zgjedhimin e tyre. Kuptimi dhe ilustrimi i rrënjeve të fjalëve është shumë i dobishëm për mësimin e shkrimit dhe leximit. Në këtë modul, ne do zgjerojmë këtë strategji. Ne mund të vizualizojmë pjesët dhe modelet e fjalëve të shkruara përmes ngjyrave, lëvizjeve, dhe modaliteteve të tjera vizuale. Poashtu, ne do të prezantojmë konceptin e lidhjes zingjyrore si aplikim praktik të

	<p>mësimdhënies multimodale dhe shumëgjuhëshe.</p> <p>Në Njësinë 3, ne do të përparojmë nga fazat basike të mësimit në ato më të avancuara. Ne do të fokusohemi në zgjerim të fjalorit përmes mjeteve praktike dhe duke krijuar mënyra të mbështetjes së procesit të mësimit të shkruarit dhe leximit hap pas hapi.</p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Trajnimi është i dizajnuar ashtu që të mund të ofrohet në sallë trajnimit, duke përfshirë ndërveprim, plane dhe projekte mësimore, aktivitete me nxënës, prezantime, diskutime, punë individuale, dhe punë në ekip me kolegët tjerë mësimdhënës. Gjatë kësaj periudhe pjesëmarrësit mbështeten nga trajnerët për këtë program, përmes këshillave dhe poashtu observohen gjatë procesit mësimor.</p> <p>Pastaj, një kohë e caktuar dedikohet për zbatim të njohurive të trajnimit, me nxënës, kolegët tjerë në shkollë dhe reflektim me trajnerë, e që përfshinë edhe detyra praktike. Çdo njësi mundëson fleksibilitet dhe rregullim të planeve të mëtejshme të ofrimit (mënyrat e studimit, mjediset mësimore dhe përmbajtjet). Për shembull, shembujt e marrë nga konteksti finlandez mund të zëvendësohen me shembuj nga kontekstet kosovare ndërsa kursi vazhdon dhe pjesëmarrësit hetojnë mjediset e tyre të përditshme për materiale për t'u përdorur dhe kontrolluar së bashku me edukatorët dhe pjesëmarrësit e tjerë.</p>
Certifikimi	Pas vijimit të minimum 14 orëve trajnimit
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	Dy (Irja Seilola & Elina Tapio)
Data e aplikimi	16.01.2024

Titulli i Programit:	Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie
Titulli i organizatës:	Sindiakta e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)
Tipi i programit:	
Ofertuesi i programit:	Sindiakta e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)
Adresa:	Rr Agim Ramadani p.n. Qendra e studentëve, Drejtoria 10000 Prishtinë
E-mail:	sbashk2004@yahoo.com ; info@sbashk-rks.org
Telefoni:	+383(0) 38 226 940
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr: 151/2024 Data e aprovimit: 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	Nr: 151/2024 Data e skadimit: 26.02.2027
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr: 41/2024 Data e aprovimit: 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr: 41/2024 Data e skadimit: 26.02.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	103 orë (51 orë një certifikatë dhe 52 orë një certifikatë) 51 orë (Word 21+1 test; Excel 18+1 test; Power point 9+1 test) 52 orë (Sisteme operative 15+1 test; Internet 6+1 test; Outlook dhe aplikacione 12+1 test; Access 15+1 test)
Përfituesit:	Ky program i dedikohet përfaqësuesve të MASHTI-t, të DKA, drejtorëve të shkollave, udhëheqësve sindikal si dhe mësimdhënësve të niveleve të ndryshme. Po ashtu, programi mund të jetë i dobishëm edhe për studentët e fakulteteve që përgatisin mësimdhënësit e ardhshëm dhe të atyre që ofrojnë kurse lidhur me teknologjinë e informacionit.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25 deri 32 pjesëmarrës.

Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Me përvetësimin e këtij Programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> Të njohin bazat themelore të teknologjisë së informacionit Të njohin sistemet operative Të fitojnë shkathtësi për zbatimin e MS Outlook 2013 dhe aplikacione Të fitojnë shkathtësi për përdorimin e MS Word 2013 Të fitojnë shkathtësi për përdorimin e MS Excel 2013 Të fitojnë shkathtësi për përdorimin e MS PowerPoint 2013 Të fitojnë shkathtësi për përdorimin e MS Access 2013 Të fitojnë shkathtësi për përdorimin e Interneti.
<p>Përmbajtja:</p>	<p>Fëmijët e njohin TEATRIN shumë herët përmes aktiviteteve të përditshme praktike; në shtëpi, në lojë, në institucionin parashkollor, me bashkëmoshatarët e tyre në natyrë ku përfshihen aktivitetet bazë si ndrimi i roleve, imitimeve, kuptimit dhe konceptimit të botës përmes të rriturve. loja me kukulla/kafshë që flasin, vizitat në teatër. Kur fëmijët luajnë role dhe improvizojnë, ata krijojnë aftësi krijuese, logjike e akademike duke e rritur dëshirën për të eksploruar dhe gjetur zgjidhje për pjesën që do të "inskenojnë" - TEATRI e ofron këtë. Njohuria për TEATRIN është pjesë e përditshmërisë së tyre kur luajnë, imitojnë, ndërrojnë rolet e improvizojnë gjëra të reja. Është shumë e rëndësishme që fëmijët të kenë mundësi të zhvillojnë aktivitetet teatrore sepse kështu mësojnë dhe eksperimentojnë me aftësitë që ofron TEATRI dhe teoritë që rrjedhin. TEATRI dhe artet skenike janë forma të fuqishme, madhështore të shprehjes artistike. Ata magjepsin mendjet, stimulojnë reflektimin dhe nxisin rritjen estetike. Ata zotërojnë një fuqi të veçantë të zbulimit dhe gjenerimit të bukurisë - në të gjitha kuptimet - të botës ku jetojmë. Teatri dhe artet skenike i ndihmojnë individët të kapërcejnë të zakonshmen dhe të ushqejnë ndjenjën e lirisë individuale. Së bashku me vlerën e tyre të jashtëzakonshme të brendshme, teatri dhe artet skenike: Teatri dhe artet skenike janë forma të fuqishme, madhështore të</p>

shprehjes artistike. Ata magjepsin mendjet, stimulojnë reflektimin dhe nxisin rritjen estetike. Ata zotërojnë një fuqi të veçantë të zbulimit dhe gjenerimit të bukurisë – në të gjitha kuptimet – të botës ku jetojmë. Teatri dhe artet skenike i ndihmojnë individët të kapërcejnë të zakonshmen dhe të ushqejnë ndjenjën e lirisë individuale. Së bashku me vlerën e tyre të jashtëzakonshme të brendshme, teatri dhe artet skenike: Nxiten demokracinë sepse TEATRI dhe artet skenike kanë një fuqi të natyrshme për të promovuar vlerat humanitare. Ato u mundësojnë qytetarëve të të gjitha moshave të kuptojnë dhe pranojnë këndvështrime të ndryshme, gjë që është thelbësore për një demokraci të shëndetshme;

Metodat e realizimit të programit

3.5 Metodologjia që do të përdoret në ofrimin e programit trajnues *(Të përshkruhet metodologjia e ofrimit të programit trajnues dhe baza mbi të cilën është përzgjedhur,*

Metodologjia e përshkruar për edukimin teatror përfshin metodologji gjithëpërfshirëse dhe atraktive për audiencën e synuar që janë mësimdhënësit e fëmijërisë së hershme. Duket i krijuar për të përdorur lojën, improvizimin dhe përvojat praktike për të rritur aftësitë njohëse, krijuese dhe logjike të fëmijëve. Elementet kryesore përfshijnë:

Qartësia e objektivave: Moduli synon të përgatisë edukatorë duke përdorur punën pedagogjike, lojën dhe improvizimin në edukimin teatror. Ai thekson përdorimin e metodave didaktike, rekuizitave, lojërave, aktiviteteve dhe improvizimeve praktike të skenës.

Qasja e integruar: Edukimi teatror paraqitet si një platformë shumëdimensionale për të mësuar, duke shërbyer si instrument për të ndihmuar fëmijët të eksplorojnë dhe përjetojnë botën përmes ngjarjeve dhe temave në kohë dhe hapësirë. Kjo qasje synon të stimulojë emocionet pozitive dhe të kontribuojë në një zhvillim të ekuilibruar.

Përafrimi me kompetencat: Është i harmonizuar me Kornizën Kurrikulare në Kosovë, duke trajtuar kompetencat si të nxëniet, kompetencat qytetare

	<p>dhe personale të fëmijët. Moduli është i përshtatur me nevojat dhe objektivat arsimore të përshkruara në kurrikulën e Kosovës.</p> <p>Të mësuarit përmes lojës: Theksi në mësimin e bazuar në lojë dhe qasjen teorike dhe praktike përmes improvizimit dhe përvojave personale përputhet me metodologjitë e mbështetura nga kërkimi për edukimin e fëmijërisë së hershme.</p> <p>Përgatitja e edukatorëve: Moduli nuk fokusohet vetëm në të nxënit tek fëmijët, por edhe në përgatitjen e edukatorëve për të përdorur qasjen e duhur ndaj edukimit teatror. Ai synon të informojë dhe trajtojë edukatorët në një mënyrë që u mundëson atyre të krijojnë mjedise të qëndrueshme dhe tërësore të të mësuarit.</p>
Certifikimi	Nr.15/2024 me datë 26.02.2024
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	3 trajnerë; Fadil Hysaj, Zeherie Plakolli, Florie Bajoku
Data e aplikimi	Djetor, 2023

Titulli i Programit:	Edukimi matematik përmes një veprimtarie komplekse të zgjidhjes së problemeve - Fusha "Matematikë"
Titulli i organizatës:	Qendra e Trajnimeve Albas - Kosovë
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	Qendra e Trajnimeve Albas - Kosovë
Adresa:	Rr."Bekim Femi", Lakrishtë, Prishtinë
E-mail:	trajtime@albaskosova.com / albas_pr@yahoo.com
Telefoni:	+38344108887 / 045999332
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Numër 135/2024 Datë 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	Numër 135/2024 Datë 26.02.2025
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Numër 105/2024 Datë 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Numër 105/2024 Datë 26.02.2025
Kohëzgjatja e programit(orë)	12 orë
Përfituesit:	Mësimdhënës fillestar Mësimdhënës i karrierës Mësimdhënës i avancuar Mësimdhënës mentor Mësimdhënës i merituar
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	30 mësues
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Në fund të programit të trajnimit mësuesi/ja zotëron: <ul style="list-style-type: none"> - Qëndrim reflektues efektiv ndaj kurrikulës së matematikës shkollore bazuar në kompetenca, realizuar në të zbatuar konkret. - Praktikitet të ndërtimit të situatave problemore dhe sjellja e jetës në klasë. - Ndërtimi i kuptimeve përmes angazhimit me problemet dhe ndërveprimet me të

	<p>tjerët në aktivitete konkrete.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Promovim diskutimi e komunikimi, ide dhe qëndrime. - Aftësim për të përdorur, ndërthurur e hulumtuar metoda/teknika efektive dhe burime të larmishme të të nxënit. - Aftësi reflektuese ndaj sugjerimeve/feedback në dobi të qëndrimeve dhe përmirësimit të mësimdhënies. - Risi e iniciativa për ndryshim. - Rikoncepton kurrikulën e matematikës shkollore në vijimësi sipas shkallëve të klasifikimit standard dhe zbatim përmes tematikave të saj në arsimin parauniversitar, mbështetur në strategji kombëtare e përvoja kombëtare apo më gjerë; si dhe diktuar nga nevoja për përmirësim. - Demonstron se kupton varësitë e ndërlidhjet midis koncepteve, kuptimeve të përmbytjes shkencore të lëndës/ fushës me kompetencat kyçe, lëndore dhe të fushës si dhe zhvillimin e tyre nga një cikël shkollor në vijimësi deri në përfundim të arsimit parauniversitar; - Kupton zhvillimin spiral të përmbytjes shkencore më thelbësore të lëndës/ fushës Matematikë nga një cikël shkollimi në tjetrin dhe progresin që duhet të realizojnë nxënësit në zotërimin e kompetencave të fushës. - Planifikon dhe realizon veprimtari të përshkallëzuara të nxënies për aktivizimin dhe aftësimin e tyre në çdo orë mësimore me fokus zotërimin dhe demonstrimin e kompetencave kyçe, lëndore dhe të fushës. - Demonstron praktikitet në ndërtimin e situatave problemore dhe sjelljen e jetës në klasë. - Kupton përparësitë e bashkëpunimit në ekip të mësuesve të lëndëve të fushës Matematikë si dhe lidhjet me mësuesit sipas fushave/ lëndëve të tjera për të planifikuar, realizuar, vlerësuar, dokumentuar dhe raportuar për arritjet e çdo nxënësi në lidhje me kompetenca kyçe, lëndore dhe të fushës në përfundim të çdo viti dhe cikli. - Përmirëson procesin e vlerësimit të nxënësit në përfundim të çdo periudhe, viti dhe cikli shkollor duke e dokumentuar me formatin e niveleve të zotërimin të kompetencave lëndore dhe të fushës dhe evidentuar progresin ose jo të çdo nxënësi. - Analizon arritjet e nxënësve në përfundim të çdo viti dhe cikli sipas niveleve të përmbytjes së kompetencave lëndore dhe të fushës, efektivitetin e aftësimin të tij si zgjidhës i problemeve. - Mban qëndrim reflektues ndaj kurrikulës së matematikës shkollore bazuar në kompetenca, duke e realizuar dhe zbatuar atë konkretisht përgjatë zhvillimit dinamik të saj. - Reflekton individualisht dhe në grup me mësuesit lëndor të fushës për përmirësim të mëtejshëm të procesit mësimor me qendër nxënësit bazuar në analizën e matricës përmbledhëse të niveleve të zotërimin të kompetencave nga secili nxënësi në përfundim të çdo cikli shkollor. - Demonstron përgatitje dhe përkushtim në zbatimin, në kushtet konkrete e
--	--

	<p>specifike të shkollës ku punon, të sistemit të parashtruar të ecurisë së formimit të nxënësit në fushën Matematikë bazuar në nivelet e zotërimit të kompetencave lëndore dhe të fushës.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Reflektton profesionalisht mbi përvoja e risi të evidentuara në trendin e mësimdhënies/ nxënies së matematikës shkollë duke demonstruar një përshtatshmëri koherente në nivel kombëtar e më gjerë. - Rikoncepton zhvillim profesional me modele të “Të Nxënit Profesional të Individualizuar” si mësues për rritjen e cilësisë së shërbimit të mësimdhënies së matematikës nisur nga ky trajtim në modul, me mundësinë që të analizojnë dhe zgjedhin praktikën dhe/ose mënyrën më të mirë që mbështet rritjen e mësuesve si ‘nxënës’ individualë në kushtet e shkollës. - Aftësohet dhe reflektton ndaj sugjerimeve/feedback në dobi të qëndrimeve dhe përmirësimit të mësimdhënies së lëndës/ fushës Matematikë. Arrin të jetë rezultativ në të nxënit praktik dhe efektiv, cilësor dhe sfidues lidhur me aftësimin e nxënësve për jetën.
Përmbajtja:	<p>Programi do të nxisë iniciativa që lidhen me zhvillimin profesional të mësuesve për rritjen e cilësisë së shërbimit të mësimdhënies së matematikës nisur nga ky këndvështrim, duke siguruar rezultate efektive në të nxënit praktik, cilësor dhe sfidues lidhur me aftësimin e nxënësve për jetën. Pjesëmarrësit të kuptojnë qartë kërkesat e dokumentacionit kurrikular bazuar në kompetenca, në organizimin dhe realizimin e procesit mësimor si edhe në vlerësimin e nxënësve në përfundim të periudhës, vitit dhe ciklit shkollor duke iu referuar kompetencave kyçe dhe të fushës/lëndë.</p> <p>Programi, përmes seancave të tij, siguron një lidhje të trajtimeve e materialeve teorike me konkretizime në zbatime përmes detyrave praktike individuale dhe në grup, për t’u aftësuar në plotësimin e formateve të ofruara përgjatë seancave të modulit. Zotërimi i gjithë materialit strukturor teorik, praktik e konkretizues të trajtuar në modul do të reflektohet te: qartësia, qëndrimi dhe gatishmëria për ta zbatuar. Programi do të motivojë shkëmbimin e mendimeve, promovim diskutimi e komunikimi, parashtrimin e ideve dhe qëndrimeve dhe praktika të reja pune me bazë kompetencat, të zbatueshëm në kushtet aktuale të shkollës dhe përmes sjelljes së jetës në klasë.</p> <p>Detyrat e dhëna sugjerohen të rimerren nga pjesëmarrësit edhe pas përfundimit të modulit në formën e reflektimit profesional, e të bashkëngjiten me modele të “Të Nxënit Profesional të Individualizuar” harmonizuar me Zhvillimin e brendshëm profesional të shkollës.</p> <p>Moduli 1. Matematika e rikonceptuar si një veprimtari komplekse e zgjidhjes së problemeve.</p> <p>Moduli 2. Situata të nxëni në matematikë në lidhje me TIK-un.</p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Metodologjia e trajnimit mbështetet në metodologjitë bashkëkohore dhe me qasje interaktive, parimet dhe kërkesat e mësimdhënies inovative duke pasur parasysh përfshirjen aktive të pjesëmarrësve, qasjen e integruar, bashkëpunimin, iniciativën dhe rezultatet e të nxënit me fokus kompetencat dhe rritjen e shkathtësive për mësimdhënie efikase.</p>

	<p>Disa nga metodat të cilat do të përdoren gjatë programit të trajnimit janë: <i>Leksioni (në power point) dhe materiale ilustruese të prezantuara me metodat audiovizuale, demonstrimi, veprimtari e pavarur individuale, punë me grupe</i> / “<i>punë në çift</i>”, <i>metoda sokratike</i> që përdoret pothuajse në secilën seancë. Seancat praktike të grupeve përmbajnë metodologji të përqendruar te nxënësit, në mënyrë që mësime të familjarizohen me metodat edhe nga këndvështrimi i nxënësit. Çdo modul shoqërohet me detyra të cilat demonstrojnë shkallën e njohurive të marra nga pjesëmarrësit në secilin prej tyre.</p>
Certifikimi	<p>Certifikimi i pjesëmarrësve do të bëhet duke respektuar kriteret në vijim: Pjesëmarrja në trajnim min. 80% dhe realizimi me sukses i detyrave (portfolios) nga pjesëmarrësit, të dhëna nga trajneri/ja 2 ditë pas çdo moduli të zhvilluar (ditë trajnimi).</p>
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	Dhurata Valera; Jeta Kingji Kastrati; Eglantina Kalluci; Alida Thaçi.
Data e aplikimi	15.12.2023

Titulli i Programit:	Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social
Titulli i organizatës:	Sindiakta e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)
Tipi i programit:	
Ofertuesi i programit:	Sindiakta e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)
Adresa:	Rr Agim Ramadani p.n. Drejtoria Qendra e studentëve 10000 Prishtinë
E-mail:	sbashk2004@yahoo.com ; info@sbashk-rks.org
Telefoni:	+383(0) 38 226 940
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr: 151/2024 Data e aprovimit: 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	Nr: 151/2024 Data e skadimit: 26.02.2027
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr: 36/2024 Data e aprovimit: 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr: 36/2024 Data e skadimit: 26.02.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	32 orë
Përfituesit:	Ky program i dedikohet përfaqësuesve të MASHT, të DKA, drejtorëve të shkollave, udhëheqësve sindikal si dhe mësimitdhënësve të niveleve të ndryshme. Po ashtu, programi mund të jetë i dobishëm edhe për studentët e fakulteteve që përgatisin mësimitdhënësit e ardhshëm dhe të atyre që ofrojnë kurse lidhur me dialogun social
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25 deri 32 pjesëmarrës.
Rezultatet e pritura ose objektivat e	Me përvetësimin e këtij Programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje: Të njohin procesin e ndryshimit dhe zhvillimit të organizatave

programit:	<p>Të fitojnë shkathtësi relevante për zbatimin e formave të ndryshme të dialogut social</p> <p>Të praktikojnë dhe të përgatisin një metodologji për të udhëhequr një proces të dialogut përmes negocimit, konsultimit, etj.</p> <p>Të shkëmbejnë informacione në mes të përfaqësuesve të qeverisë, punëdhënësve dhe punëtorëve, për çështjet me interes të përbashkët ,që kanë të bëjnë me politikën ekonomike dhe sociale.</p> <p>Të jenë në gjendje të praktikojnë dialogun informal apo të institucionalizuar si dhe të bëjnë kombinimin e të dyjave.</p>
Përmbajtja:	<p>Përmbajtja: Çfarë është dialogu social – Përkufizimi, Zhvillimi I Dialogut, Sfidat dhe kujdesi në dialog;</p> <ul style="list-style-type: none"> -Dialogu social Kombëtar – partnerët e dialogut dhe interesat e partnerëve të dialogut; -Ushtrim mbi interesat e punëtorëve, punëdhënësve dhe interesat e përbashkëta; -Dialogu Social-Këshilli i punëtorëve të Evropës – Funkcionet; -Dialogu Social dhe puna në Kosovë- Këshilli Ekonomik Social i Kosovës (KES), Funkcionet e KES-it në Kosovë, Organet e KES-it; -Dialogu Social Evropian- Përkufizimi, Funkcionimi; -Dialogu Social në Kosovë-vizioni dhe misioni, objektivat strategjike dhe specifike -Dialogu Social dhe Puna -Ushtrim në grup lidhur me kyçjen e sindikatave dhe punëtorëve në Këshillin Evropian të punëtorëve dhe sfidat që hasin - Konflikti dhe zgjidhja e tij- Përkufizimi, Strategjitë për zgjidhjen e konfliktit -Ushtrim praktik në grupe nga 6 persona për zgjidhje të një konflikti dypalësh (Vlerësim)
Metodat e realizimit të programit	Programi organizohet në formë të një seminari 4 - ditorë
Certifikimi	Në fund të trajnimit pjesëmarrësit të cilët e kanë ndjekur trajnimin marrin certifikatë.
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	Rrahman Jasharaj, Ymer Ymeri, Vjollca Shala, Safet Beqiri, Atdhe Hykolli, Besa Krasniqi, Alban Zeneli, Besim Haliti, Blendor Shatri, Blerim Mehmeti, Ramadan Gashi, Leonida Imeri, Reshit Kushaj, Hysen Sogojeva, Astrit Buja, Dervish Kopriva, Jehona Hysenaj, Sebahate Ajeti, Shpend Canamusa,

	Nora Haliti, Isuf Lajqi, Avdullah Krasniqi, Emrush Ahmeti, Kastriot Veselaj, Besjana Rexhepi, Haxhi Berisha, Valbona Haziri, Blerina Lubishtani, Mervan Mustafa, Milot Haziri, Afrim Balaj, Hamdi Aliu, Ramadan Lushaj, Arta Haxhimehmeti, Visar Sadriu, Skender Gashi, Bashkim Hyseni, Besim Kryeziu, Hanife Shorra, Emine Rashiti, Kaltrina Aliu.
Data	08.04.2024

Titulli i Programit:	“Gjithë përfshirja” Edukimi dygjuhësor i te shurdhërve, Bilingualizmi
Titulli i organizatës:	Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim” Nene Tereza” Prizren
Tipi i programit:	Trajnime për mësimdhënës fillestar, mësimdhënës i karrierës, mësimdhënës i avancuar, mësimdhënës mentor, mësimdhënës i merituar, edukator, DKA, OJQ
Ofertuesi i programit:	QBMK “Nënë Tereza” Prizren
Adresa:	Rr. “ Hoxhë Tasini”nr.231, 20000, Prizren
E-mail:	
Telefoni:	+38344-191-896
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr.1925 09.01.1951
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	/
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr.126/2024 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr.126/2027 26.02.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	3 Vite
Përfituesit:	Shkollat e Kosovës, mësimdhënësit, edukatorët, DKA, OJQ
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	15-20 kandidat

Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Ky projekt do fokusohet në arsimin dhe edukimin e femijeve me aftësi të kufizuara degjimi dhe te folurit si dhe per femijet Autike.</p> <p>Programimi dygjuhësh i shenjave është Program tipike dygjuhëshe të gjuhët e shenjave natyrore si gjuhë të parë të nxënësve të shurdhër (L1), e cila supozohet se mbështet zhvillimin e shkrim-leximit të tyre në gjuhën e folur si gjuhë e tyre të dytë (L2), pavarësisht faktit se pothuajse 95% e këtyre nxënësve lindin nga prindër që dëgjojnë.</p> <p>Ky program do te ketë impakt tek mësimdhënësit te cilët punojnë me fëmijë me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe te folurit, fëmijët autik, ne qasje, trajtimin dhe edukimin e kësaj kategorie te fëmijëve.</p>
Përmbajtja:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Edukimi dygjuhësor i te shurdhereve-Bilingualizmi 2. Aspektet gjuhësore të dygjuhësisë bimodale <ol style="list-style-type: none"> 2.1. Gjuhësia e gjuhës së shenjave 2.2. Përvetësimi i gjuhës së shenjave 2.3. Vlerësimi i gjuhës së shenjave 3. Përdorimi bimodal i gjuhës dygjuhëshe <ol style="list-style-type: none"> 3.1. Hulumtimi me dygjuhësh bimodalë që dëgjojnë 3.2. Kërkimi dygjuhësh bimodalë të shurdhër 3.3. Hulumtimi me fëmijët me implante kokleare 4. Zhvillimi bimodal i shkrim-leximit dygjuhësh <ol style="list-style-type: none"> 4.1. Procesi i leximit 4.2. Shkrimi bimodal dygjuhësor i fëmijëve të shurdhër 4.3. Qasjet dygjuhëshe bimodale për mbështetjen e zhvillimit të shkrim-leximit <ol style="list-style-type: none"> 4.3.1. Drejtshkrimi me gishta 4.3.2. Fjalimi i kuptueshëm 4.4. Vështrime nga shkrim-leximi i hershëm 5. Pedagogjitë bimodale dygjuhëshe <ol style="list-style-type: none"> 5.1. Rezultatet e arsimit dygjuhësor 6. Politika arsimore

<p>Metodat e realizimit të programit</p>	<p>Trajnim Online dhe ne formë fizike)</p>
<p>Certifikimi</p>	
<p>Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve</p>	<p>Trajner: (3) 1.Mustafe Morina 2.Albulena Rrustemi Vejsa 3.Teuta Krasniqi</p>
<p>Data e aplikimi</p>	<p>15.120.2023.</p>

Titulli i Programit:	Gjithëpërfshirja në edukimin fizik, lojërat dhe sportet për nxënës me aftësi të kufizuara
Titulli i organizatës:	Komiteti Paralimpik i Kosovës (KPK)
Tipi i programit:	Program plotësues
Ofertuesi i programit:	Komiteti Paralimpik i Kosovës (KPK)
Adresa:	Rr. "Metush Krasniqi" Nr. 65, Arbëria, Prishtinë
E-mail:	njomzaemini@gmail.com
Telefoni:	+383 44 280 500 +383 48 493 202
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr. 134/2024, 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	Nr. 134/2024, 26.02.2025
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr. 140 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr. 140 26.02.2025
Kohëzgjatja e programit(orë)	16 orë
Përfituesit:	Institucionet e arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës, mësimdhënësit, edukatorët, asistentët e fëmije me nevoja të veçanta dhe punëtorët arsimor të ciklit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, federatat e sporteve për personat me aftësi të kufizuara.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Grupet prej 15-20 pjesëmarrës. (Numri i pjesëmarrësve nga komunat e Kosovës gjate një viti do të jetë 800).

Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e kapaciteteve të shkollave dhe mësimdhënësve për të përfshirë nxënësit me nevoja të veçanta në edukimin fizik dhe aktivitete sportive; - Përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në procesin mësimor në orët e edukimit fizik; - Nxitja e sportit dhe jetës së shëndetshme tek nxënësit me nevoja të veçanta.
Përmbajtja:	<p>Trajnimi është dy ditor me modulet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjithëpërfshirja në procesin arsimor: 1 orë - Fëmijët me nevoja të veçanta arsimore: 2 orë - Edukimi fizik tek nxënësit me nevoja të veçanta: 2 orë - Zhvillimi i sporteve tek fëmijët me NVA: 3 orë - Individualizimi i planit mësimor në edukimin fizik: 2 orë - Modifikimet e mjedisit, pajisjeve, rregullave dhe metodave mësimor në edukimin fizik: 2 orë - Lojërat dhe sportet- demonstrimet praktike: 3 orë - Raste studimi, punë praktike në grupe: 1 orë
Metodat e realizimit të programit	<p>Trajnimi është interaktiv dhe kombinohen metodat e ndryshme në punën në grup, përfshirë mësimet teorike dhe praktike që zhvillohet me demonstrim në sallë të përshtatjeve mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Metodat verbale me prezantime me powerpoint, me ilustrime me foto dhe video; - Demonstrimi apo modelimi- paraqitjen ose shpjegimin përmes veprimeve në sallën e trajnimit; - Asistenca fizike- asistimin që i duhet nxënësit për të arritur një teknikë të caktuar ose një lëvizje. <p>Në çdo lojë apo sport mësohen rregullat bazë të sajë me përshkrim të lojës, pajisjet, teknikat dhe profilet funksionale të nxënësve.</p>
Certifikimi	<p>Certifikimi sipas kriterëve të Këshillit Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve (KSHLM) për programet plotësuese për zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe punonjësve arsimor.</p>

Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<ol style="list-style-type: none">1. Ahmet Mahmutaj2. Enver Ulaj3. Arbër Grabovci
Data e aplikimi	13.12.2023

Titulli i Programit:	Gjithpërfshirja në sistemin arsimor në Kosovë, integrimi i fëmijëve të verbër
Titulli i organizatës:	Qendra Burimore për mësim dhe këshillim "Xheladin Deda"
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Qendra Burimore për mësim dhe këshillim "Xheladin Deda"
Adresa:	Rruga Bill Klinton, nr. 183 Pejë
E-mail:	shvqb.peje@gmail.com
Telefoni:	+383 39 410 355
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	N/A
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	N/A
Numri dhe data e aprovimit të programit:	26.02.2024 Nr. 02/2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	26.02.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	16 orw
Përfituesit:	Ky trajnim është i paraparë për mësimdhënësit e niveleve fillor, mesëm i ultë dhe i mesëm i lartë në institucionet arsimore në Kosovë, në ato institucione që kanë, apo që do të pranojnë të regjistrojnë fëmijë të verbër dhe me dëmtime në të parë.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Trajnimi mbahet me pjesëmarrje direkte në grupe deri në 25 persona.
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Mësimdhënëset që kryejnë këtë trajnim: <ul style="list-style-type: none"> - Punojnë me fëmijë të verbër dhe që janë të integruar në institucionet e tyre fillore dhe të mesme - Marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e Planit Individual të arsimit - Njohin sistemin gjithpërfshirës në arsimin e Kosovës dhe marrin

	përgjegjasi që dalin nga legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar - Bashkëpunojnë dhe këshillojnë prindërit e fëmijëve të verbër me dëmtime në të parë
Përmbajtja:	Programi “Gjithpërfshirja në sistemin arsimor në Kosovë, integrimi i fëmijëve të verbër” është i dizajnuar për mesimdhënësit në shkollat e rregullta në Kosovë dhe përbëhet nga këto tema: 1. Edukimi i fëmijëve me dëmtime në të parë – karakteristikat e fëmijëve të verbër 2. Gjithpërfshirja në sistemin arsimor në Kosovë 3. Legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut dhe arsimin 4. Qendrat burimore dhe roli i tyre 5. Mësuesi dhe nxënësi në klasën gjithpërfshirëse 6. Përshtatja e ambientit përgatitja e materialeve mësimore për të verbër
Metodat e realizimit të programit	Trajnimi mbahet me pjesëmarrje direkte në grupe deri në 25 persona. Trajnimi është interaktiv dhe përmban pjese teorike të prezantimeve dhe punën praktike individualisht dhe në grupe që bëhet nga pjesëmarrësit në trajnim. Një pjesë e trajnimit konsiston në materialet që prezantohen dhe demontohen para pjesëmarrësve të trajnimit, duke përfshirë mjete punë, instrumente, metoda të cilat demonstrohen në punën konkrete me fëmijën. Grupet për trajnime krijohen në bazë në shkollë, në atë shkollë ku regjistrohet një fëmijë i ri i verbër për herë të parë, krijohet grupi i mesimdhënësve që punojnë direkt me të dhe trajnohen për punë me fëmijë të verbër. Trajnimet mund të bëhen edhe në bashkëpunim me DKA-të për mësuesit në nivel komuna, apo përmes Divisionit për Gjithpërfshirje për grupe të kombinuara të mësuesve që duan të marrin aftësimin bazik në këtë fushë.
Certifikimi	Certifikatë e trajnimit
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	Xhavit Kastrati, drejtor, trajner Enver Ulaj, Koordinator i Qendrës së trajnimeve; profesor, trajner Shfqet Mulliqi, Tifloperdagog, dr sc. i edukimit special Ilirjana Shehu, Ekspert i intervenimit të hershëm për fëmijët e verbër Ahmet Mahmutaj, Profesor i edukatës fizike
Data e aplikimi	06.12.2023

Titulli i Programit:	Gjithëpërfshirja dhe Individualizimi i mësimit për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore - PIA
Titulli i organizatës:	Eko - Protection
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	Eko - Protection
Adresa:	Rr. Isa Kastrati – Prishtinë
E-mail:	Ekoprotection2020@gmail.com
Telefoni:	049-541-053 - 044-415-558
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	152/2024 Data: 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	152/2024 26.02.2027
Numri dhe data e aprovimit të programit:	86/2024 - 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	86/2024 – 26.02.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	56 orë.
Përfituesit:	Përfituesit e drejtpërdrejtë: Drejtorët e shkollave, zëvendës drejtorët, pedagogët, psikologët, mësime dhënësit klasorë, mësime dhënësit lëndorë, mësime dhënësit mbështetës, mësime dhënësit e klasave të bashkangjitura si dhe asistentë për nxënës me nevoja të veçanta.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25 - 30 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pjesëmarrësit do informohen për terminologjinë dhe konceptet e arsimit gjithëpërfshirës, për largimin e paragjyqimeve për nxënës apo personat me nevoja të veçanta arsimore; Të mos i paragjykojmë nxënësit në bazë të vështirësisë që kanë por përparësive të tyre, të fokusohemi në atë që mund të bëjnë e jo në atë që nuk mund të bëjnë;

	<p>Pjesëmarrësit do të pajisen me njohuri të reja për organizimin dhe planifikimin e punës me nxënës me nevoja të veçanta arsimore respektimi i individualitetit të secilit nxënës;</p> <p>Për përgatitjen e materialeve alternative mësimore duke u bazuar në nevojat individuale të nxënësve;</p> <p>Si bëhet menaxhimi i klasës ku ka nxënës me nevoja të veçanta arsimore, krijimi i klimës së përshtatshme brenda klase, respektimi i nevojës së veçantë dhe përfshirja në aktivitete të shkollës të secilit pavarësisht vështirësisë së tij/saj.</p> <p>Njohja e vështirësive në të nxënë (vështirësi këto që janë pedagogjike e jo mjekësore).</p> <p>Përdorimi i metodave dhe teknikave të përshtatshme varësisht nga vështirësia në të nxënë që ka nxënësi në klasë</p> <p>Informata të nevojshme për Planin Individual të Arsimit (PIA),</p> <p>Të mësojnë si hartohet PIA dhe si ta zbatojnë atë në punë me nxënës me nevoja të veçanta arsimore në klasë;</p> <p>Pjesëmarrësit që kanë vijuar trajnimin mësojnë të vlerësojnë nxënësit sipas UA, dhe vlerësimin në ditarë shkollorë sipas PIA.</p>
Përmbajtja:	<p>Programi i trajnimit është i ndarë në 2 module:</p> <p>Moduli I – Gjithëpërfshirja, mësimdhënia dhe mësimnxënia (24 orë)</p> <p>Programi përfshinë Informatat themelore për arsimin gjithëpërfshirës - Terminologjisë;</p> <p>Legjislacioni i arsimit special në Kosove dhe Botë;</p> <p>Stilet dhe strategjitë e mësimdhënies;</p> <p>ADHD (Çrregullimet e Vëmendjes dhe Hiperaktivitetit);</p> <p>Bashkëpunimi prindër , nxënës dhe mësimdhënës;</p> <p>Menaxhimi i klasës;</p> <p>Vështirësitë në shkrim- lexim dhe matematikë;</p> <p>Nxënësit hiperaktiv;</p> <p>Autizmi</p> <p>Inteligjencat e shumëfishta;</p> <p>Dallueshmëritë ndërmjet nxënësve;</p> <p>Moduli II – Plani Individual i Arsimit - PIA- (24 orë)</p> <p>Njohja me planin individual të arsimit (PIA) dhe udhëzuesin për përdorimin e PIA-së;</p> <p>Hartimi i PIA-së;</p> <p>Aktivitete relaksuese me përmbajtje gjithëpërfshirëse;</p> <p>Ekipi identifikues dhe vlerësues në nivel komunal;</p> <p>Prodhimi i materialeve alternative mësimore të përshtatura sipas nevojave individuale.</p>

	<p>Kurrikula e re e Kosovës në gjithëpërfshirje; Dhe 8 orë punë praktike (Detyrë shtëpie) Programi i trajnimit përfshin 6 ditë trajnimi nga 8 orë: që do të thotë se, çdo pjesëmarrës ka 48 orë trajnim direkt dhe 8 orë punë praktike – pjesëmarrësit që përfundojnë detyrën praktike do të certifikohen dhe në fund të programit të trajnimit merr 56 orë trajnim.</p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Metodologjia e realizimit të programit trajnues do të jetë një gërshetim i punës në grupe dhe individuale, përmes disa veprimtarive, siç janë: <i>studim rasti, strategji reflektimi dhe strategji veprimi</i>. Shumicën e aktiviteteve të kryhen praktikisht gjatë programit trajnues</p>
Certifikimi	<p>Pjesëmarrësit do të certifikohen sipas vijueshmërisë (mbi 80%) dhe sipas përfundimit të suksesshëm të detyrave.</p>
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<p>Dott. Mag. Arben Zabeli Dr. Bujar Thaçi Mr. Vjollca Osmani Mr. Remzije Osmani Mr. Shqipe Rexhepi Mr. Mimoza Zhara Mr. Burim Sylejmani Mr. Ardita Voca Prof. Nehat Duraku Prof. Mergime Kuçi</p>
Data e aplikimi	<p>14.12.2023</p>

Titulli i Programit:	Identifikimi i problemeve shëndetësore të fëmijëve në kopsht dhe në shkollë
Titulli i organizatës:	QEHT "KONICA"
Tipi i programit:	Program plotësues
Ofertuesi i programit:	QEHT "KONICA"
Adresa:	rr. Muharrem Fejza, p.n. Prishtinë
E-mail:	qeht.konica@gmail.com
Telefoni:	049 328 528
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr. 141/2024, date 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	26.02.2025
Numri dhe data e aprovimit të programit:	nr. 72/72, datë 10.06.2022
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	26.02.2025
Kohëzgjatja e programit(orë)	32
Përfituesit:	Mësimdhënësit e arsimit parauniversitar
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Në fund të këtij programi mësimdhënësit do të jeni në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të familjarizohen me sëmundjet më të shpeshta të fëmijëve / nxënësve; 2. Të identifikojnë problemet shëndetësore të fëmijëve / nxënësve; 3. Ta japin ndihmën e parë në klasë për fëmijët / nxënësit që manifestojnë probleme shëndetësore; 4. Ta referojnë sëmundjen e fëmijës / nxënësit te prindërit në fazë të hershme të saj, në mënyrë që të parandalohet / shërohet sëmundja me kohë.

Përmbajtja:	<p>Programi i trajnimit të mësimdhënësve <i>Identifikimi i problemeve shëndetësore të fëmijëve në kopsht dhe klasë</i>, përbëhet nga 3 module të cilat realizohen në 3 ditë trajnimi. Secili modul, përfshinë edhe detyra dhe këshilla praktike. Moduli i katërt përfshin pjesën e monitorimit.</p> <p>Dita e parë e trajnimit: Moduli 1: Problemet shëndetësore akute të fëmijëve</p> <p>Dita e dytë e trajnimit: Moduli 2: Problemet shëndetësore kronike</p> <p>Dita e tretë e trajnimit: Moduli 3: Problemet shëndetësore mentale</p> <p>Moduli 4: Monitorimi i edukatoreve / mësimdhënësve për identifikimin e problemeve shëndetësore.</p>
Metodat e realizimit të programit	<ul style="list-style-type: none"> • Ligjërime • Prezantim me Powerpoint • Shembuj praktikë përmes detyrave gjatë trajnimit; • Ushtrime • Aktivitete atraktive • Kombinim i materialeve tekst dhe video.
Certifikimi	PO
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	Dr. Rita Qarkaxhija Dr. Nita Ymeraga
Data e aplikimi	

Titulli i Programit:	Kontekstualizimi i Qasjes Reggio Emilia në Kosovë. Perspektiva dhe dialogu
Titulli i organizatës:	Instituti Për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA) – Fakulteti I Edukimit - UP
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	Instituti Për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA) – Fakulteti I Edukimit - UP
Adresa:	Fakulteti i Edukimit Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Rr. Agim Ramadani, nr. 350, 10000 Prishtinë, Kosovë
E-mail:	blerim.saqipi@uni-pr.edu
Telefoni:	+ 383 38 22 92 01
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	/
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	/
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr. 104/2024 Datë: 13.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr. 104/2024 Datë: 13.02.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	150 orë
Përfituesit:	Ky program i zhvillimit dhe aftësimit profesional u dedikohet të gjitha edukatoreve që punojnë me fëmijët nga mosha 6 muaj deri në 6 vjeç dhe profesionistëve të fushës së edukimit në fëmijëri të hershme, të cilët janë të gatshëm të avancojnë praktikat e tyre të punës.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20-25 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<ul style="list-style-type: none"> • Demonstrjnë një kuptim sistematik të mënyrës se si qasja Reggio Emilia përkufizon fëmijët dhe rolin e edukatorëve në zhvillimin e potencialit maksimal të fëmijëve. • Shkathtësohen për të zhvilluar aktivitete që bazohen në interesat e secilit fëmijë dhe për të parashtruar pyetje në vazhdimësi për t'i angazhuar më tej fëmijët në realizimin e aktivitetit

- Analizojnë mënyrat konkrete të punës me fëmijët dhe rëndësinë e planifikimit reflektiv për të jetësuar filozofinë Reggio Emilia në mjediset e të nxëniet të hershëm dhe në kontekst të marrëdhënieve me fëmijët dhe familjet.
- Vlerësojnë përfitimet të cilat mund t'i arrijnë për zhvillimin e tyre profesional, zhvillimin e fëmijëve, dhe bashkëpunimin me akterët e tjerë relevant.
- Krijojnë shembuj konkret në punën e tyre me fëmijët dhe i dokumentojnë në forma të ndryshme, rezultatet e arritura, përmes aplikimit të qasjes së Reggio Emilia në kopshtet ku punojnë.
- Ngrisin hipoteza për projekte të reja dhe planifikojnë situata provokuese/skenare për fëmijët duke u bazuar në analizën e vëzhgimit dhe dokumentimit.
- Reflektojnë mbi rëndësinë e kurrikulës emergjente e cila ndërtohet mbi bazën e interesave, dëshirave dhe potencialeve të fëmijëve dhe krijojnë mundësi që fëmijët të jenë pjesëmarrës aktiv në planifikimin dhe organizimin e projekteve të thella.
- Praktikojnë njohjen me materialet duke eksportuar përdorimi shumëdimensional të tyre.
- Praktikojnë përgatitjen e mjedisit me mjete dhe materiale përmes të cilave krijojmë një kontekst të të nxëniet inspiruar sipas qasjes Reggio Emilia.
- Diskutojnë me grupin dhe reflektojnë për ndryshimet që mund të ndërmarrin në mjediset e dhomave/klasëve të tyre apo institucionit parashkollor në mënyrë që fëmijët të jenë protagonistët kryesor të të nxëniet të tyre.
- Dokumentojnë ndryshimet në krijimin e konteksteve të të nxëniet ofruar fëmijëve të përgatitura në mjediset ku ata/ato punojnë.
- Zhvillojnë të kuptuarit mbi rëndësinë e përdorimit të vëzhgimit, regjistrimit dhe dokumentimit të të nxëniet të fëmijëve për të dëshmuar të nxëniet e tyre.
- Përdorin vëzhgimin dhe dokumentimin si mjete për të zhvilluar të nxëniet e fëmijëve të vegjël.
- Anlizojnë ciklin e dokumentimit dhe stimulojnë situata të reja të të nxëniet;
- Kenë zhvilluar një pasqyrë të formave të ndryshme të përfshirjes së prindërve dhe komunitetit dhe të reflektojnë në mënyrë kritike mbi zbatimin e kësaj qasjeje në praktikën e kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme.
- Eksplorojnë efektet e përfshirjes aktive të prindërve dhe komunitetit në

	përvojën edukative të fëmijës
Përmbajtja:	<p>Programi i trajnimit është i dizajnuar që të bëjë një ndërlidhje të pjesës teorike me pjesën praktike që do të zhvillohet në institucionet parashkollore të cilat e aplikojnë qasjen Reggio Emilia. Poashtu përmes të ftuarve, viziatave dhe shkëmbimeve pedagogjike të cilat janë të parapara përgjatë moduleve.</p> <p>Ndër aktivitetet e mundëshme që pritet të realizohen janë :</p> <p>Ligjerime dhe diskutime interaktive, Punë individuale në çifte dhe grupore, Observime dhe reflektime, Praktikim i shkathtësive, Shkëmbim i eksperiencave, Vizita, etj.</p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Programi do të ofrohet në bashkëpunim të ngushtë me Institucionet Parashkollore të cilat janë përfituese nga projekti PEDAKOS dhe me të cilat Fakulteti i Edukimit ka bashkëpunim të vazhdueshëm. Në module është paraparë që një pjesë e modulit të mbahet në Fakultetin e Edukimit në hapësirën e cila është dizajnuar nga projekti PEDAKOS dhe një pjesë tjetër të zhvillohet praktikisht në ndonjërin nga institucionet parashkollore.</p> <p>Një lidhje në mes të pjesës teorike dhe asaj praktike si dhe harmonizimi i asaj që shtjellohet me kontekstin ku ajo do të realizohet, do të mundësojë një të kuptuar më të thellë të Qasjes Reggio Emilia. Kjo poashtu do të mundësojë një reflektim më të thelluar mbi atë sesi mund të përdoret kjo qasje për të avancuar praktikën aktuale të punës në Institucion parashkollor.</p> <p>Ndër format e punës që do të përdoren:</p> <p>Diskusime interaktive, Punë individuale në çifte dhe grupore, Observime dhe reflektime, Praktikim i shkathtësive, Shkëmbimi i eksperiencave, Vizita, etj.</p>
Certifikimi	Po.
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<p>4-10 trajner</p> <p>Majlinda Gjellaj Arlinda Beka Blerta Perolli Shehu</p>

	Rozafa Shala Edukatoret të cilat janë të trajnuara nga projekti PEDAKOS
--	--

Titulli i Programit:	Krijimi i Komunitetit të të nxëniet demokratik dhe gjithëpërfshirës
Titulli i organizatës:	Këshilli i Evropës
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	Këshilli i Evropës
Adresa:	Bedri Pejani 17/18 Prishtinë
E-mail:	coe.pristina@coe.int
Telefoni:	+383 (0) 38 407 750 dhe +383 (0) 38 407 751
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	N/A
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	N/A
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr 109/109 13.06.2022
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr 109/109 13.06.2025
Kohëzgjatja e programit(orë)	48 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit/et e shkollave të rregullta, edukatorët/et, psikologët/et dhe personeli tjetër mësimdhënës i shkollës.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	30
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pjesëmarrësit: <ul style="list-style-type: none"> • Aftësohen lidhur me metodologjitë e bazuara në përvojën e Këshillit të Evropës në fushën e demokracisë, të cilat mund të kenë përdorim praktik në aktivitetet që mund të organizohen në nivel shkolle, bazuar në një qasje që përfshinë gjithë shkollën; • aftësohen për të mbështetur shkollat në krijimin e një kulturë

	<p>demokratike, përmes zbatimit të qasjeve gjithëpërfshirëse, bazuar në standardet dhe praktikatat e Këshillit të Evropës;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbështetësin shkollën në angazhimin aktiv ndaj proceseve të zhvillimit, me idenë e ndërtimit të një kulture demokratike dhe gjithëpërfshirëse në shkollë dhe realizimit të një procesi zhvillimor me pjesëmarrje; • Ndërgjegjësohen për rolin dhe përgjegjësitë që kanë rreth dukurisë së bullizmit në shkolla dhe shoqëri ; • Marrin rol aktiv për të reaguar në mënyrë konstruktive ndaj bullizmit; • Ndërgjegjësohen për ndikimin e ambientit në mirëqenien e fëmijëve.
Përmbajtja:	<p>Programi i këtij trajnimi përmban një pako prej dy materialeve të cilat janë zhvilluar enkas për qëllimet e këtij programi të trajnimit:</p> <p>1. Manuali i trajnerëve</p> <p>Manuali i trajnerëve së bashku me prezantimin PPT ndihmojnë trajnerët të përkrahin shkollat sipas temave të paracaktuara në 3 ditë punë me nga 4 seanca.</p> <p>Dita 1</p> <p>Ndërtimi i ekipit, profil shkollor demokratik dhe gjithëpërfshirës, njohuri themelore rreth fakteve kryesore të përfshirjes.</p> <p>Dita 2</p> <p>Reflektimi dhe raportimi për sukseset e para. Njohja me elementet kryesore në lidhje me adresimin e bullizmit, dhe të kuptuarit si dhe përdorimi i Kornizes së referencës së Këshillit të Evropës për zhvillimin e kompetencave për kulturë demokratike /Council of Europe Reference Framework for Competences on Democratic Culture (RFCDC)</p> <p>Dita 3</p> <p>Prezantimi i posterit kundër bullizmit dhe planifikimi i një jave të veprimi kundër bullizmit.</p> <p>Njohja me faktorët kryesorë për një planifikim të mirë gjithëpërfshirës</p> <p>Dita 4</p> <p>Prezantimi i projektit mjedisor me potencial gjithëpërfshirës dhe demokratik.</p> <p>Seanca mësimore praktike si provë e zhvillimit personal.</p> <p>2. Materiali mbështetës për mësimdhënës.</p> <p>Materiali mbështetës për mësimdhënës është udhërrëfyes për pjesëmarrësit</p>

	me shumë materiale të nevojshme sipas temave të paracaktuara dhe në pjesën e fundit ka materialet konkrete për zbatimin e aktiviteteve të cilat do të mbështesin mësimdhënësin në arritjen e qëllimeve të programit në praktikën e tyre të përditshme.
Metodat e realizimit të programit	<p>Trajnerët e përzgjedhur me kritere të caktuara, janë përgatitur paraprakisht për të ofruar këtë trajnim. Përmes zhvillimit profesional me bazë në shkollë, pjesëmarrësit e këtij trajnimi, do të marrin pjesë në gjashtëmbëdhjetë sesione me kohëzgjatje 90 minutave (6 orë të plota për ditë), të moderuara me trajnerët.</p> <p>Pastaj, një kohë e caktuar dedikohet për zbatim të njohurive të trajnimit, me nxënës, kolegët tjerë në shkollë dhe reflektim me trajnerë, e që në kuptim kohor është ekuivalente me 16 sesione tjera 90 minutëshe (24 orë tjera).</p> <p>Trajnimi është i dizajnuar ashtu që të mund të ofrohet në sallë trajnimi ose në mënyrë virtuale nga distanca përmes platformave elektronike, duke përfshirë ndërveprim, plane dhe projekte mësimore, aktivitete me nxënës, prezantime, diskutime, punë individuale, dhe punë në ekip me kolegët tjerë mësimdhënës. Gjatë kësaj periudhe pjesëmarrësit mbështeten nga trajnerët për këtë program, përmes këshillave dhe poashtu observohen gjatë procesit mësimor, që të përkrahen deri në përmbushjen e kërkesave për certifikim.</p>
Certifikimi	Secili kandidat që ka ndjekur së paku 30 orë trajnimi mund të pajiset me certifikatë
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	Tetë (Hana Zylfiu-Haziri, Gazmend Tahiraj, Remzije Krasniqi, Alida Thaqi, Driton Berisha, Jehona Xhaferi, Vllaznim Balidemaj, Veton Sylhasi,)
Data e aplikimi	23.09.2022

Titulli i Programit:	Krijimi, zbatimi dhe monitorimi i suksesshëm i PIA-së për të përmirësuar mësimnxënien e nxënësve me nevoja
Titulli i organizatës:	Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje – QPGJ - OJQ
Tipi i programit:	Krijimi, zbatimi dhe monitorimi i suksesshëm i PIA-së për të përmirësuar mësimnxënien e nxënësve me nevoja
Ofertuesi i programit:	Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje - QPGJ
Adresa:	Veternik p.n., Prishtina, Kosova
E-mail:	info@qendraprofesionale.org
Telefoni:	+383 49 183 156
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	65/2024 – 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	65/2024 – 26.02.2025
Numri dhe data e aprovimit të programit:	65/2024 – 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	65/2024 – 26.02.2025
Kohëzgjatja e programit(orë)	20 orë
Përfituesit:	Përfituesit e programit përfshijnë një gamë të gjerë mesimdhënësish nga të gjitha nivelet dhe shkollat parauniversitare, duke përfshirë edukatorët, shkolla fillore, të mesme të ulta dhe larta, gjimnaze dhe ato profesionale.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20 deri në 25 mesimdhënës për grup
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Rritja e Njohurive Profesionale:</p> <p>Aktivitetet e Programit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hyrje mbi Planin Individual të Arsimit (PIA); qëllimi dhe rëndësia; përpilimi dhe zbatimi i PIA tek fëmijët me nevoja të veçanta arsimore - Kuptimi i pjesëve integrale dhe përmbajtësore të PIA në përpilimin, zbatimin, dhe vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore

Rezultatet e Pritshme:

Zhvillimin e njohurive dhe aftësive profesionale tek mësimdhënësit në akseptimin e informacioneve dhe njohurive profesional, të përdituara dhe profilizuara për profesionistët që punojnë me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore rreth Planit Individual të Arsimit (PIA).

Aftësimi i tyre në identifikimin e nevojave të veçanta të secilit fëmijë, zhvillimin e kompetenës, dhe përdorimin e teknologjisë së avancuar në arsim.

Aktivitetet e Programit:

- Krijimi i PIA: qëllimet, objektivat, dhe aktivitetet për të përmirësuar mësimdhënien dhe përmbushur nevojat e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore

- Përdorimi i strategjive dhe burimeve të specializuara për të mbështetur PIA

-Përfshirja e teknologjisë në përpilim, zbatim, dhe vlerësim të PIA

- Prezantim dhe diskutim i evidencave empirike mbi përpilimin, zbatimin, dhe vlerësimin e PIA

Rezultatet e Pritshme:

Ngritja shkathtësiv dhe aftësive për përpilimin e planit individual për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, përfshirë përcaktimin e objektivave, strategjitë e mësimin, dhe vlerësimin e progresit.

Zbatimi dhe Përshtatja e Metodave:**Aktivitetet e Programit:**

Zbatimi i PIA në praktikë: rregullimi i mësimin dhe vlerësimi i përparimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore si dhe përgatitja e një mjedisi të përkrahjes dhe bashkëpunimi me prindërit dhe stafin shkollor për të implementuar PIA

- Menaxhimi i dokumentacionit dhe monitorimi i suksesit të PIA për të siguruar përmirësimin e mësimnxënies së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore

- Rishikimi dhe ristrukturimi i PIA sipas nevojave të ndryshme të fëmijëve

- Diskutim panel: Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave nga ekspertët e fushës

Rezultatet e Pritshme:

Zhvillimi i strategjive mësimore të personalizuara që synojnë të ndihmojë profesionistët të kuptojnë dhe të zbatojnë praktikat e përshtatshme të mësimin për përmirësimin qasjen ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

	Kuptimi i thellë i strategjive dhe burimeve të specializuara për të mbështetur PIA
Përmbajtja:	<p>Përmbajtja e programit është strukturuar në mënyrë të gjerë për të përmbushur nevojat e profesionistëve që janë të përfshirë në trajnim. Fillimi i programit ofron një hyrje të detajuar mbi planin individual qëllimin dhe rëndësinë; përpilimin dhe zbatimin e PIA-s tek fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, më pas përdorimin e strategjive dhe burimeve të specializuara për të mbështetur PIA-n e deri te rregullimi i mësimi dhe vlerësimi i përparimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe përgatitjen e një mjedisi përkrahës dhe bashkëpunimi me prindërit dhe stafin shkollor për të implementuar PIA-n.</p> <p>Aktivitetet praktike përfshijnë ligjerata, prezantime, diskutime paneli, punë individuale, grupe, analiza rastesh dhe zgjidhje të problemeve. Këto aktivitete inkurajojnë pjesëmarrësit të aplikojnë njohuritë e fituara në situata reale dhe të ndajnë përvojën dhe praktikën e tyre me kolegët.</p> <p>Objektivat e programit synojnë rritjen e njohurive profesionale duke ofruar informacion dhe njohuri të përditësuara, prezantimin e metodave dhe strategjive të avancuara për zhvillimin funksional të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, si dhe inkurajimin dhe aftësimin e profesionistëve për zbatimin e këtyre metodave në praktikë. Bashkëpunimi me prindërit dhe menaxhimi i sjelljeve të papërshtatshme gjithashtu përfshihen si elementë kyç në trajnim, për të siguruar një përmirësim të përgjithshëm të aftësive dhe njohurive të profesionistëve në këtë fushë.</p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Metodologjia e përdorur gjatë ofrimit të programit trajnues është e karakterizuar nga një qasje holistike dhe interaktive, duke kombinuar disa metoda efektive të mësimi.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligjeratat dhe prezantimet do të përdoren për të sjellë një hyrje të detajuar në temat kryesore të trajnimit dhe për të krijuar një kornizë konceptuale për pjesëmarrësit. Diskutim panelet me kolegët kanë shërbyer për prezantimin dhe diskutimin e evidencave empirike mbi sfidat në përpilimin e një plani individual të mirëfillt dhe të përshtatshëm për fëmijët me novaja të veçanta arsimore, duke synuar përmirësimin e kuptimit mbi temat komplekse që tangojnë mësimdhënësit. - Puna në grup do të përdoret me qëllim inkurajimi të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave midis pjesëmarrësve. Ky format ka për qëllim

	<p>përmirësimin e aftësive të tyre për të aplikuar konceptet teorike në situata reale.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i rasteve studimore do të ndihmojë në paraqitjen e sfidave reale dhe skenarëve të ngjashëm me ato të përditshme në profesionin e tyre, duke synuar forcimin e aftësisë për të zgjidhur probleme specifike. - Aktivitetet e zgjedhjes së problemeve kanë qëllim për të inkurajuar pjesëmarrësit të identifikojnë dhe zgjidhin sfida të caktuara në punën e tyre, duke promovuar një qëndrim proaktiv dhe zgjidhje inovative. Metodologjia e programit është fokusuar në pjesëmarrjen aktive, duke përfshirë shkëmbimin e përvojave, diskutimet interaktive dhe situata praktike për të siguruar një përvojë të pasur dhe të aplikueshme. Për më tepër, qasja multidisiplinore dhe përfshirja e ekspertëve të fushës synon të kontribojë në një trajnim holistik dhe të përshtatshëm për profesionistët që janë të përfshirë në punën e tyre me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.
Certifikimi	Se paku 80% pjesëmarrje ne sesionet e planifikuara
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	Dr. Natyra Agani Destani, Dr. Ereblir Kadriu, Arbesa Uka, Genta Jahiu, Blerina Bytyqi, Ilirjana Mehmeti
Data e aplikimi	Dhjetor 2023

Titulli i Programit:	Integrimi i edukimit për qëndrueshmëri në klasa
Titulli i organizatës:	Instituti Për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA) – Fakulteti I Edukimit - UP
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	Instituti Për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA) – Fakulteti I Edukimit - UP
Adresa:	Fakulteti i Edukimit Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Rr. Agim Ramadani, nr. 350, 10000 Prishtinë, Kosovë
E-mail:	blerim.saqipi@uni-pr.edu
Telefoni:	+ 383 38 22 92 01
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	/
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	/
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr. 140/2024 Datë: 16.01.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr. 140/2024 Datë: 16.01.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	16 orë
Përfituesit:	Ky trajnim synon mësimdhënës nga këto fusha: - Edukatore të fëmijërisë së hershme (kopshteve dhe çerdheve) - Mësimdhënës të ciklit fillor (që mbajnë të gjitha lëndët), - Mësimdhënës lëndor të fushave: gjuhë e komunikimi, arte, matematikë, shkenca natyrore, shkenca shoqërore.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	15-20 mësimdhënës/edukatorë.
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<ul style="list-style-type: none"> definojnë dhe shpjegojnë konceptet kyçe të zhvillimit të qëndrueshëm dhe edukimit për zhvillimin e qëndrueshëm në kurrikulën zyrtare; aplikojnë qasjen e 4 Mënyrave të të Menduarit (Four Eays of Thinking): të menduarit për të ardhmen, të menduarit strategjik, të menduarit sistematik dhe të menduarit në vlera;

	<ul style="list-style-type: none"> të përgatisin aktivitete mësimore bazuar në katër mënyrat e të menduarit dhe të menduarit me standarde; integrojnë tema të caktuara nga lista e “100 temave të qëndrueshmërisë” në planprogramet e tyre mësimore; të dizajnojnë aktivitete mësimore me qasje të integruar ku qëndrueshmëria integrohet në lëndët e tyre respektive gjatë mësimit.
Përmbajtja:	<p>Në fund të kompletimit të përmbajtjes online të kursit, pjesmarrësit do të jenë në gjendje të:</p> <p>zbatojnë kurrikulë e re të bazuar në kompetenca- përfshirë atë me qasje të mësimdhënies së integruar me qëndrueshmërinë si fokus;</p> <p>bëjnë zhvillimin e përmbajtjeve të reja (tema të integruara të qëndrueshmërisë) dhe metoda të reja pedagogjike;</p> <p>zhvillojnë shkathtësi të mendimit kritik- përmes zhvillimit dhe aplikimit të kornizës së 4 mënyrave të të menduarit tek pjesmarrësit dhe nxënësit e tyre;</p> <p>shfrytëzojnë teknologjinë përmes ndjekjes së trajnimit online dhe përgatitjes së përmbajtjeve mësimore online;</p> <p>aplikojnë planifikimin e orës me qasjen e integruar të qëndrueshmërisë;</p> <p>menaxhimin e klasës përmes aktiviteteve praktike që lidhin qëndrueshmërinë me mësimdhënien;</p> <p>motivojnë nxënësit për të menduar se si vendimet dhe veprimet e tyre të sotme mund të ndikojnë në të ardhmen të shoqërisë që i takojnë.</p> <p>Përveq këtyre nga pjesmarrësit pritet që të:</p> <p>Mësojnë dhe vendosin mbi Katër Mënyrat e të Menduarit të domosdoshëm për qëndrueshmërinë;</p> <p>Përfundojnë dy aktivitete në lidhje me standardet e të nxënit dhe kurrikulën e integruar;</p> <p>Lidhen me mësimdhënës të tjerë dhe qasen në kurrikulën e qëndrueshmërisë të hartuar nga të tjerë nga i gjithë vendi</p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Përmbajtja e kursit trajnuar ka filluar të përgatitet para se Pandemi Covid 19 ta shtyjë sistemin arsimor kosovar në formën online. Trajnimi ofrohet në formën online dhe si i tillë do të kursej pjesmarrësit e nga udhëtimi nga qendrat tjera, humbja e orëve të punës, shpenzimet e udhëtimit dhe të tjera.</p> <p>Sesionet e trajnimit do të jenë të kombinuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takime virtuale në Google meet për diskutimin e njohurive dhe e detyrave; - Disuktime e debate të pjesmarrësve me trajnerët dhe mes vete në platformën Padlet - Shkarkimi i videove online në gjuhën shqipe për përgatitjen e aktiviteteve mësimore nga edukatorët; - Shkarkimi i formave online (formularëve, planeve mësimore etj) përdetyrat e

	dhëna për pjesmarrësit ; - Prezantimi i aktiviteteve të integritit të temave të qëndrueshmërisë në klasat e tyre.
Certifikimi	Po.
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	2 trajner Dr.Zeqir Veselaj Dr. Blerta Perolli-Shehu

Titulli i Programit:	Intervenimi i hershëm te fëmijët e verbër dhe me dëmtime pamore
Titulli i organizatës:	Qendra Burimore për mësim dhe këshillim “Xheladin Deda”
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Qendra Burimore për mësim dhe këshillim “Xheladin Deda”
Adresa:	Rruga Bill Klinton, nr. 183 Pejë
E-mail:	shvqb.peje@gmail.com
Telefoni:	+383 39 410 355
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	N/A
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	N/A
Numri dhe data e aprovimit të programit:	26.02.2024 Nr. 02/2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	26.02.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	Minimumi 16 orë (dy ditë)
Përfituesit:	Ky trajnim është i paraparë për mësimdhënësit e të gjitha niveleve: parashkollor, fillor, mesëm i ultë dhe i mesëm i lartë në institucionet arsimore në Kosovë, në ato institucione që kanë, apo që do të pranojnë të regjistrojnë fëmijë të verbër dhe me dëmtime në të parë.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Trajnimi mbahet me pjesëmarrje direkte në grupe deri në 20 persona.
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Mësimdhënëset që kryejnë këtë trajnim: <ul style="list-style-type: none"> - Punojnë me fëmijë të verbër dhe që janë të integruar në institucione parashkollore - Marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e Planit Individual të arsimit dhe Planin Individual të rehabilitimit

	- Bashkëpunojnë dhe këshillojnë prindërit e fëmijëve të verbër me dëmtime në të parë
Përmbajtja:	<p><i>Programi "Intervenimi i hershëm të fëmijët e verbër dhe me dëmtime në të parë"</i> përbëhet prej 7 kapitujve:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Intervenimi i hershëm të fëmijët me dëmtime në të parë 2. Bashkëpunimi me prindin, marrja e informatave, krijimi i dosjes dhe hartimi i planit individual 3. Formimi i mjedisit që stimulon shikimin 4. Metodrat dhe testet mësimore 5. Vlerësimi i aftësive të fëmijë me "Oregon" 6. Metoda "Feel Free" 7. Loja dhe kategoritë e lojës
Metodat e realizimit të programit	<p>Trajnimit mbahet me pjesëmarrje direkte në grupe deri në 20 persona. Trajnimi është interaktiv dhe përmban pjesë teorike të prezantimeve dhe punën praktike individualisht dhe në grupe që bëhet nga pjesëmarrësit në trajnim. Një pjesë e trajnimit konsiston në materialet që prezantohen dhe demontohen para pjesëmarrësve të trajnimit, duke përfshirë mjete punë, instrumente, metoda të cilat demonstrohen në punën konkrete me fëmijën. Grupet për trajnime krijohen në bazë rajonale duke mbledhur grupe mësimdhënësish nga disa komuna të rajonit, në mënyrë që së paku në çdo komunë të ketë së paku një institucion parashkollor që ka staf të trajnuar për ofrimin e shërbimeve për fëmijët e moshës 0-6 vjeç.</p>
Certifikimi	Certifikatë e trajnimit
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<p>Ilirjana Shehu, Ekspert i intervenimit të hershëm për fëmijët e verbër Enver Ulaj, Koordinator i Qendrës së trajnimeve Shfqet Mulliqi, Tiflopedagog, dr sc. i edukimit special Ganimete Sejdiu, Mësimdhënëse</p>
Data e aplikimi	06.12.2023

Titulli i Programit:	Komunikimi jo i dhunshëm
Titulli i organizatës:	Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
Adresa:	Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë
E-mail:	office@kec-ks.org
Telefoni:	038/244-257, lok. 109
Numrat dhe data e akreditimit:	Nr. 110/2024 Data: 26.02.2024
Kohëzgjatja e programit(orë)	Programi i trajnimit "Komunikim jo i Dhunshëm" i ka 20 orë të trajnimit të cilat ofrohen përmes trajnimit 2-ditor (16 orë trajnimi) me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë dhe koha e angazhimit për përmbushjen e detyrave që lidhen me rezultatet e programit të trajnimit (4 orë trajnimi).
Përfituesit:	Synimi i programit është përfshirja e të gjithë aktorëve të shkollës (menaxhmenti i lartë, menaxhmenti i mesëm, mësime dhënësit, administratorët, shërbyesit e këshillimit, nxënësit dhe prindërit), si temë e rëndësishme për të gjithë e me theks për mësime dhënësit si personat me më shumë ndikim në jetën e shkollës, të cilët janë në shërbim në arsimin parauniversitar, si dhe duke u zgjeruar edhe për mësime dhënësit universitarë.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	18-24
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pjesëmarrësit në këtë program trajnues do të arrijnë rezultatet si në vijim: <ul style="list-style-type: none"> - Identifikojnë rëndësinë e zhvillimit të shkathtësisë së komunikimit personal dhe të nxënësve; - Vëzhgojnë situatat gjatë komunikimit pa gjykuar dhe pa vlerësuar; - Analizojnë katër komponentë kryesorë në procesin e komunikimit Gjirafë si: vëzhgimin, ndjenjat, nevojat dhe kërkesat; - Dallojnë gjuhën Xhaka gjatë analizimit të shembujve të kontekstit shkollor; - Zbatojnë shembuj të gjuhës Gjirafë kundrejt gjuhës Xhaka; - Riformulojnë mënyrën e të shprehurit përmes dëgjimit në mënyrë aktive dhe parashtrimin të kërkesave për bashkëbiseduesin nisur nga shembujt personalë pa përdorur urdhra;

	- Vlerësojnë në ekip karakteristikat e gjuhës Gjirafë që ndihmojnë shmangien e konflikteve të cilat rrjedhin nga komunikimi Xhaka.
Përmbajtja:	<p>Programi i këtij trajnimi përmban një pako me materiale të larmishme në funksion të përgatitjes sa më të mirë të pjesëmarrësve, me theks mësimdhënësve e drejtorëve për promovimin e komunikimit jo të dhunshëm në shkollë. E ashtuquajtura Gjuha Gjirafë apo Gjuha për Jetën (Language For Life) ndihmon në reflektimin e individit për përmirësimin e komunikimit efektiv dhe të respektueshëm me theks në ndjeshmëri, dëgjim aktiv dhe mirëkuptim, përmes së cilës të gjithë aktorët e shkollës do të ngritin kompetencën e komunikimit dhe do t'i kontribuojnë jetës më të lumtur në shkollë. Edhe pse programi përqendrohet në punën me mësimdhënës e drejtorë/zëvendës-drejtorë të arsimit parauniversitar, materiali është i përshtatshëm dhe mund të përdoret mjaft mirë edhe me aktorë të tjerë të shkollës dhe me mësimdhënës universitarë, si përkrahje për përmirësimin e komunikimit edhe në atë nivel arsimit.</p> <p>Prioritet i programit është një ndër kompetencat themelore siç është ajo e të shprehurit dhe komunikimit, dhe e cila përcillet nga disa shkathtësi si: <i>shkathtësia e të folurit të rrjedhshëm e të saktë, e të dëgjuarit aktiv, e të menduarit kritik e kreativ, inteligjenca emocionale, ndërgjegjshmëria, dhe ajo e zgjidhjes së problemeve</i>, që do të ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e mësimdhënësve për kontekste të ndryshme kohore dhe vendore duke ndikuar së shumti edhe në zhvillimin e këtyre komponentëve të nxënësit.</p>
Metodat e realizimit të programit:	<p>Trajnimi 2-ditor ka gjithsej 8 sesione. Secili sesion zgjatë 90 minuta, plus 4 orë të kalkuluara për vëzhgim në vendin e punës (orë mësimore, takime diskutimi, punë me palë) dhe për takime reflektuese/planifikuese dhe zbatim të komponentëve të komunikimit jo të dhunshëm).</p> <p>Kursi është i dizajnuar ashtu që të mund të ofrohet në sallë trajnimi ose virtualisht nga distanca përmes platformave elektronike. Kjo përfshin ligjërime, demonstrime, bashkëpunim, realizim me nxënës, me prindër, me kolegë të tjerë në shkollë, prezantime, diskutime, punë individuale, dhe punë në grup me kolegët tjerë mësimdhënës. Tërë procesi i trajnimit shtrihet në afat kohor prej 2-3 javësh. Gjatë kësaj periudhe pjesëmarrësit do të mentorohen përmes komunikimit elektronik nga fasilituesit e programit, që të përkrahen në përmbushjen e kërkesave për certifikim.</p>
Certifikimi:	Në fund të këtij trajnimi pjesëmarrësit: mësimdhënësit/ drejtorët (apo edhe palët e propozuara) do të certifikohen duke u kredituar me gjithsej 20 orë

	<p>trajnimi (8 sesione x 90 min = 16 orë kontaktuese; plus 4 orë të kalkuluara për vëzhgim në vendin e punës (orë mësimore, takime diskutimi, punë me palë) dhe për takime reflektuese/planifikuese dhe zbatim të komponentëve të komunikimit jo të dhunshëm).</p> <p>Kriteret për certifikim janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Së paku 90% pjesëmarrje në sesionet kontaktuese dhe në takimet reflektuese me fasilitues; - Realizimi i Gjuhës Gjirafë në vendin e punës; - Prezantimi i raportit të praktikimit të komunikimit efektiv në vendin e punës, me palët e interesit.
Trajnerë:	3 trajnerë
Data e aplikimit	15.12.2023

Titulli i Programit:	Lions Quest - Shprehitë për adoloshencën
Titulli i organizatës:	Lions International-Lions Club Peja
Tipi i programit:	Program themelor
Ofertuesi i programit:	OJQ Lions Club Peja
Adresa:	Objekti "Ish Komiteti" pranë administratës qendrore të komunës - Pejë
E-mail:	bekimshoshi1@gmail.com
Telefoni:	+38344281858
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr. 149/2024 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	Nr.149/2024 26.02.2026
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr.51/2024 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr.51/2024 26.02.2026
Kohëzgjatja e programit(orë)	Programi përmban 42 orë trajnimi të drejtpërdrejtë dhe 21 orë detyra dhe projekte: gjithsej 63 orë për certifikim.
Përfituesit:	Përfitues primar :mësuesit fillor dhe të mesëm të ulët Përfitues sekondar :drejtorët e shkollave,pedagog dhe psikolog Përfitues janë të gjithë nxënësit e shkollave dhe mësime të mësimdhënësve pjesëmarrës në trajnim..
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	24 pjesëmarrës në çdo trajnim
Rezultatet e pritura	- Rezultatet e programit janë të ndërlidhura me katër fazat e mësimdhënies të cilat promovohen dhe zbatohen gjatë tërë programit. Rezultatet janë të

<p>ose objektivat e programit:</p>	<p>strukturuara dhe planifikuara si më poshtë: FAZA E PARË: TË ZBULUARIT Rezultati: Zbulohet se çfarë dinë që më parë për temën nxënësit. Mësuesi tregon entuziazëm për temën, nxit interesin e nxënësve, dëgjon aktivisht, tregon respekt për këndvështrimet e ndryshme dhe fillon vlerësimin e dijeve të nxënësve mbi temën.</p> <p>FAZA E DYTË: VENDOSJA E LIDHJEVE 155 Rezultati: Ndërlidhja e dijeve ekzistuese me informacionet dhe shprehite e reja. Përdoren shpjegime të shkurtra, shembuj dhe/ose demonstrime, për të prezantuar dijet dhe shprehite e reja dhe për të modeluar përdorimin e duhur të tyre. Për t'i ndihmuar nxënësit të kuptojnë konceptet përfshihen fletë transparente/diapozitiva, fleta burimore, fleta informative, artikuj dhe tregime. FAZA E TRETË: TË USHTRUARIT Rezultati: Ushtrohen shprehite e reja nën orientimin e mësuesit dhe reflektim mbi ato çfarë kanë mësuar nxënësit. Nxënësit e ushtrojnë informacionin ose shprehinë e re në një kontekst të kuptimtë dhe që ka lidhje me ta. Mësuesi e ndjek me vëmendje veprimtarinë për t'u kujdesur që nxënësit ta kuptojnë informacionin ose shprehinë dhe të mund ta përdorin në mënyrë të saktë. Përmes pyetjeve që kërkojnë përpunim në një nivel më të lartë, mësuesi drejton përdorimin e shprehive, integrimin e dijeve dhe përmbledhjen e ideve më kryesore. FAZA E KATËRT: ZBATIMI Rezultati: Zbatimi i informacionit dhe/ose shprehisë së re në situata të reja. Përmes shkrimit në ditar, nxënësit mendojnë se si do të përdoshin konceptet e reja në jetën e tyre. Veprimtari të tjera ofrojnë mundësi të tjera zbatimi dhe diskutime me persona të rritur në familje dhe shkollë.</p>
<p>Përmbajtja:</p>	<p>Plani i mësimit për "Shprehite për adoleshencën" është një model eklektik i mbështetur në punën e një morie studiuesish dhe mësuesish. Ai mbështetet në këto parime mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mësimi orientohet nga objektivi. Ngaqë nxënësit e presin më mirë mësimin kur e dinë se cili është objektivi i tij, mësuesi u shpjegon objektivin e mësimit dhe arsyet përse po u mëson shprehite dhe dijet konkrete. <p>156 Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mësimi e lidh informacionin e ri me dije të mëparshme. Diskutimet dhe veprimtaritë i ndihmojnë nxënësit të vendosin ura lidhëse midis dijeve ekzistuese dhe informacioneve të reja. • Mësimi zhvillohet me faza, por gjithsesi është rekursiv. Organizimi në trajtë spirale e programit mësimor mundëson përsëritjen dhe përforcimin e shprehive dhe dijeve të reja. • Të mësuarit ndikohet nga zhvillimi. Përmbajtja, qasja dhe ritmi i çdo mësimi ndërtohet në atë mënyrë që të plotësojë nevojat e të rinjve adoleshentë. Në thelb të planit të mësimit qëndron pikëpamja se nxënësit duhen parë si pjesëmarrës aktivë, të cilët e nisnin vetë të mësuarit e tyre në mënyrë të natyrshme, duke u mbështetur në kureshtjen e brendshme të tyre. Theksi vihet te ndërveprimi—një element thelbësor i lidhjes të riut me shkollën (Hawkins, 1999). Të rinjtë punojnë së bashku për të mësuar koncepte, për të ushtuar të menduarit dhe shprehite sociale dhe për të zbuluar përfitimet që u sjell bashkëpunimi në kuadër të arritjes së qëllimit të përbashkët. Katër fazat e mësimit u japin mundësi nxënësve të mbështeten te dijet dhe përvojat e tyre, të inkorporojnë informacionet e reja, të

	<p>ushtrijnë ato që mësojnë, të reflektojnë dhe t'i përdorin informacionet dhe dijet e reja në një larmi situatash të reja. Gjatë trajnimit zhvillohen këto module :</p> <p>MODULI 1(Një komunitet i të mësuarit pozitiv) MODULI 2(Zhvillimi personal) MODULI 3(Zhvillimi social) MODULI 4(Shëndeti dhe parandalimi) MODULI 5(Mësim –shërbimi) MODULI 6(Zbatimi i programit) Dita e shtatë :Çertifíkimi i pjesëmarrësve</p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Modulet e programit sigurojnë informacione bazike lidhur me shtatë temat, ndërlidhjen e tyre me kërkesat e programeve aktuale mësimore (kërkesat kurrikulare) si dhe mundësitë për zbatim të efektshëm në nivel shkollë e klase. Programi trajnues ofrohet gjatë ditëve të fundjavës (kryesisht do të jetë ditën e shtunë) për të mos penguar procesin e rregullt mësimor. Qasja e përzgjedhur ofron mundësi që të gjithë mësimdhënësit e shkollës të jenë të përfshirë, dhe të gjithë së bashku, nën udhëheqjen e një trajneri/fasilituesi, të diskutojnë dhe provojnë ide e forma të ndryshme të zbatimit të temave në mësimdhënien e tyre. Kjo mënyrë e punës dhe e bashkëpunimit ndërmjet kolegëve të shkollës, mundëson shtjellimin e temave të ndryshme profesionale me interes të përbashkët, konsultim formal dhe kolegial të mësuesimdhënësve si dhe mundësi të avancimit profesional të mësuesimdhënësve përmes aktiviteteve me bazë në shkollë. Gjithashtu, modulet mund të përdoren për të monitoruar dhe për të mbështetur mësuesimdhënësit gjatë zbatimit të temave të ndryshme në klasë</p>
Certifíkimi	<p>Certifíkimi bëhet duke u bazuar në kriteret e programit Lions Quest dhe kriteret e trajnimit.Cdo pjesëmarrës duhet të ndjekë me rregull trajnimin shtatë ditore ,të jetë aktiv dhe bashkëpunues me pjesëmarrësit e tjerë gjatë trajnimit,të shkëmbejnë idetë dhe përvojat e tyre rreth metodologjive mësimore dhe të përvetësojnë njohuritë e reja nga programi Lions Quest dhe ato njohuri të jenë në gjendje të i zbatojnë në praktikë gjatë procesit të mësimdhënies në shkollat e tyre.</p>
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<p>Organizata ka 4 trajnere: Gjejlon Begolli, Havë Haxhiaj, Jeta Komoni, Ulla Sirvio Hyttinen</p>
Data e aplikimit	14.12.2023

Titulli i Programit:	Menaxhimi i klasës dhe disiplina
Titulli i organizatës:	QEHT "KONICA"
Tipi i programit:	Program plotësues
Ofertuesi i programit:	QEHT "KONICA"
Adresa:	rr. Muharrem Fejza, p.n. Prishtinë
E-mail:	qeht.konica@gmail.com
Telefoni:	049 328 528
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr. 141/2024, date 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	26.02.2025
Numri dhe data e aprovimit të programit:	nr. 54/2024, datë 26.02.2025
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	26.02.2025
Kohëzgjatja e programit(orë)	16
Përfituesit:	Mësimdhënësit e arsimit parauniversitar
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Çdo mësimdhënës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të jetë në gjendje të ndërtojë besimin, ndjenjat e respektit të ndërsjellë dhe marrëdhënieve midis nxënësve; • Të aplikojë me sukses fazat e formimit të grupit; • Të drejtojë alternimet midisi të gjitha veprimtarive, duke e çuar mësimin drejt një përfundimi të suksesshëm; • Të motivojë nxënësit në qëndrimin e tyre aktiv ndaj të nxënësve;

	<ul style="list-style-type: none"> • Të zhvillojë rregullat në përputhjes me kushtet e klasës dhe arsyetimin e nxënësve; • Të njohë kushtet thelbësore në zhvillimin e mësimit për mendimin kritik; • T'i motivojë nxënësit në krijimin pozitiv të klasës; • Të sigurojë disiplinën në klasë që çon drejt të nxënës të efektshëm; • Të trajtojë dhe të kontrolloj sjelljet e padëshirueshme të nxënësve; • Të fitojë autoritetin e mësimit nxënës;
Përmbajtja:	<p><i>Përmbajtja e programit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Menaxhimi i klasës dhe disiplina; • Grupi dhe fazat e formimit të tij; • Ekologjia e klasave; <ul style="list-style-type: none"> • Karakteristikat e klasave • Fillimi dhe përfundimi i mësimit. Alternimi i veprimtarive në të <ul style="list-style-type: none"> • Fillimi me përpikëri; • Mobilizimi mendor; • Kalimet e qeta; • Përfundimi i mësimit; • Klima e klasës. • Disiplina dhe rregulli në klasë • Shqyrtimi i shkaqeve dhe këshillimi <ul style="list-style-type: none"> • Këshillimi i suksesshëm ; • Përdorimi me sukses i qortimit; • Natyra dhe qëllimi i ndëshkimit; • Të metat e ndëshkimit; • Llojet e ndëshkimit.
Metodat e realizimit të programit	<ul style="list-style-type: none"> • Ligjërime • Prezantim me Powerpoint • Shembuj praktikë përmes detyrave gjatë trajnimit; • Ushtrime • Aktivitete atraktive • Kombinim i materialeve tekst dhe video.
Certifikimi	PO
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	Edi Puka Diana Qarkaxhija
Data e aplikimi	

Titulli i Programit:	Mësimi i shkrimit braj
Titulli i organizatës:	Qendra Burimore për mësim dhe këshillim “Xheladin Deda”
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Qendra Burimore për mësim dhe këshillim “Xheladin Deda”
Adresa:	Rruga Bill Klinton, nr. 183 Pejë
E-mail:	shvqb.peje@gmail.com
Telefoni:	+383 39 410 355
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	N/A
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	N/A
Numri dhe data e aprovimit të programit:	26.02.2024 Nr. 02/2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	26.02.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	30 orw
Përfituesit:	<p>Ky trajnim është i paraparë për mësimdhënësit e niveleve fillor, mesëm i ultë dhe i mesëm i lartë në institucionet arsimore në Kosovë, në ato institucione që kanë, apo që do të pranojnë të regjistrojnë fëmijë të verbër dhe me dëmtime në të parë.</p> <p>Ky grup është i përzgjedhur natyrshëm pasi që këta mësues kanë nevojë të trajnohet për të punuar me fëmijë me nevoja të veçanta, në rastet kur ndodh integrimi nga shkolla speciale në shkollë të rregullt.</p> <p>Këta mësimdhënës që duhet të punojnë me fëmijët e verbër në klasat e tyre më parë kurrë nuk kanë ndjekur trajnime mbi punën me nxënës me nevoja të veçanta arsimore, ndërsa institucioni jonë është i vetmi në Kosovë që</p>

	është i specializuar për këto lloje trajnimi.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Trajnimi mbahet në grupe 10 deri në 15 persona.
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Mësimdhënëset që kryejnë këtë trajnim: <ul style="list-style-type: none"> - Njohin, shkruajnë dhe lexojnë shkrimin braille gjatë punës me fëmijë të verbër - Ua mësojnë shkrimin braille fëmijëve të verbër në shkollat dhe komunat e tyre - Njohin dhe shfrytëzojnë teknologjinë që përdoret në shkrim lexim dhe komunikim për të verbër
Përmbajtja:	Programi “Mësimi i shkrimit braj” është i dizajnuar për mësimdhënësit në shkollat e rregullta në Kosovë dhe përbëhet nga këto tema: <ol style="list-style-type: none"> 1. Shkrimi i braille për personat e verbër 2. Njohja me qasjen e rregullt të gjashtëpikëshit 3. Teknologjia e shkrimit në braille, makina dhe shkrimi elektronik 4. Braille elektronik 5. Veprime matematikore dhe gjuha shqipe 6. Shenjat dhe simbolet 7. Zhvillimi i shkrimit dhe leximit të shkronjave -ushtrime
Metodat e realizimit të programit	Trajnimi mbahet me pjesëmarrje direkte në grupe 10 deri në 15 persona. Trajnimi është interaktiv dhe përmban pjese teorike të prezantimeve dhe punën praktike individualisht dhe në grupe që bëhet nga pjesëmarrësit në trajnim. Një pjesë e trajnimit konsiston në punën praktike dhe ushtrime të shfrytëzimit të makinës së shkrimit në braille dhe në formën elektronike me pjesëmarrësit e trajnimit, duke përfshirë mjete punë, instrumente, metoda të cilat demonstrohen në punën konkrete me fëmijën. Grupet për trajnime krijohen në bazë në komuna apo në një rajon me disa komuna, dhe preferohet të bëhen në bashkëpunim me DKA-të për mësuesit në nivel komuna, apo përmes Divizionit për Gjithëpërfshirje për grupe të kombinuara të mësuesve që duan të marrin aftësimin bazik në këtë fushë.
Certifikimi	Certifikatë e trajnimit
Trajner sa trajner,	Gani Gashi, profesor

emrat e trajnerëve	Ilirjana Shehu, Ekspert i intervenimit të hershëm për fëmijët e verbër
Data e aplikimi	06.12.2023

Titulli i Programit:	Metodologji interaktive e mësimdhënies moderne
Titulli i organizatës:	QEHT "KONICA"
Tipi i programit:	Program plotësues
Ofertuesi i programit:	QEHT "KONICA"
Adresa:	rr. Muharrem Fejza, p.n. Prishtinë
E-mail:	qeht.konica@gmail.com
Telefoni:	049 328 528
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr. 141/2024, datë 26.02.2027
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	26.02.2025
Numri dhe data e aprovimit të programit:	nr. 74/74, datë 10.06.2022
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	10.06.2024
Kohëzgjatja e programit(orë)	32
Përfituesit:	Mësimdhënësit e arsimit parauniversitar
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Në fund të këtij programi mësimdhënësit do të jeni në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shpjegojnë arsyet e përdorimit të metodave interaktive të mësimdhënies 2. Përshkruajnë dhe kuptojnë si të përdorin shumicën e rreth 30 metodave të ndryshme interaktive të mësimdhënies të paraqitura në këtë material. 3. Të planifikojnë orën mësimore me efikasitet në aspektin kohor dhe metodik. 4. Të kenë paraqitje profesionale para nxënësve. 5. Të fitojnë njohuri të përgjithshme mbi organizimin e prezantimeve, strukturimin

Titulli i Programit:	Maximising Learning through Project-Based Learning
Titulli i organizatës:	Shoqata Kosovare e Mësimdhënësve të Gjuhës Angleze- KETNET
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	Shoqata Kosovare e Mësimdhënësve të Gjuhës Angleze- KETNET
Adresa:	Rr. Xhorxh Bush, Nr.31-Fakulteti i Filologjisë PRISHTINË, 10000, Kosovë
E-mail:	ketnetinfo@gmail.com
Telefoni:	
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	/
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	/
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr. 132/2024, 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	26.02.2025
Kohëzgjatja e programit(orë)	Programi i ka gjithsej 12 orë.
Përfituesit:	Mësimdhënësit e gjuhës angleze
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	15 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Si rezultat i këtij programi, mësimdhënësit do të mund të: <ul style="list-style-type: none"> - zhvillojnë mësimdhënie të bazuar në projekte; - bashkëpunojnë me mësimdhënës të lëndëve të tjera për të realizuar projekte të përbashkëta për kohë më të gjatë; - promovojnë konceptin e të mësuarit gjatë gjithë jetës si dhe rëndësinë e bashkëpunimit;

	- bëjnë gjithëpërfshirjen e nxënësve gjatë mësimdhënies.
Përmbajtja:	<p>Programi ka për qëllim zhvillim e mësimi bazuar në projekte. Përmes angazhimit në projekte për një kohë më të gjatë, nxënësit zhvillojnë njohuri të thelluara në një fushë të caktuar, fitojnë shkathtësi kreative dhe analitike, zhvillojnë shkathtësi të zgjidhjes së problemeve, bëhen pjesë të procesit mësimor dhe zhvillojnë shkathtësi të menaxhimit të kohës e bashkëpunimit, shkathtësi këto që janë të rëndësishme edhe për arsimin universitar dhe tregun e punës.</p> <p>Mësimdhënësit do të dalin nga trajnimi me plane konkrete të implementimit të mësimi të bazuar në projekte gjë që rrit efikasitetin e trajnimit dhe ndikon direkt në implementimin e praktikave të reja të mësimdhënies. Pikë e rëndësishme e programit është bashkëpunimi që kërkohet të bëhet në mes të mësimdhënësve të gjuhës angleze dhe lëndëve të tjera, duke bërë kështu këtë program të veçantë. Gjithashtu, pikë kyçe e programit është mentorimi që u bëhet pjesëmarrësve gjatë procesit të trajnimit, gjë që u mundëson pjesëmarrësve të kenë përkrahje të vazhdueshme për implementim sa më efektiv të trajnimit gjatë mësimdhënies.</p>
Metodat e realizimit të programit	Gjatë trajnimit do të përdoren metodologji bashkëkohore që nxisin të menduarit kritik të pjesëmarrësve si: metoda e të nxënësve aktiv (active learning), bashkëveprimi e mësimdhënësve e diferencuar.
Certifikimi	Certifikimi bëhet vetëm për ata mësimdhënës që ndjekin të gjitha orët e trajnimit.
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<p>7 trajnerë:</p> <p>Blerta Mustafa, Zinaide Gruda, Yllkë Paçarizi, Faton Ratkoceri, Miranda Agaj, Rina Krasniqi, Shqipprojë Shala</p>
Data e aplikimi	15.12.2023

Titulli i Programit:	Mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi
Titulli i organizatës:	Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
Adresa:	Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë
E-mail:	office@kec-ks.org
Telefoni:	038/244-257, lok. 109
Numrat dhe data e akreditimit:	Nr. 21/2021 Data: 17.03.2021 Nr. 109/2024 Data: 26.02.2024
Kohëzgjatja e programit(orë)	Në fund të këtij kursi, pjesëmarrësit mësimdhënës do të certifikohen duke u kredituar me gjithsej 8 orë trajnimi.
Përfituesit:	Ky kurs/program trajnimi synon të përfshijë mësimdhënës që janë në shërbim në arsimin para universitar.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20-25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Pjesëmarrësit në këtë kurs/program trajnimi do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruajnë konceptet e mirëqenies së fëmijës dhe mjedisit mik për fëmijët • Përkufizojnë abuzimin, karakteristikat e tij dhe kategoritë dalluese • Identifikojnë instrumentet ligjore për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe raportin e tyre brenda një kornize të përbashkët • Përshkruajnë manifestimin e llojeve të ndryshme të abuzimit; • Identifikojnë shenjat e abuzimeve dhe arsyetojnë dyshimet për ekzistencën e tyre; • Kuptojnë pasojat afatgjata të abuzimit dhe vlerësojnë rrezikun e tyre. • Kuptojnë rëndësinë e organizimit të hapësirave shkollore në harmoni me standardet e sigurisë; • Reflektojnë për përgjegjësinë e tyre dhe gjithë stafit të shkollës për sjellje në përputhje me politikat dhe standardet e operimit; • Kuptojnë përgjegjësinë e tyre shoqërore e institucionale në raportimin e rasteve; • Demonstrojnë vetëbesim e shkathtësi për reagim ndaj abuzimit.

Përmbajtja:	<p>Ky kurs përbëhet nga tri module të ndërlidhura në mes vete dhe që pjesëmarrësit i ofrojnë njohuri përmes përmbajtjeve informative, si dhe shkathtësi përmes pyetjeve reflektive e tregimit të rasteve.</p> <p>Në modulën e parë trajtohet në përgjithësi përkufizimi, karakteristikat dhe kategoritë e abuzimit të fëmijëve, në dritën e koncepteve udhëheqëse të të drejtave të fëmijëve, si mirëqenia e fëmijëve dhe mjedisi mik për fëmijët. Ky modul, po ashtu, trajton kornizën normative për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi.</p> <p>Moduli i dytë trajton manifestimin e kategorive të ndryshme të abuzimit, si dhe pasojat e abuzimit të fëmijëve.</p> <p>Moduli i tretë, jep informata praktike për krijimin e mjedisit mik dhe të sigurt për fëmijë nëpër shkollë, përfshirë organizimin e ndërtesave shkollore, politikat dhe procedurat standarde të operimit, si dhe procedurat e raportimit dhe referimit të rasteve të abuzimit të fëmijëve</p> <p>Në fund të secilit modul, pjesëmarrësi i kursit do të reflektojë mbi përmbajtjen e modulit, duke u përgjigjur në pyetjet që lidhen me përmbajtjen e që janë të lidhura me situata jetësore reale në shkollë e komunitet.</p>
Metodat e realizimit të programit:	<p>Kursi ofrohet përmes internetit (online) dhe është kurs i vetëdrejtuar, ku pjesëmarrësi e ndjek tempon individuale të të nxënit duke naviguar përmes kursit i cili është i disenjuar ashtu që ka mundësi të kthimit pas e kapërcimit përpara në përmbajtje të kursit, duke përfshirë edhe mundësitë e shumëfishta për reflektim. Pjesë të përmbajtjes së kursit mbështeten me burime elektronike që mundësojnë lexim më të thelluar për ato përmbajtje si dhe video-prezantime që përkrahin të nxënit.</p> <p>Kursi mund të ndiqet nga pjesëmarrësi njëherësh (pa ndërprerje) ose në sesione të disahershme, duke iu përshtatur kohës në dispozicion të pjesëmarrësit.</p>
Certifikimi:	<p>Në fund të këtij kursi pjesëmarrësit do të certifikohen duke u kredituar me gjithsej 8 orë trajnimi.</p> <p>Kriteret për certifikim janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimi i gjithë përmbajtjes së kursit (të gjitha temave të të trija moduleve) • Suksesi së paku 80% në reflektimet përgjatë kursit; <p>Plotësimi i kriterëve të certifikimit vërtetohet përmes një sistemi përcjellës në platformën e kurseve online dhe lidhet me gjenerimin e certifikatës elektronike. Certifikata elektronike shndërrohet në certifikatë të shtypur e të</p>

	nënshkruar nga përfaqësuesit e organizatës implementuese dhe MASHT.
Trajnerë:	4 trajnerë
Data e aplikimit	15.12.2023

Titulli i Programit:	Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet edukimit, artit dhe medias - scream
Titulli i organizatës:	Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
Adresa:	Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë
E-mail:	office@kec-ks.org
Telefoni:	038/244-257, lok. 109
Numrat dhe data e akreditimit:	Nr. 111/2024 Data: 26.02.2024
Kohëzgjatja e programit(orë)	Programi i trajnimit është program tre - ditor i përbërë nga gjithsej 12 sesione. Secili sesion zgjat 90 minuta.
Përfituesit:	Grupi i synuar i programit të trajnimit janë mësimmshënësist e fushave të ndryshme kurrikulare, e në veçanti të 'shoqëria dhe mjedisi', 'jeta dhe puna', 'gjuhët dhe komunikimi', 'artet', etj. Në këtë trajnim është e rekomandueshme të përfshihet edhe shërbimi profesional i shkollave (pedagogët, psikologët), koordinatorët e cilësisë, etj.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20-25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Programi SCREAM siguron këto rezultate:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njohjen e të dhënave kryesore për punën e fëmijëve, çështjeve të punës sw tyre në mënyrë të kuptueshme nga të rinjtë, duke dhënë shifra, tregues statistikorë dhe informacion kryesor; • Nxitjen për të shprehurit artistik vizual dhe pasqyrimin të vëmendjes së pamjaftueshme që shtypi ka për problemin e punës së fëmijëve; • Kërkimin dhe gjetjen e një informacioni sa më të gjerë për punën e fëmijëve, përfshirë këtu edhe konventat ndërkombëtare, për t'u thelluar në këtë problem; • Zhvillimin e një interviste apo sondazhi në mjedise që interesohen për punën e fëmijëve, duke paraqitur teknikat e intervistës dhe nxitur veprimtarinë kërkimore për të nxjerrë në dukje se ç'bëjnë të tjerët për punën e fëmijëve në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe shoqërisë; • Krijimin e profilit të një fëmije që punon, përmes figurave të ndryshme, duke nxitur të pranishmit të përfshihen emocionalisht e me ndërjegje

	<p>në trajtimin e problemit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Futjen në rolin e fëmijës që punon dhe të personave që kanë lidhje me të, duke përdorur dramatizimet me qëllim edukativ; • Pjesëmarrjen apo organizimin e një konkursi për punën e fëmijëve, duke nxitur shprehjen artistike dhe promovuar procesin edukativ të sensibilizimit të komunitetit; • Të shkruarit të një historie për një temë për punën e fëmijëve, me teknikë të caktuar, duke përmirësuar aftësitë letrare dhe komunikuese; • Studimi, përgatitja dhe mbajtja e një debati publik për punën e fëmijëve; • Përballja me mjetet e komunikimit, për të ngjallur vëmendjen e publikut për punën e fëmijëve, për të mësuar të shkruajnë një njoftim shtypi dhe për të siguruar botimin e tij, si dhe për të përgatitur dhe realizuar një intervistë radiofonike ose televizive; • Nxitja dhe përfshirja e komunitetit në çështjen e punës së fëmijëve, duke përforcuar rolin e të rinjve si nismëtarë të ndryshimeve sociale; • Paraqitja e mekanizmave të tregut të punës, duke diskutuar rolet që kanë sektorë të ndryshëm të shoqërisë dhe mënyra si ato veprojnë në të mirë të shoqërisë; • Nxitja e interesimit dhe pjesëmarrjes së komunitetit për punën e fëmijëve. • Shkathtësitë e të qenit trajner.
<p>Përmbajtja:</p>	<p>Aktivitetet e SCREAM mundësojnë zhvillimin e aftësive krijuese, shprehëse e sociale të fëmijëve, mundësojnë njohjen e fëmijëve me botën e mediatike, përgatitjen për komunikim me mediet si dhe aftësimin e fëmijëve për ndërmarrjen e nismave në vendosjen e një bashkëpunimi me komunitetin. Ato mund të përshtaten sipas kohës dhe burimeve që kemi në dispozicion, sipas kontekstit gjeografik apo kulturor. Si të tilla, këto aktivitete mund të zhvillohen për trajtimin e temës së punës së fëmijëve, por edhe të çfarëdo teme tjetër që ka të bëjë me mbrojtjen e fëmijëve, në kontekst të programeve formale apo jo-formale të edukimit.</p> <p>Programi SCREAM realizohet përmes 14 moduleve vijuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informacioni kryesor • Kollazhi • Kërkimi dhe informacioni

	<ul style="list-style-type: none"> • Intervista dhe sondazhe • Figura • Loja me role • Konkursi artistik • Shkrimi krijues • Debati • Mjetet e komunikimit (dy module: mjetet e shkruara dhe radio e tv) • Dramatizimi • Tregu i punës • Integrimi i komunitetit
Metodat e realizimit të programit:	<p>Programi i trajnimit për SCREAM është program tre - ditor i përbërë nga gjithsej 12 sesione, secili zgjatë 90 minuta. Në ditën e parë fillohet me sesionin orientues, pastaj programi me aktivitetet e moduleve shpaloet në pesë sesionet tjera me radhë të shtrira në dy ditë. Dy sesionet e fundit të ditës së dytë i dedikohen planifikimit për zbatim të moduleve në shkollë dhe planit të mentorimit. Këto sesione kanë sesione plenare dhe punë grupore, varësisht nga natyra e modulit. Dita e tretë i kushtohet prezantimit të punës së bërë gjatë realizimit të moduleve, me ç’rast ipet informata kthye nga ‘miqtë kritik’, dhe zhvillohen diskutime. Forma e realizimit të ditës së tretë mund të ndryshojë varësisht nga numri i pjesëmarrësve, bëhen prezantime klasike me power pointit dhe pastaj diskutime, apo, organizohen poster prezantime ku miqtë kritik observojnë, marrin shënime, pyesin, etj., dhe në fund realizohet diskutim i hapur konstruktiv për mënyrën e realizimit, për sfidat që janë hasur dhe se si ka mundur të realizohej ndryshe. Për trajnimin e trajnerëve, njëri sesion i ditës tretë i kushtohet standardeve të fasilitimit me të rriturit, ndërsa kur targeti i trajnimit janë mësimdhënësit, ky sesion i kushtohet prezantimeve dhe diskutimeve të mësimdhënësve, sepse në ato raste numri i pjesëmarrësve është më i madh. Në këtë sesion, mësimdhënësit udhëzohen që përmbajtjet e pakos SCREAM t’i përfshijnë në planifikimin vjetor të punës së tyre me nxënës, si aktivitet kurrikular, ndërkurrikular, projekte mësimore apo lëndë zgjedhore të ndryshme.</p>
Certifikimi:	<p>Për t’u certifikuar si trajnerë për programin SCREAM, në fund të punëtorisë tre ditore do të realizohet vlerësimi i kandidatëve. Trajnerët do të certifikohen duke u kredituar me gjithsejt 32 orë pedagogjike.</p> <p>Kalkulimi i pikëve për licencim: 32 pikë = 8 orë pedagogjike (45’) x 3 ditë trajnimi + 8 orë pedagogjike për</p>

	<p>zbatim të aktiviteteve në shkollë.</p> <p>Kriteret për certifikim janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 90% pjesëmarrje aktive në trajnim dhe në takimet reflektuese me mentor; • Realizimi i së paku një aktiviteti të përzgjedhur nga njëri modul i pakos SCREAM, dhe mbledhja e evidencës me nxënës gjatë punës me nxënës (krijimi i portfolios); • Demonstrimi i shkathtësive moderuese gjatë prezantimit të portfolios / produktit final të realizuar me nxënësit; • Pjesëmarrje aktive me diskutime në sesionet finale gjatë prezantimit të pjesëmarrësve.
Trajnerë:	13 trajnerë
Data e aplikimit	15.12.2023

Titulli i Programit:	Menaxhimi i sjelljeve dhe gjithëpërfshirja
Titulli i organizatës:	Qendra e Trajnimeve Albas - Kosovë
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Qendra e Trajnimeve Albas - Kosovë
Adresa:	Rr. "Bekim Femi", Lakrishtë, Prishtinë
E-mail:	trajnime@albaskosova.com
Telefoni:	+38344108887 / 045999332
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Numër 135/2024 Datë 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	Numër 135/2024 Datë 26.02.2025
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Numër 14/2024 Datë 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Numër 14/2024 Datë 26.02.2025
Kohëzgjatja e programit(orë)	24 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e arsimit parauniversitar
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	30 mësues
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<ul style="list-style-type: none"> - njeh mirë kuptimin e sjelljeve problem dhe procedurat e trajtimit të tyre; - trajton në mënyrë specifike situatat brenda klasës në bashkëveprim me të tretët; - zotëron njohuri mbi organizimin e klasës; - fokusohet mbi rëndësinë e menaxhimit të klasës dhe aftësive menaxhuese; - kupton rolin dhe rëndësinë që ka mësuesi mbi menaxhimin e klasës; - kupton rëndësinë mbi llojet e konflikteve dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre; - zhvillon strategji për të vlerësuar dhe menaxhuar sjelljet e papërshtatshme; - zhvillon aftësi për të përdorur teknika të ndryshme për të trajtuar sjelljen problematike të nxënësve me aftësi ndryshe; - ndërjegjësohet për problematikat e integritetit të nxënësve me aftësi ndryshe gjatë

	<p>mësimit në klasë dhe atij në distancë;</p> <ul style="list-style-type: none"> - njih dhe aplikon strategji për t'iu përgjigjur nevojës së dyfishtë për individualizimin dhe shoqërizimin në kushtet e reja në rastet edhe kur zbatohet mësimdhënia on-line; - aftësohet të sigurojë gjithëpërfshirjen dhe shoqërizimin e nxënësit me aftësi ndryshe.
Përmbajtja:	<p>Menaxhimi i sjelljeve të nxënësve në klasë, i sjelljeve të nxënësve me vështirësi në të nxënë dhe të nxënësve me aftësi ndryshe është një nga sfidat e shumta me të cilat përballet arsimit sot. Institucionet arsimore, mësuesit, komunitetet janë gjendur të papërgatitur mjaftueshëm për të menaxhuar situatën. Prandaj ka lindur një nevojë e domosdoshme që aktorët të cilët përballen në mënyrë të drejtpërdrejtë me këtë situatë të marrin trajnime të specializuara në këtë drejtim. Trajnimi nëpërmjet këtij programi ka për synim të zhvillojë: teknika të identifikimit dhe vlerësimit funksional të sjelljeve problematike; mbajtjen e të dhënave vlerësuese të sjelljeve; vlerësimin e funksionit të tyre, aktorët gjithëpërfshirës në proces; ndërtimin e programit dhe aplikimin e tij sipas metodës ABA; qasjen bihevisoriste në analizën e sjelljes, koncepte të gjithëpërfshirjes së tyre në procesin mësimor dhe strategji të ndryshme që lidhen me mësimin e drejtpërdrejtë dhe atë në distancë.</p> <p>Programi synon të përmirësojë jetën e fëmijëve gjatë procesit mësimor, dhe të atyre fëmijëve që janë pjesë e vështirësive me natyrë neuro-zhvillimore, aftësi ndryshe dhe fëmijëve me nevoja të veçanta përmes procesit të gjithëpërfshirjes dhe strategjive të suksesshme në këtë kontekst.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Moduli: Menaxhimi i klasës dhe konflikteve 2. Moduli: Menaxhimi i sjelljeve të nxënësve me nevoja të veçanta 3. Moduli: Strategjitë e integritit të nxënësve me aftësi ndryshe në mësimdhënien në klasë dhe në distancë 4. Moduli: Teoritë e komunikimit.
Metodat e realizimit të programit	<p>Metodologjia e trajnimit mbështetet në metodologjitë bashkëkohore dhe me qasje interaktive, parimet dhe kërkesat e mësimdhënies inovative duke pasur parasysh përfshirjen aktive të pjesëmarrësve, qasjen e integruar, bashkëpunimin, iniciativën dhe rezultatet e të nxënësve me fokus kompetencat dhe rritjen e shkathtësive për menaxhimin efektiv të sjelljeve dhe klasës, si dhe gjithëpërfshirjes.</p> <p>Disa nga metodat të cilat do të përdoren gjatë programit të trajnimit janë: <i>Leksioni</i> (në power point) dhe <i>materiale ilustruese të prezantuara me metodat audiovizuale, demonstrimi, veprimtari e pavarur individuale, punë me grupe</i> / <i>“punë në çift”</i>, <i>metoda sokratike</i> që përdoret pothuajse në secilën seancë.</p> <p>Çdo modul shoqërohet me detyra të cilat demonstrojnë shkallën e njohurive të marra nga pjesëmarrësit në secilin prej tyre.</p>

Certifikimi	Certifikimi i pjesëmarrësve do të bëhet duke respektuar kriteret në vijim: Pjesëmarrja në trajnim min. 80% dhe realizimi me sukses i detyrave (portfolios) nga pjesëmarrësit, të dhëna nga trajneri/ja 2 ditë pas çdo moduli të zhvilluar (ditë trajnimi).
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	Albesë Kryeziu; Alida Thaçi; Artemis Shehu (Dano); Edona Berisha Kida; Era Baliu; Erida Koleci; Miranda Fazliu
Data e aplikimi	15.12.2023

Titulli i Programit:	Mësimdhënia dhe të nxëniet e shkencave natyrore në klasat 1-5
Titulli i organizatës:	Instituti Për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA) – Fakulteti I Edukimit - UP
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	Instituti Për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA) – Fakulteti I Edukimit - UP
Adresa:	Fakulteti i Edukimit Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Rr. Agim Ramadani, nr. 350, 10000 Prishtinë, Kosovë
E-mail:	blerim.saqipi@uni-pr.edu
Telefoni:	+ 383 38 22 92 01
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	/
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	/
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr. 142/2024 Datë: 16.01.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr. 142/2024 Datë: 16.01.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	30 orë
Përfituesit:	Ky program i dedikohet zhvillimit dhe aftesimit profesional të mësimdhënësve në nivelin e shkollave fillore (ISCED 1), klasat 1-5 me fokus të veçantë në njohuritë e shkencave natyrore. Po ashtu, programi mund të jetë i dobishëm edhe për mësimdhënësit e ardhshëm të këtij niveli.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	15-25 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Zbatojnë strategji, metoda dhe teknika ndërvepruese të mësimdhënies dhe të nxëniet, që mundësojnë ndërtimin dhe krijimin e njohurive të nxënësve, formimin e shprehive, zhvillimin e kompetencave në përputhje me Kornizën e Kurrikulës dhe rezultatet e të nxëniet në fushën kurrikulare Shkencat natyrore. <ul style="list-style-type: none"> • Përdorin veprimtari të shumëllojshme dhe të efektshme për shprehitë e procesit në shkencat e natyrës: vëzhgimin, krahasimin, klasifikimin dhe analizën, të cilat

	<p>ndihmojnë nxënësit në ndërtimin e koncepteve për dukuritë natyrore dhe për zgjidhjen e detyrave të ndryshme me karakter vëzhgues dhe hulumtues.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshtasin mësimdhënien e tyre nevojave dhe mundësive të nxënësve, duke përdorur metoda ndërvepruese dhe të nxënësve aktiv, të cilat nxënësit të menduarin kritik dhe formojnë nxënësit të pavarur, • Zhvillojnë imagjinatën dhe krijimtarinë e nxënësve përmes përdorimit të organizuesve grafikë dhe mjeteve të tjera pamore, • Përdorin mjete të ndryshme konkretizuese me qëllim të aftësisë të nxënësve për hulumtim të informacioneve të ndryshme në Internet, të nxënësve të koncepteve shkencore përmes situatave simuluese ose reale dhe zhvillimin e kompetencave të nxënësve në këtë lëndë.
Përmbajtja:	<p>Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ka përgatitur profilin e kompetencave që një mësimdhënës duhet të ketë. Me anë të Programit “Mësimdhënia dhe të nxënësve të shkencave natyrore në klasat 1 - 5 të shkollës fillore” synohet të zhvillohen kompetencat e mësimdhënësve që kanë të bëjnë me Metodologjinë dhe Përmbajtjen akademike. Përmes këtij programi mësimdhënësve do të aftësohen në përdorimin e strategjive dhe metodave ndërvepruese me qëllim të nxitjes së mendimit kritik tek nxënësit, formimin e shprehive si dhe zhvillimin e kompetencave në përputhje me Kornizën Kurrikulare.</p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Mësimdhënie interaktive Punë grupe Punë praktike e bazuar në kontekst Qasja e punës do të jetë e bazuar në ngritjen e debateve.</p>
Certifikimi	Po.
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<p>10 trajner</p> <p>Zeqir Veselaj Arlinda Damoni Irir Mazreku Jeton Halili Fitore Malaj Lulzim Thaqi Fadil Latifi Shpëtim Kastrati Musaj Paçarizi Selim Qevani</p>

Titulli i Programit:	Mësimdhënia e Gjuhës shqipe dhe letërsisë në kurrikulën me kompetenca, gërshetimi me teknologjinë.
Titulli i organizatës:	Qendra e Trajnimeve Albas - Kosovë
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	Qendra e Trajnimeve Albas - Kosovë
Adresa:	Rr."Bekim Femi", Lakrishtë, Prishtinë
E-mail:	trajtime@albaskosova.com / albas_pr@yahoo.com
Telefoni:	+38344108887 / 045999332
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Numër 135/2024 Datë 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	Numër 135/2024 Datë 26.02.2025
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Numër 13/2024 Datë 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Numër 13/2024 Datë 26.02.2025
Kohëzgjatja e programit(orë)	18 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e gjuhës shqipe dhe të letërsisë në arsimin parauniversitar
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	30 mësues
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<i>Në fund të programit të trajnimit mësuesi/ja:</i> <ul style="list-style-type: none"> - zotëron njohuri mbi metodat e reja të mësimdhënies së aspekteve të ndryshme të gjuhës shqipe dhe letërsisë; - fokusohet mbi çështjet kryesore gjuhësore që janë të rëndësishme për formimin e nxënësve; - kupton rolin e tij dhe të metodave të reja të përditësuara për të shtuar interesimin e nxënësve në përvetësimin e gjuhës shqipe dhe letërsisë; - zhvillon strategji për të vetëdijësuar nxënësit për rëndësinë e përdorimit të saktë të gjuhës, si një aftësi shumë e rëndësishme për shtetasit kosovarë.

	<ul style="list-style-type: none"> - zhvillon kompetenca të shtuara në përdorimin e teknologjisë; - zbaton strategjitë të të nxënit aktiv; - zbaton praktikat më të mira në këtë kontekst; - aftësohet në përdorimin e përmbajtjes multimediale dhe përdorimin e platformave në internet; - aftësohet në shfrytëzimin e burimeve në internet të lidhura me mësimdhënien e gjuhës; - specializohet në mësimdhënie dhe në aplikimin e metodave.
Përmbajtja:	<p>Ky program trajton përveç trajtimit të metodave të reja të mësimdhënies në drejtim të përvetësimit të njohurive gjuhësore e letrare, sjell si risi zbatimin e teknologjisë në mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe letërsisë, duke theksuar avantazhet, sfidat dhe praktikat më të mira që lidhen me integrimin e saj.</p> <p>Në këtë program propozohen praktikat më të mira për integrimin e teknologjisë në mësimin e gjuhës shqipe dhe letërsisë, për t'i tejkaluar këto sfida dhe për të rritur përfitimin nga përdorimi i teknologjisë.</p> <p>Përshkruhen një sërë mjesh teknologjike në mësimdhënien e gjuhës shqipe, siç janë: Fjalorë në internet; Softuerë për mësimin e gjuhës; Platforma për mësimdhënien, platforma për përdorimin e drejtë të gjuhës shqipe; Platforma për vetëvlerësimin e njohurive gjuhësore të shqipes; Libra elektronike dhe audio; Mediat sociale dhe komunitetet e mësimin të gjuhës; Faqe uebi dhe aplikacione specifike; Tabela interaktive etj. Përmbajtja multimediale, duke përfshirë videot, imazhet, skedarët audio dhe materialet ndërvepruese, rezulton të jetë një burim i fuqishëm për angazhimin e nxënësve në mësimin e gjuhës shqipe.</p> <p>Programi është ndërtuar në 3 module:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Moduli: Ndërtimi i aftësive të të lexuarit 2. Moduli: Përdorimi i teknologjive të reja në mësimdhënien e letërsisë. 3. Moduli: Mësimdhënia e gjuhës shqipe përmes teknologjisë
Metodat e realizimit të programit	<p>Metodologjia e trajnimit mbështetet në metodologjitë bashkëkohore dhe me qasje interaktive, parimet dhe kërkesat e mësimdhënies inovative duke pasur parasysh përfshirjen aktive të pjesëmarrësve, qasjen e integruar, bashkëpunimin, iniciativën dhe rezultatet e të nxënit me fokus kompetencat dhe rritjen e shkathtësive për mësimdhënie efikase.</p> <p>Disa nga metodat të cilat do të përdoren gjatë programit të trajnimit janë: <i>Leksioni (në power point) dhe materiale ilustruese të prezantuara me metodat audiovizuale, demonstrimi, veprimtari e pavarur individuale, punë me grupe</i> / <i>“punë në çift”</i>, metoda sokratike që përdoret pothuajse në secilën seancë.</p>
Certifikimi	<p>Certifikimi i pjesëmarrësve do të bëhet duke respektuar kriteret në vijim: Pjesëmarrja në trajnim min. 80% dhe realizimi me sukses i detyrave (portfolios) nga pjesëmarrësit, të dhëna nga trajneri/ja 2 ditë pas çdo moduli të zhvilluar (ditë trajnimi).</p>
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	Anila Cepani; Erida Koleci; Shpetim Elezi; Adelina Cerpja; Dhurata Shehri; Shyrete Alaj; Albërie Rraci Sejdiu; Bleta Berisha; Era Baliu.
Data e aplikimi	15.12.2023

Titulli i Programit:	Mësimdhënia Online në Nivelin e Duhur
Titulli i organizatës:	Kosova Center for Digital Education (KCDE) - Mëso Online
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Kosova Center for Digital Education (KCDE) - Mëso Online
Adresa:	Tech Park - Bërnice e Poshtme, 10000, Prishtine
E-mail:	info@kcde-ks.org antigona.uka@kcde-ks.org
Telefoni:	+383 49 410 003
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Aprovimi nga Ministria e Administrates Publike Nr. 5117389-9 Datë: 10/07.2018
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	N/A
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr. 82/2024 Datë: 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr. 82/2024 Datë: 26.02.2025
Kohëzgjatja e programit(orë)	Programi organizohet online në formë të pesë moduleve. Secili modul përmban 3 sesione, pra gjithsej janë 15 sesione, nga të cilat 8 janë sinkronike dhe 7 asinkronike. Një sesion sinkronik zgjatë 120 minuta, pra në tërësi sesionet sinkronike zgjasin 16 orë, kurse një sesion asinkronik zgjatë rreth 90 minuta (me përjashtim të njërit sesion asinkronik, më saktësisht sesionit 2 në modulën 5, i cili kërkon 120 minuta) dhe të gjitha sesionet asinkronike zgjasin 11 orë. Pra, gjithsej programi përmban 27 orë trajnimi. Programi përfshin edhe përpilimin e katër punimeve, përmbushja e të cilave kërkon angazhim rreth 8 orë, si dhe pjesëmarrjen opsionale në një fokus grup diskutimi 2-orësh pas përfundimit të trajnimit. Pra, si tërësi programi trajnues kërkon 35 orë

	angazhimi për pjesëmarrësit të cilët ndjekin trajnimin.
Përfituesit:	<ol style="list-style-type: none"> 1) Mësimdhënësit e nivelit të mesëm-ulët dhe mesëm-lartë (përfshirë IAAP) të Republikës së Kosovës. 2) Studentët e sapo diplomuar të fakultetit të edukimit, apo mësimdhënësit e ardhshëm të nivelit të mesëm-ulët dhe mesëm-lartë (përfshirë IAAP) të Republikës së Kosovës.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	30 pjesëmarrës për një grup.
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Qëllimi kryesor i programit 'Mësimdhënia online në nivelin e duhur' është ngritja e njohurive mbi mësimin online dhe zhvillimi i kapaciteteve për krijimin e klasave virtuale. Prandaj, përmes këtij programi, pjesëmarrësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përmirësojnë aftësitë e tyre digjitale për mësimdhënie online në një medis bashkëpunues. - Përforcojnë lidhjet profesionale mes vete duke ndërtuar një komunitet për mësim online. <p>Përfitojnë mundësi të zhvillimit profesional në mësimdhënie online</p> <p>Përmes trajnimit, pjesëmarrësit do të krijojnë së paku një njësi të plotë mësimore virtuale apo të realizueshme online. Njësi e plotë mësimore virtuale konsiderohet atëherë kur përmban të gjitha elementet pedagogjike, duke filluar nga planifikimi, metodat e mësimdhënies, materialet, e deri tek vlerësimi i nxënësve. Për të zhvilluar dhe dizajnuar një njësi mësimore virtuale, gjatë trajnimit pjesëmarrësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njihen me platforma të ndryshme për mësim online duke mësuar si të regjistrohen dhe si t'i përdorin ato (sic janë: sisteme të menaxhimit të mësimin, platformat për komunikim, krijimin e materialeve mësimore, angazhimin e pjesëmarrësve për punë individuale dhe grupe, etj.); - krijojnë materiale audio-vizuale si dhe forma të vlerësimit online (duke përdorur H5P, PreziVideo, Kahoot, Socrative, Mentimeter, etj); - praktikojnë realizimin e aktiviteteve e-didaktike duke përdorur veglat për mësim virtual (të listuara më sipër).

Përmbajtja:	<p>Programi përmban 5 Module, sesionet e te cilave sigurojnë arritjen e rezultateve të programit.</p> <p>MODULI 1: Hyrje në Mësimin Online Sesioni 1: Platformat e mësimin online Sesioni 2: Teori dhe nocione mbi mësimin online Sesioni 3: Krijimi i guackës së kursit në Moodle</p> <p>MODULI 2: E-Didaktika / Metodat e Mësimdhënies Online Sesioni 1: Mësimdhënia online Sesioni 2: Mesimi Sinkronik dhe Asinkronik Sesioni 3: Skicimi i një plani mësimor online</p> <p>MODULI 3: Materialet Audio-Vizuale Sesioni 1: Materialet vizuale në mësimin online Sesioni 2: Krijimi i materialeve interaktive për sesione sinkronike Sesioni 3: Krijimi i materialeve interaktive për sesione asinkronike</p> <p>MODULI 4. Vlerësimi Online Sesioni 1: Hyrje në vlerësimin online të nxënësve Sesioni 2: Prezantimi i mjeteve online për vlerësim Sesioni 3: Krijimi i formave të vlerësimit në Moodle</p> <p>MODULI 5. Sistemi për Menaxhimin e Mësimin (LMS Moodle) Sesioni 1: Integrimi i platformave në Moodle Sesioni 2: Dizajnimi i plotë i njësisë mësimore në Moodle Sesioni 3: Prezantimi i njësisë mësimore virtuale</p>
Metodat e realizimit të programit	Programi zhvillohet online, i cili përbëhet nga sesione sinkronike dhe asinkronike.
Certifikimi	Pjesëmarrësit marrin certifikatë e cila është e barazvëlshme me 30 pikë apo 30 kredi.
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<p>Gjithsej janë 3 trajner:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Antigona Uka; 2) Marigona Morina; 3) Robert Pajaziti.
Data e aplikimi	Thirrja është gjithmonë e hapur, meqenëse ka grupe të njëpasnjëshme.

Titulli i Programit:	Metodologjia Montessori për edukimin në fëmijërinë e hershme (mosha 0-6 vjeç)
Titulli i organizatës:	Instituti Për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA) – Fakulteti I Edukimit - UP
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	Instituti Për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA) – Fakulteti I Edukimit - UP
Adresa:	Fakulteti i Edukimit Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Rr. Agim Ramadani, nr. 350, 10000 Prishtinë, Kosovë
E-mail:	blerim.saqipi@uni-pr.edu
Telefoni:	+ 383 38 22 92 01
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	/
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	/
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr. 138/2024 Datë: 16.01.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr. 138/2024 Datë: 16.01.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	240 orë
Përfituesit:	Edukatorët të cilët punojnë me fëmijët e moshave 0-3 vjeç dhe 3-6 vjeç në kopsht ose shkollat fillore me klasat parafillore. Pjesëmarrësit në këtë trajnim duhet të kenë përvojë pune në profeson, së paku 3 vite për arsye se nevojitet një bazë e kompetencave për punë me fëmijët e moshave përkatëse.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	15-25 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<ul style="list-style-type: none"> • Stimulojnë fëmijët për zhvillim të shkathtësive për jetë (kujdesin ndaj vetes, ndaj ambientit, mirësjelljen, vetëkontrollit, etj); • Përkrahin fëmijët për të nxënë duke përdorur të gjitha shqisat; • Mbështesin fëmijët për të zhvilluar shkathtësitë e jetës së përditëshme. • Zhvillojnë aktivitete të cilat nxisin të menduarit matematikor përmes punës me materiale specifike montesori;

	<ul style="list-style-type: none"> • Stimulojnë zhvillimin e gjuhës dhe komunikimit tek fëmijët duke përdorur strategji dhe materiale specifike Montessori; • Zhvillojnë aktivitete që nxisin njohjen e vetës, njohjen e të tjerëve dhe njohjen e Botës që na rrethon duke hulumtuar dhe eksperimentuar me materiale specifike; • Krijojnë materiale didaktike të cilat nxisin zhvillimin dhe të nxënit e fëmijës. • Vëzhgojnë dhe dokumentojnë zhvillimin dhe përparimin e fëmijëve si dhe janë në gjendje të planifikojnë dhe nxisin fëmijët në drejtimin që kanë nevojë, interesim dhe dëshirë.
Përmbajtja:	Përmbajtja e programit të metodologjisë Montessori i shërben zhvillimit profesional të edukatorëve në shërbim nëndërlidhje me shumicën e kompetencave të edukatorëve duke përfshirë: zbatimin e strategjive dhe metodologjive të të mësuarit të cilat pasqyrojnë vlerat demokratike dhe zhvillimin e gjithmbarshëm të personalitetit; aftësitë komunikuese me partnerët kryesor, prindërit dhe komunitetin; vlerësimin dhe planifikimin e bazuar në nevoja, interesa dhe dëshira të fëmijëve; ndërveprimin me fëmijë, si dhe sigurimin e një ambienti stimulues për të nxënë. Edukatorët të cilët përfundojnë trajnimin e metodologjisë Montessori, mund të aplikojnë për licencim në nivelin e mësimit të avancuar sepse gjithsej fitohen 240 orë trajnim brenda dy vitesh.
Metodat e realizimit të programit	Trajnimi organizohet përmes metodologjisë së kombinuar me minileksione, modelime dhe ushtrime praktike për përdorimin e të gjitha materialeve.
Certifikimi	Po.
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	13 trajner Rainer Völkel Irmtraud Völkel Ingrid Rudolf-Gissel Majlinda Gjellaj Rozafa Ferizi- Shala Arlinda Beka Blerta Perolli- Shehu Albulena Metaj- Macula Adelina Hajrullahu Donika Koliqi Kadrie Asllani Arbenita Rexha Hajrie Peci

Titulli i Programit :	Mësimdhënia cilësore në edukim dhe arsim gjithëpërfshirës
Titulli i organizatës:	Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim QBMK “Përparimi” Prishtinë
Tipi i programit :	Bazik - themelor
Ofertuesi i programit :	Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim QBMK “Përparimi” Prishtinë
Adresa:	Adresa: Rruga ‘ Don Bosko’ 21 Prishtinë
E-mail:	qendraburimoreperparimi@hotmail.com
Telefoni:	044-175 – 789 dhe 044-206-940
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	- -
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	- -
Numri dhe data e aprovimit të programit :	Nr.98/2024 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit	Nr.98/2024 26.02.2027

të afatit të aprovimit të programit :	
Kohëzgjatja e programit (orë)	<p>Programi “ Mësimdhënia cilësore në edukim dhe arsim gjithëpërfshirës” përbëhet nga katër module ku secili modul ka kohëzgjatje të ndryshme në ditë dhe orë trajnimi varësisht nga përmbajtja:</p> <p>Moduli I. Arsimi Gjithëpërfshirës dhe Aftësia e kufizuar : 3 ditë trajnim me 18 orë</p> <p>Moduli II. Edukimi gjithëpërfshirës në fëmijërinë e hershme: 2 ditë trajnim me 12 orë</p> <p>Moduli III. Ndikimi dhe aplikimi i muzikës te fëmijët me aftësi të kufizuara:1 ditë trajnim me 6 orë</p> <p>Moduli IV: Hartimi dhe zbatimi i planit individual të arsimit: 2 ditë trajnimi me 12 orë dhe 1 ditë mentorim me 6 orë</p> <p style="text-align: center;"><i>Gjithsej programi ka 9-të ditë trajnimi me 54 orë</i></p>
Përfituesit :	Përfituesit e këtyre moduleve të trajnimit mund të jenë edukatorët, mësimdhënësit e tri niveleve të arsimit parauniversitar, asistent për nxënës me nevoja të veçanta arsimore, mësues mbështetës, psikolog etj.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25 – 30 pjesëmarrës
Rezultatet e priturose objektivat e programit :	<p>Moduli I. Arsimi Gjithëpërfshirës dhe aftësia e kufizuar</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përshkruajnë konceptet themelore të arsimit gjithëpërfshirës 2. Kuptojnë rëndësinë e arsimit gjithëpërfshirës dhe rolin e akterve mësimor në këtë proces 3. Vlerësojnë modelin e shkollës dhe klasave gjithëpërfshirëse 4. Dallojnë llojet e aftësisë së kufizuara 5. Përcaktojnë lehtësuesit dhe barrierat për nxënësit me aftësi të kufizuara brenda shkollave gjithëpërfshirëse 6. Përfitojnë strategji të llojllojshme për të bërë identifikimin e vështirësive në shkrim, lexim, matematikë, përmes instrumenteve të hartuara për këtë qëllim 7. Modifikojnë, zbërthejnë dhe lehtësojnë barrierat në programet mësimore, me qëllim që nxënësit me vështirësi në të nxënë të arrijnë në nivelin e dëshiruar <p>Moduli II . Edukimi gjithëpërfshirës në fëmijërinë e hershme:</p>

1. Përshkruajnë fazat e zhvillimit në fëmijërinë e hershme të fëmijët e moshës 3-6
Prezantojnë konceptet baze mbi arsimin gjithëpërfshirës dhe aftësinë e kufizuar
2. Dallojnë strategjitë të përshtatshme të mësimdhënies për të mbështetur praktikën gjithëpërfshirëse
3. Analizojnë stilet dhe strategjitë e mësimdhënies për angazhimin me fëmijë me nevojë të ndryshme arsimore
4. Identifikojnë strategjitë për menaxhimin e sjelljeve verbale dhe problematike të fëmijëve me nevojë të veçanta.
5. Interpretojnë bashkëpunimin efektiv mes familjes, fëmijëve si dhe me profesionistë nga disiplina të tjera si terapistë etj
6. Identifikojnë dhe dallojnë faktorët për krijimin e një mjedisi mbështetës dhe pozitiv për të nxitur ndërveprimin ndërmjet bashkëmoshatarëve.

Moduli III Ndikimi i muzikës dhe aplikimi i saj tek fëmijët me nevojë të veçanta

1. Përshkruajnë ndikimin e muzikës, të nxënësit me aftësi të kufizuara dhe jo vetëm.
2. Dallojnë mënyrën e qasjes adekuate me fëmijët/nxënësit me aftësi të kufizuara përmes muzikës dhe metodave adekuate
3. Praktikojnë shembuj të ndryshëm të aplikimit të muzikës
4. Përshkruajnë konceptin e terapisë muzikore dhe përdorimin e saj.

Moduli IV Hartimi dhe zbatimi i planit individual të arsimit-PIA

1. Përshkruajnë aspektin ligjorë në cilin mbështetet procesi mësimor sipas planit individual të arsimit PIA
2. Dallojnë dhe kuptojnë pjesët e PIA-s (pjesa administrative, pjesa pedagogjike, faza e tranzicionit dhe pjesa rehabilituese)
3. Përshkruajnë dhe dallojnë rolin e secilit profesionist në hartim, rishikim dhe zbatim të PIA-s
4. Dallojnë mënyrat e identifikimit të aftësive dhe nevojave individuale të nxënësve me nevojë të veçanta arsimore NVA
5. Plotësojnë PIA-n sipas aftësive dhe nevojave të identifikuara të nxënësve
6. Përcaktojnë rezultate individuale mësimore për NVA
7. Përcaktojnë qëllimet individuale vjetro për NVA
8. Ndërlidhin rezultatet e planifikuara me vlerësimin paraprakë të nxënësve
9. Përcaktojnë materialet dhe metoda mësimore bazuar në rezultatet e planifikuara
10. Identifikojnë dhe përcaktojnë hapat për rishikim të PIA-s
11. Identifikojnë metodat e vlerësimit të nxënësve me NVA bazuar në PIA-a
12. Praktikojnë plotësimin e secilës pjesë të PIA-s (pjesa administrative, pjesa pedagogjike, faza e tranzicionit dhe pjesa rehabilituese)

Përmbajtja:	<p>Programi “Mësimdhënia cilësore në edukim dhe arsim gjithëpërfshirës” përmes katër moduleve të trajnimit parasheh që të aftësoi edukatorët dhe mësimdhënësit në qasjen e drejtë në punë me fëmijë- nxënës me nevoja të veçanta bazuar në nevojat, aftësitë e tyre në një shkollë, grup -klasë gjithëpërfshirëse. Individualizimi i programit mësimorë bazuar në aftësitë dhe nevojat e nxënësve është një domosdoshmëri për të pasur sukses në punë me nxënësit me nevoja të veçanta. Njoftimi dhe identifikimi i lehtësuesve, barrierave e po ashtu edhe aktivitete kreative siç është muzika janë pjesë e këtij programi që kanë për qëllim përmirësimin e pjesëmarrjes aktive të nxënësve me aftësi të kufizuara në një mjedis gjithëpërfshirës.</p> <p>Programi i trajnimit përveç aspektit teorik parasheh edhe punën praktike të pjesëmarrësve në mënyrë që secili të krijoj aftësi për të praktikuar njohurit e marra në kuadër të secilit modul.</p> <p>Bazuar në përmbajtjen dhe rezultatet e programit parashohim që të gjithë mësimdhënësit e trajnuar të jenë në gjendje të hartojnë dhe zbatojnë planin individual të arsimit, të përdorin qasje gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet edukative arsimore, të modifikojnë dhe përshtatin një ambient që siguron qasje të drejtë dhe barabartë për të gjithë fëmijët-nxënësit.</p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Secili modul i këtij programi do të ketë në fokus punën interaktive mes trajnerëve dhe pjesëmarrësve duke nxitur debatet produktive dhe shqyrtimin e praktikave të drejtpërdrejta të pjesëmarrësve në punën e tyre të përditshme. Do të organizohen aktivitete individuale, në qifte dhe grupe , aktivitete këto që do të kontribuojnë në arritjen e rezultateve të planifikuar të secilit modul. Puna praktike p.sh në hartimin e PIA-s, etj do t praktikohen gjatë orëve të trajnimit, prezantimi i punës së pjesëmarrësve, diskutimi grupor etj. Do të ketë edhe raste studimore që do të analizohen dhe shqyrtohen së bashku me pjesëmarrësit dhe trajnerët.</p>
Certifikimi	<p>Certifikimi i pjesëmarrësve do të bazohet në pjesëmarrjen fizike dhe aktiv të tyre në secilin modul. Pjesëmarrësit mund të ndjekin të gjitha modulet e programit dhe të certifikohen për të gjitha modulet apo edhe mund të ndjekin modulën përkatës dhe të certifikohen për modulet përkatësve varësisht nga interesat dhe nevojat e tyre.</p>
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<ol style="list-style-type: none"> 1. Igballe Asllani Potera 2. Lirije Vitija Reçica 3. Hyra Salihu 4. Dafina Ademi 5. Egzona Berisha 6. Linda Shalqini Bajramaga 7. Blerina Halilaj 8. Albana Haliti Selmani 9. Blerina Kallaba Pacolli
Data e aplikimi	22.07.2024

Titulli i Programit :	Mësimdhënia dhe nxënia e integruar
Titulli i organizatës:	INSTITUTE FOR RESEARCH AND PREVENTION OF ORGANIZED CRIME – IRPOC INSTITUTI PËR HULUMTIM DHE PARANDALIM TË KRIMIT TË ORGANIZUAR - IHPKO
Tipi i programit :	Programi Themelor
Ofertuesi i programit :	Instituti – IRPOC
Adresa:	Rr:”Agim Ramadani”, Prishtinë
E-mail:	office.ihpko@gmail.com office@irpoc.org www.irpoc.org
Telefoni:	+383 44 195 350
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr.11/2024 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	Nr.11/2024 26.02.2025
Numri dhe data e	Nr.11/2024 26.02.2024

aprovimit të programit :						
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit :	Nr.11/2024 26.02.2025 Programi aprovohet për një vit (1).					
Kohëzgjatja e programit (orë)	Programi trajnues “Mësimdhënia dhe nxënia e integruar” përfshin 4 module ku shpërndarja e orëve është si në vijim :					
		Shpërndarja e orëve				
Nr.	Modulet	Orët teorike - praktike në trajnim	Mentori m	Total	Kredi	
1	Të nxënit interdisciplinar në shkencë përmes eksperimentit	12	3	15	15	
2	Zhvillimi profesional i mësimdhënësve përmes hulumtimit					

	shkencor	12	3	15	15
3	Parandalimi dhe menaxhimi i konflikteve si formë e integruar e mësimdhënies	6	3	9	9
4	Komunikimi dhe bashkëpunimi me media si formë e integruar e mësimdhënies	6	3	9	9
	Totali	36	12	48	48

Gjithsej, Programi trajnues ka 48 orë trajnimi ku përfshihen nga 36 orë trajnim në tërsi dhe 3 orë mentorim për secilin modul. Në përgjithësi, Programi trajnues ka karakter 6 ditor (6 orë në ditë) në kuadër të realizimit të trajnimeve, pa përfshi 3 orë për secilin modul në mentorim.

Përfituesit
:

Grupet e synuara në kuadër të realizimit të këtij programi janë:

- Mësimdhënësit e shkollave fillore të mesme të ultë nga klasa 6-9
- Mësimdhënësit e shkollave të mesme të lartë 10-12

Numri optimal i pjesëmarr

15 - 20

ësve në trajnim:	
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit :	<p>Realizimi i rezultateve të pritshme të programit të trajnimit janë thelbësore për të vlerësuar suksesin dhe impaktin e tij.</p> <p>Në fund të këtij programi mësimeve do të jenë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● kuptojn dhe integrojnë informacionet e marra gjatë trajnimit; ● aplikojnë njohuritë e fituara në praktikë dhe gjatë procesit mësimor; ● përmisimi i aftësive teknike gjatë zhvillimit të aktiviteteve; ● avancojnë zhvillimin profesional në mësimeve edhe më tutje; ● reflektojnë dhe forcojnë aftësitë bashkëpunuese dhe aftësitë në zgjidhjen e problemeve me nxënësit në mënyrë që të mund të kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë; ● forcojnë kapacitetin profesional dhe bashkëpunues ndërmjet trekëndëshit mësimeve - nxënës - prindër etj.
Përmbajtja:	<p>Programi “Mësimeve dhe nxënia e integruar” përmban një program cilësor i cili synon që më anë të katër moduleve t’i pasurojë mësimeve me njohurit shtesë që vijn si rrjedhojë e Kurrikulës Bërthamë. Modulet në kuadër të programit të lartëpërmendur janë kombinim ndërmjet shkencave natyrore dhe atyre shoqërore.</p> <p>Programi trajnuar përfshin modulet si në vijim:</p> <p>MODULI 1 - Të nxënësve interdisciplinar në shkencë përmes eksperimentit</p> <p>MODULI 2 - Zhvillimi profesional i mësimeve përmes hulumtimit shkencor</p> <p>MODULI 3 – Parandalimi dhe menaxhimi i konflikteve si formë e integruar e mësimeve</p> <p>MODULI 4 - Komunikimi dhe bashkëpunimi me media si formë e integruar e mësimeve</p>
Metodat e realizimit	<p>Programi trajnuar do të ofrohet nga profesionist të fushave përkatëse të cilët gjatë laborimit të moduleve do të përdorin metodologji të avancuar profesionale me qëllim të një mësimeve</p>

<p>të programit</p>	<p>cilësore.</p> <p>Kësisoj, do të përdoren metoda të cilat ndërlidhen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kombinim me metodat të të mësuarit në baza individuale dhe grupore, • zhvillimin e procesit mësimor duke u orientuar mësimdhënësin në përdorimin e teknologjisë inovative, • orientimin në projekte, • integrimi i evoluimit gjatë procesit mësimor, • ushtrimet simuluese, • metodën interaktive me të pranishmit, • mentorimin përgjatë gjithë zhvillimit të programit dhe tutje, • sesionet e zhvillimit të projekteve, • bashkëpunimi me familje dhe komunitet, • reflektim etj.
<p>Certifikimi</p>	<p>Pjesëmarrësit duhet dëshmuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrje aktive në trajnimet e programit; • Rezultat të kalimit të testeve modulare me së paku 50% të pikëve. <p>Certifikata mund të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Certifikim i Trajnimit të Plotë; • Certifikatë e Modulit
<p>Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve</p>	<p>Lista e trajnerëve të angazhuar gjatë ofrimit të programit:</p> <p>Prof.Asoc.Dr. Arlinda Damoni Prof.Ass.Dr. Iliriana Tahiraj Prof.Ass.Dr. Rreze Gecaj Prof.Ass.Dr. Flutura Tahiraj Prof.Ass.Dr. Emine Abdyli Msc. Zana Lika</p>

Data e aplikimi	Dhjetor 2023
------------------------	--------------

Titulli i Programit:	Ndihmë psiko-edukative nxënësve me sjellje të papërshtatshme
Titulli i organizatës:	Eko - Protection
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	Eko - Protection
Adresa:	Rr. Isa Kastrati – Prishtinë
E-mail:	Ekoprotection2020@gmail.com
Telefoni:	049-541-053 - 044-415-558
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	152/2024 Data: 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	152/2024 26.02.2027
Numri dhe data e aprovimit të programit:	88/2024 - 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	88/2024 - 26.02.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	Programi organizohet në formë të një seminari 4-ditor dhe ka gjithsej 32 orë.
Përfituesit:	Ky program u dedikohet edukatorëve, mësimehdhënësve, mësimehdhënësve mbështetës, asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta, pedagogëve, psikologëve, studentëve dhe punonjësve të arsimit.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25 - 30 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Aftësimi i pjesëmarrësve (mësimehdhënësve) për krijimi e mjediseve mikpritëse dhe të sigurta që përmirësojnë gjithëpërfshirjen dhe lehtësojnë procesin e të nxënësve. Qasja e prezantuar dhe strategjitë e programit “Ndihmë psiko-edukative nxënësve me sjellje të papërshtatshme” janë një mënyrë efektive për t’ju mundësuar të gjithë fëmijëve një mjedis sa më të mirë të të nxënësve. ▪ Për t’i ndihmuar pjesëmarrësit (mësimehdhënësit), nxënësit dhe prindër, por edhe stafin e shkollës të kuptojnë qasjen e re të ndërhyrjeve për sjellje pozitive, të cilat

	<p>do të zbatohen pranë shkollave ku ata veprojnë.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Në këtë program pjesëmarrësit do të njihen mbi kuptimet e vërteta të “ndëshkimit” dhe “disiplinës”, natyrën dhe pasojat e ndëshkimit fizik, si dhe fuqinë e disiplinës pozitive. ▪ Pjesëmarrësit do të njihen pse nxënësit sillen siç dinë dhe pse ata mund të sillen dhe keq. Do të analizojnë dhe japin shembuj, duke u nisur nga këndvështrimi i tyre, se si mund të ndikojë konteksti nga ku vijnë mbi sjelljen e tyre dhe përshtypjen që ata kanë për ta, si dhe mbi rëndësinë që ka përfshirja e çdo familjeje në edukimin e sjelljes së fëmijës së vet. Gjithashtu, do të njihen me disa strategji të rëndësishme inkurajimi. ▪ Përmes veprimtarive konkrete do të njihen me krijimi i një mjedisi mësimor pozitiv dhe mbështetës për nxënësit dhe vetë ata. Po ashtu, se si sjelljet korrekte mund të zhvillohen vetëm në mjedise mësimore të organizuara dhe drejtuara mirë. ▪ Në këtë program pjesëmarrësit do të tregojnë për menaxhimin e mjedisit fizik të klasës së tyre, që ai të jetë sa më komod për mësimin dhe të nxisë sjellje të mira, edhe sikur klasa të ketë shumë nxënës. Do të shpjegojnë për rëndësinë e vendosjes së rutinave dhe të standardeve të sjelljes dhe se si të përfshihen prindërit në edukimin e sjelljes së fëmijëve të tyre. Duke qenë një shembull i rëndësishëm për nxënësit, pjesëmarrësit do të tregojnë se ç’është stili i drejtimit dhe si ta përmirësoni atë, si dhe rrugët për një stimuli pozitiv të nxënësve.
<p>Përmbajtja:</p>	<p>MODULI 1. Ndëshkimi në raport me disiplinën, kuptimi</p> <p>Çështjet kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ E kaluara dhe e tashmja e fëmijëve ▪ Ç’është “ndëshkimi” ▪ Rreziqet e ndëshkimit fizik ▪ Ç’është “disiplina” ▪ Disiplina pozitive: Ç’është ajo dhe si funksionon <p>Rezultatet e pritshme</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të kuptuarit e dallimit mes ndëshkimit dhe disiplinës. ▪ Në këtë sesion pjesëmarrësit do të njihen mbi kuptimet e vërteta të “ndëshkimit” dhe “disiplinës”, natyrën dhe pasojat e ndëshkimit fizik si dhe fuqinë e disiplinës pozitive. <p>MODULI 2. Ndërtimi i raporteve pozitive, Mësues - nxënës</p>

Çështjet kryesore:

- Bazat e marrëdhënieve mësues – nxënës.
- Përse fëmijët sillen ashtu siç dinë.
- Përse fëmijët sillen jo mirë.
- Të mësojmë rreth nxënësve duke u nisur nga vetja e tyre.
- Të kuptojmë jetën e nxënësve.
- Të mësojmë rreth familjeve të nxënësve.
- Komunikimi prindër – mësues.
- Strategjitë e inkurajimit.

Rezultatet e pritshme

- Një marrëdhënie pozitive dhe mbështetëse mes mësuesit dhe nxënësit, që bazohet te të kuptuarit dhe të mirëkuptuarit.
- Në këtë sesion pjesëmarrësit do të njihen pse nxënësit sillen siç dinë dhe pse ata mund të sillen dhe keq.
- Do të analizojnë dhe japin shembuj, duke u nisur nga këndvështrimi i tyre, se si mund të ndikojë konteksti nga ku vijnë mbi sjelljen e tyre dhe përshtypjen që ata kanë për ta, si dhe mbi rëndësinë që ka përfshirja e çdo familjeje në edukimin e sjelljes së fëmijës së vetë.
- Gjithashtu, do të njihen me disa strategji të rëndësishme inkurajimi.

MODULI 3. Krijimi i një mjedisi pozitiv që nxit të mësuarit**Çështjet kryesore:**

- Rëndësinë që ka drejtimi i orës së mësimit.
- Krijimi i një mjedisi mësimesor të këndshëm.
- Krijimi i rregullave rutinë në klasë.
- Vendosja e rregullave gjatë mësimit dhe përfshirja e prindërve.
- Ndërtimi i një stili pune që nxit sjellje të mira.
- Dhënia e kurajës pozitive.

Rezultatet e pritshme

- Krijimi i një mjedisi mësimesor pozitiv dhe mbështetës për nxënësit dhe vetë ju. Sjelljet korrekte mund të zhvillohen vetëm në mjedise mësimore të organizuara dhe të drejtuara mirë.
- Në këtë sesion pjesëmarrësit do të tregojnë për menaxhimin e mjedisit fizik të klasës së tyre, që ai të jetë sa më komode për mësimin dhe të nxisë sjellje të mira,

	<p>edhe sikur klasa të ketë shumë nxënës.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Do të shpjegojnë për rëndësinë e vendosjes së rutinave dhe të standardeve të sjelljes dhe se si të përfshihen prindërit në edukimin e sjelljes së fëmijëve të tyre. ▪ Duke qenë një shembull i rëndësishëm për nxënësit, pjesëmarrësit do të tregojnë se ç'është stili i drejtimit dhe si ta përmirësoni atë, si dhe rrugët për një stimuli pozitiv të nxënësve.
Metodat e realizimit të programit	<p>Metodologjia e realizimit të programit trajnues do të jetë një gërshetim i punës në grupe dhe individuale, përmes disa veprimtarive, siç janë: <i>studim rasti, strategji reflektimi dhe strategji veprimi</i>. Shumicën e aktiviteteve të kryhen praktikisht gjatë programit trajnues. Programi organizohet përmes moduleve trajnuese që zgjasin 4 ditë trajnimi. Gjatë katër ditëve të trajnimit ofrohet e gjithë përmbajtja e trajnimit. Ndërsa, në sesionin e fundit pjesëmarrësit do të shpjegojnë dhe japin shembuj duke treguar një larmi rrugësh se si t'i trajtojnë sjelljet sfiduese, rrugët e parandalimit të tyre dhe mënyrat e zgjidhjes së konflikteve. Gjithashtu, disa teknika të disiplinës pozitive në përshtatje me mosha të caktuara, si dhe ato për fëmijë që kanë nevoja të veçanta.</p>
Certifikimi	Kusht për certifikim (32 orë) është pjesëmarrja mbi 80% në seminar.
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	Dr.sc. Lon Laska Dott. Mag. Arben Zabeli
Data e aplikimi	14.12.2023

Titulli i Programit:	Ngritja e Kapaciteteve në Udhëheqjen Arsimore
Titulli i organizatës:	Instituti Për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA) – Fakulteti I Edukimit - UP
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	Instituti Për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA) – Fakulteti I Edukimit - UP
Adresa:	Fakulteti i Edukimit Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Rr. Agim Ramadani, nr. 350, 10000 Prishtinë, Kosovë
E-mail:	blerim.saqipi@uni-pr.edu
Telefoni:	+ 383 38 22 92 01
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	/
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	/
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr. 141/2024 Datë: 16.01.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr. 141/2024 Datë: 16.01.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	154 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit dhe profesionistët të tjerë në arsim
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20-25 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<ul style="list-style-type: none"> • Njihen me legjislacionit dhe mënyrat e zbatimit të tij për të avancuar dhe siguruar cilësinë në arsim. • Analizojnë dhe zbatojnë forma praktike të mbështetjes së procesit të mësimdhënies dhe të nxënies • Diskutojnë dhe planifikojnë përfshirjen e të gjithë fëmijëve/nxënësve në shkollë • Planifikojnë dhe fillojnë së zbatuari pjesë të Planit Zhvillimor të Shkollës si dhe menaxhojnë projekte të ndryshme praktike • Provojnë forma të efektshme të komunikimit dhe bashkëpunimit me akterët

	<p>e shkollës</p> <ul style="list-style-type: none"> • Planifikojnë dhe zbatojnë udhëzimet për menaxhim të personelit të shkollës. • Zbatojnë forma efektive të menaxhimit të shkollës dhe udhëheqjes së takimeve.
Përmbajtja:	<p>Moduli 1: E drejta për edukim – edukimi cilësor - Ky modul prezanton konceptin e cilësisë së arsimit në kontekstin ndërkombëtar dhe kombëtarë, nënvizon marrëdhënien në mes të cilësisë së arsimit dhe rritjes ekonomike. Moduli gjithashtu trajton disa komponentët Standardeve për praktikën profesionale të drejtorëve të shkollës.</p> <p>Moduli 2: Shkolla e mirë – mësimdhënia dhe të nxënësve cilësorë – Trajton fushat e cilësisë së shkollës dhe fushat për zhvillim të shkollës sipas PSAK (2017/2021), duke u fokusuar në kulturën e të mësuarit, kulturën e shkollës dhe nevojën për një strategji dhe vizion të zhvillimit të cilësisë në aspektin afatgjatë dhe afatmesëm bazuar në dokumente të hartuara për zbatim të Kurrikulës, zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe vlerësimit të nxënësve.</p> <p>Moduli 3: Gjithëpërfshirja në arsim - Ky modul trajton tematikën e gjithëpërfshirjes në shkolla në mënyrë që të mbështesë udhëheqësit në sigurimin e ambientit gjithëpërfshirës në shkollë për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë të nxënësve me nevojave të ndryshme mësimore në klasat/shkollat e sotme. Moduli gjithashtu synon t'i ekspozojë pjesëmarrësit me të dhëna dhe situata të ndryshme duke diskutuar aspektet e gjithëpërfshirjes në arsim në Kosovë.</p> <p>Moduli 4: Plani zhvillimor i shkollës dhe menaxhimi i projektit – Ky modul ofron një qasje të strukturuar për të shtjelluar planin për zhvillim të shkollës. Formatit dhe udhëzuesi i Planit Zhvillimor të Shkollës (PZHSH) mbështetë këtë proces duke ofruar një strukturë për hapat e njëpasnjëshëm që janë të nevojshëm për të identifikuar projektet primare për vitin e radhës. Fazat e inicimit, planifikimit, ekzekutimit dhe vlerësimit të projektit shpjegohen në bazë të ciklit për menaxhim të projektit.</p> <p>Moduli 5: Komunikimi dhe bashkëpunimi – Komunikimi në një shkollë përshkruhet në detaje. Trajtohet komunikimi dhe bashkëpunimi me dhe në mes të arsimtarëve, nxënësve dhe prindërve, si dhe komunikimi ndërmjet shkollave përmes rrjetëzimit (komunitete e të mësuarit së bashku). Prezantohet baza ligjore, përbërja dhe roli i strukturave të ndryshme të shkollës siç janë: Këshilli Drejtues i Shkollës, Këshilli i nxënësve, Këshilli i prindërve.</p>

	<p>Moduli 6: Udhëheqja dhe menaxhimi i personelit – Prezantohen disa lloje të udhëheqjesë tema e delegimit shpjegohet në detaje. Nevoja për zhvillim sistematik të stafit, bazuar në vlerësim individual, zhvillimi profesional i mësimeve dhe stafit jomësor, prezantohen dhe diskutohen.</p> <p>Moduli 7: Administrimi efektiv i shkollës dhe udhëheqja e takimeve – Moduli mbi administratën në shkollë fokusohet në menaxhimin e suksesshëm të kohës, dhe administrimin e dokumenteve, duke përfshirë arkivimin e dokumenteve elektronike dhe fizikeë planifikimin, organizimin dhe kryesimin e takimeve në mënyrë produktive.</p>
Metodat e realizimit të programit	Gjatë trajnimit do të përdoret metoda interaktive e punës, ku pjesëmarrësit do të jenë në qendër të veprimtarisë, do të punohet në grupe dhe në vazhdimësi do të përdoren forma e ndryshme të punës që të mbajnë aktiv gjatë tërë kohës. Pas secilës punëtori do të organizohen sesione monitoruese ku do të përcillet puna dhe progresi i pjesëmarrësve.
Certifikimi	Po
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<p>14 trajner</p> <p>Naser Zabeli Blerim Saqipi Majlinda Gjellaj Rozafa Ferizi Shala Blerta Perolli Shehu Albulena Metaj Teuta Danuza Fjolla Kacaniku Ismet Potera Osman Buleshkaj Selim Mehmeti Zana Zeqiri Jeta Aliu Luljeta Shala</p>

Titulli i Programit:	Ngritja e kapaciteteve për rishikim dhe përmirësim të teksteve shkollore
Titulli i organizatës:	EU KosEd dhe Instituti Pedagogjik i Kosovës
Tipi i programit:	Program themelor
Ofertuesi i programit:	EU KosEd dhe Instituti Pedagogjik i Kosovës
Adresa:	MASHTI, Kati IV ose Rr. Lorenc Antoni nr. 38 Prishtinë
E-mail:	mihaela_singer@dai.com isme.potera@rks-gov.net
Telefoni:	+383 (0)38 212 850
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr. 154/2024 Datë: 22.04.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	Nr. 154/2024 Datë: 22.04.2026
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr. 154/2024 Datë: 22.04.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr. 154/2024 Datë: 22.04.2026
Kohëzgjatja e programit(orë)	48 orë
Përfituesit:	Pjesëmarrësit përfaqësojnë disa nivele dhe fusha të mësimdhënies dhe arsimit përgjithësisht, duke përfshirë: mësimdhënësit e Niveleve 1 dhe 2 dhe 3, koordinatorët e cilësisë, pedagogë e psikologë, drejtorë shkollash, zyrtarë të DKA-ve dhe Inspektorë të arsimit.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25
Rezultatet e pritura	Rezultatet e pritshme të programit:

<p>ose objektivat e programit:</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Forcon kapacitetin e pjesëmarrësve për të mbledhur të dhëna specifike për cilësinë e teksteve aktuale. • Zhvillon kompetencat e pjesëmarrësve për identifikimin e fushave të teksteve shkollore që kërkojnë përmirësim. • Rrit kompetencën dhe angazhimin e pjesëmarrësve për të ofruar rekomandime për ndërhyrje të fokusuar që synojnë përmirësimin e teksteve ekzistuese. • Ngrit kapacitetin e mësimeve për përdorimin e kriterëve dhe përshkruesve për të vlerësuar tekstet shkollore • Ndërlidh kurrikulën e bazuar në kompetenca me përmbajtjen e teksteve shkollore • Përpilon raporte informative, të bazuara në dëshmi për cilësinë e një teksti shkollor • Analizon dhe jep komente për cilësinë e teksteve shkollore duke dhënë rekomandime të detajuara për përmirësimin e teksteve shkollore.
<p>Përmbajtja:</p>	<p>Përmbajtja sipas ditëve</p> <p>Dita e parë: Në ditën e parë të trajnimit do të bëhet prezantimi i kandidatëve si dhe prezantimi i programit të trajnimit. Kandidatët do të njoftohen me kriteret dhe përshkruesit e rishikimit të teksteve shkollore. Fillimisht trajnerët do të prezantojnë gjetjet e tyre (<i>si model i punës</i>) në tekstet aktuale nga lëndët e caktuara dhe përshtatja e këtyre gjetjeve me kriteret dhe përshkruesit. Dita e parë karakterizohet me prezantim dhe diskutim për kriterin 1 (<i>struktura e tekstit shkollor</i>) dhe 2 (<i>saktësia e përmbajtjes</i>) si dhe përshkruesit e këtyre kriterëve.</p> <p>Dita e dytë: Dita e dytë fillon me leximin dhe analizimin e skedave të daljes nga dita paraprake. Trajnerët do të përpqen që pyetjet e kandidatëve të marrin përgjigje dhe të adoptohen në kuadër të kësaj dite. Në ditën e dytë të trajnimit trajnerët do të prezantojnë gjetjet e tyre (<i>si model i punës</i>) në tekstet aktuale nga lëndët e caktuara dhe përshtatja e këtyre gjetjeve me kriteret dhe përshkruesit. Dita e dytë karakterizohet me prezantim dhe diskutim për kriterin e tretë (<i>efektiviteti i strategjive të të nxënësve</i>), të katërt (<i>saktësia dhe qasja e gjuhës</i>) dhe kriterin e pestë (<i>cilësia e paraqitjes dhe dizajni</i>) si dhe përshkruesit e këtyre kriterëve.</p> <p>Dita e tretë: Në ditën e tretë të trajnimit, kandidatët do të kenë mundësi që të prezantojnë raportet e tyre bazuar në kriteret si dhe përshkruesit e caktuar. Pas çdo</p>

	<p>prezantimi, ofrohet mundësia e diskutimit të raportit, dhënies së sugjerimeve dhe komenteve konstruktive me qëllim të përmirësimit të raportit në tërësi. Në përfundim të ditës së tretë, kandidatët plotësojnë fletë vlerësimin e trajnimit i cili shërben për nevojat e programit dhe në dobi të rritjes së efikasitetit të programit.</p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Programi trajnues dhe materialet përkatëse ofrojnë informacione bazike lidhur me temat, ndërlidhjen e tyre me praktikën aktuale dhe ato inovative si dhe mundësitë për zbatim të efektshëm në nivel shkollor. Programi trajnues ofrohet sipas orarit të planifikuar në bashkëpunim me DKA dhe shkolla, kryesisht gjatë ditëve të fundjavës, për të mos ndërhyrë në orarin e mësimin të rregullt.</p> <p>Qasja e përzgjedhur ofron mundësi që të gjithë pjesëmarrësit të jenë të përfshirë pa ngarkesën dhe obligimet gjatë ditëve të punës. Të gjithë pjesëmarrësit, nën udhëheqjen e trajnerëve dhe zyrtarëve të DKA, realizojnë procesin e rishikimit dhe përmirësimit të teksteve shkollorë. Kjo mënyrë e punës dhe e bashkëpunimit ndërmjet pjesëmarrësve në grup mundëson realizimin e detyrave në mënyrë profesionale dhe cilësore.</p> <p>Gjithashtu, ky program dhe materialet udhëzuese mund të përdoren nga DKA dhe Inspektorati i Arsimit për të monitoruar dhe për të mbështetur punën e pjesëmarrësve gjatë procesit të vazhdueshëm të rishikimit. Çdo seksion përmban prezantime të bëra nga anëtarët e ekipit të trajnimit të ndjekura nga aktivitete/detyra të dizajnuara për të trajnuarit. Çdo prezantim përmban pjesë teorike dhe shembuj praktikë, si dhe ilustrime të bazuara në tekste për rishikim.</p>
Certifikimi	Certifikata për pjesëmarrje dhe përfundim me sukses të programit dhe kërkesave specifike të tij.
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<p>Trajnerët e programit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mihaela Singer 2. Armend Shabani 3. Fadil Latifi 4. Dije Shatri 5. Ismet Potera 6. Luljeta Shala 7. Selim Mehmeti 8. Bekim Morina 9. Arbnesha Mexhuani 10. Mevlude Aliu-Gashi

	11. Murteza Osdautaj 12. Lirie Bytyqi Beqiri
Data e aplikimit	18.04.2024

Titulli i Programit:	Ofrimi i mbështetjes për mësimdhënësit e arsimit fillor për përmirësimin e aftësive të nxënësve në shkrim-lexim
Titulli i organizatës:	Instituti Pedagogjik i Kosovës
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	Instituti Pedagogjik i Kosovës
Adresa:	Rr. Lorenc Antoni nr. 38. Prishtinë, 10000
E-mail:	Lirije.Bytyqi@rks-gov.net
Telefoni:	038/212-645
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Instituti Pedagogjik i Kosovës është institucion i pavarur, publik, hulumtues, kërkimor shkencor i themeluar nga MASHT-i. Pozita juridike e IPK është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ Nr. 8/2017, datë 21.07.2017. Funkcionet e Institutit Pedagogjik të Kosovës janë: analizat, hulumtimet, trajnimet, krahasimet dhe vlerësimin në fusha të ndryshme të arsimit në Kosovë.
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr. 24/24 Datë: 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	26.02.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	3 vite
Përfituesit:	Mësimdhënësit e Arsimit Fillor dhe mësimdhënësit e gjuhëve.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim është 15-25.
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Në përfundim të programit të trajnimit, secili nga pjesëmarrësit duhet të arrijë këto rezultate: -Identifikon vështirësitë e nxënësve në shkrim dhe lexim; -Përdor instrumentet e vlerësimit individual dhe grupor të shkathhtësive të leximit dhe shkrimit; -Analizon dhe interpreton rezultatet e dala nga instrumentet e vlerësimit; -Përdor metoda alternative të mësimdhënies për punë me nxënësit që kanë vështirësi në lexim dhe shkrim;

	<p>-Krijon materiale alternative të të nxënit për të mbështetur nxënësit që kanë vështirësi në shkrim dhe lexim;</p> <p>-Harton dhe zbaton plane individuale për nxënësit me vështirësi në shkrim dhe lexim;</p> <p>-Ofron mbështetje për nxënësit me vështirësi në shkrim dhe lexim;</p> <p>-Udhëzon drejtë mësimdhënësit tjerë si t' u ofrohet mbështetja nxënësve me vështirësi në shkrim dhe lexim.</p>
<p>Përmbajtja:</p>	<p>Gjatë dy ditëve sa zgjatë trajnimi temat kryesore që do të shqyrtohen janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ <u>Vështirësitë në shkrim dhe lexim;</u> <p>Në kuadër të kësaj teme do të shqyrtohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Aspektet konceptuale lidhur me vështirësitë në shkrim dhe lexim; -Dallimet mes nxënësve me vështirësi dhe nxënësve me nevoja të veçanta; -Llojet e vështirësive në shkrim dhe lexim; -Karakteristikat e nxënësit me vështirësi në shkrim dhe lexim. <ul style="list-style-type: none"> ❖ <u>Identifikimi i nxënësve me vështirësi në shkrim dhe lexim;</u> <p>Mësimdhënësit do të informohen dhe përgatiten për:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Identifikimin e vështirësive në shkrim dhe lexim; -Përdorimin e instrumenteve të vlerësimit individual dhe vlerësimit; grupor të shkathtësive të leximit dhe shkrimit; -Interpretimi i rezultateve të testimit. <ul style="list-style-type: none"> ❖ <u>Planifikimi individual</u> <p>Mësimdhënësit do t' u ofrohen informacione të nevojshme dhe do të aftësohen për:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Hartimin e planit individual për nxënësit me vështirësi në shkrim dhe lexim; -Zbatimin e planit individual <ul style="list-style-type: none"> ❖ <u>Organizimi i punës për nxënësit me vështirësi në shkrim dhe lexim;</u> <p>Do të ofrohen informacione për organizimin e punës me nxënësit me vështirësi në lexim dhe shkrim:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Krijimi i grupeve të leximit dhe shkrimit; -Puna me grupet e leximit dhe shkrimit. <ul style="list-style-type: none"> ❖ <u>Materialet didaktike që ndihmojnë në tejkalimin e vështirësive në shkrim dhe lexim;</u>

	<p>Fokusi është në:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Hartimin e materialeve didaktike -Përdorimi i materialeve didaktike <p>Përveç pjesëmarrjes në trajnim, mësime dhe angazhohen edhe me punë praktike në shkollë. Organizimi dhe realizimi i mësimit plotësues për nxënësit me vështirësi në shkrim dhe lexim, bëhet nën udhëheqjen e koordinators të projektit me bazë në shkollë si dhe e tërë puna monitorohet e mentorohet nga koordinatori i projektit në shkollë dhe trajnerët e programit.</p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Aktivitetet kryesore në kuadër të programit janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Trajnimi i mësimeve, 2. Puna praktike me nxënësit me vështirësi, 3. Mentorimi <p>Trajnimi i mësimeve fokusohet në njohuri të përgjithshme për vështirësitë, identifikimin e nxënësve me vështirësi në shkrim dhe lexim, planifikimin e punës me nxënësit me vështirësi, krijimin e materialeve didaktike të cilat ndihmojnë në tejkalimin e vështirësive në shkrim dhe lexim.</p> <p>Në kuadër të punës praktike me nxënësit me vështirësi parashihet puna e mësimeve në identifikimin e vështirësive të nxënësve në shkrim dhe lexim, hartimin e Planeve Individuale të Arsimit, angazhimin në punë plotësuese me nxënësit me vështirësi, përgatitjen e raporteve për punën e tyre me nxënësit me vështirësi në grupet e leximit dhe shkrimit.</p> <p>Mentorimi i punës së mësimeve me nxënësit me vështirësi bëhet nga trajnerët gjatë kohës kur organizohet puna me grupet e nxënësve me vështirësi.</p>
Certifikimi	<p>Në kuadër të programit të trajnimit, pjesëmarrësit e përfshirë në trajnim do të certifikohen për 60 orë pune, e që shpërndarja e orëve do të jetë si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrje në trajnim (12 orë), - Punë praktike (48 orë), si: <ul style="list-style-type: none"> ✓ identifikimin e nxënësve me vështirësi (8 orë), ✓ hartimin e planeve individuale për nxënësit me vështirësi (14 orë),

	<ul style="list-style-type: none">✓ punë plotësuese me nxënës e identifikuar me vështirësi (16 orë), si dhe✓ përgatitjen e raporteve me shkrim për punën me nxënësit me vështirësi në shkrim (10 orë).
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	Për këtë program trajnimi është planifikuar angazhimi i dy trajnerëve: Lirije Bytyqi Beqiri Sahare Reçica Havolli
Data e aplikimit	14.12.2023

Titulli i Programit:	Parimet dhe puna profesionale përmes ABA me nxënësit me spektrin e AUTIZMIT: Metodatat dhe strategjitë e avancuara për zhvillimin funksional të nxënësve me nevoja të veçanta
Titulli i organizatës:	Qendra Profesionale për Gjithpërfshirje – QPGJ - OJQ
Tipi i programit:	Parimet dhe puna profesionale përmes ABA me nxënësit me spektrin e AUTIZMIT: Metodatat dhe strategjitë e avancuara për zhvillimin funksional të nxënësve me nevoja të veçanta
Ofertuesi i programit:	Qendra Profesionale për Gjithpërfshirje - QPGJ
Adresa:	Veternik p.n., Prishtina, Kosova
E-mail:	info@qendraprofesionale.org
Telefoni:	+383 49 183 156
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr.09/2024 – 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	Nr.09/2024 – 26.02.2025
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr.09/2024 – 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr.09/2024 – 26.02.2025
Kohëzgjatja e programit(orë)	20 orë
Përfituesit:	Përfituesit e programit përfshijnë një gamë të gjerë mësimdhënësish nga të gjitha nivelet dhe shkollat parauniversitare, duke përfshirë edukatorët, shkolla fillore, të mesme të ulta dhe larta, gjimnaze dhe ato profesionale.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20 deri në 25 mësimdhënës për grup
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Programi i trajnimit synon të ofrojë rezultate të matshme dhe të qëndrueshme që kontribuojnë në përmirësimin e aftësive dhe njohurive të mësimdhënësve për të trajtuar fëmijët me autizëm përmes metodologjisë së Analizës së Aplikuar të Sjelljes (ABA).

Këto rezultate lidhen ngushtë me qëllimet e programit dhe fushën prioritare të përzgjedhur. Në vijim janë përshtatur aktivitetet e programit me rezultatet e pritshme:

1. Rritja e Njohurive Profesionale:
 - Aktivitetet e Programit: Hyrje mbi spektrin e autizmit dhe karakteristikat e tij/ Diskutim mbi evidencat empirike mbi autizmin dhe ABA.
 - Rezultatet e Pritshme: Pjesëmarrësit do të përfitojnë njohuri të thella rreth etiologjisë dhe karakteristikave të autizmit dhe ndërlihdjen me vështirësitë tjera në funksionim të përgjithshëm.
2. Kuptimi dhe Identifikimi i Metodave dhe Strategjive për Punën Profesionale me Fëmijë me Autizëm përmes ABA:
 - Aktivitetet e Programit: Strategjitë e avancuara të bazuara në ABA për zhvillimin e komunikimit tek fëmijët me autizëm/Zbatimi i teknikave të specializuara për identifikimin e metodave efektive.
 - - Rezultatet e Pritshme: Ngritja e aftësive për identifikimin e karakteristikave dhe sfidave të fëmijëve në spektrin e autizmit / Kuptimi i thellë i metodave dhe strategjive të ABA për të përmirësuar zhvillimin funksional të fëmijëve me autizëm.
3. Zbatimi dhe Përshtatja e Metodave në punën me fëmijë me autizëm: Parimet e Analizës së Aplikuar të sjelljes (ABA):
 - - Aktivitetet e Programit: Diskutim panel: Shkëmbimi i përvojave nga ekspertët e fushës dhe aplikuesit e ABA/Bashkëpunimi me prindërit dhe familjet e fëmijëve me autizëm.
 - - Rezultatet e Pritshme: Përmirësimi i aftësive për zbatimin e metodave të mësuara në praktikë/Përshtatja e teknikave të avancuara sipas nevojave dhe karakteristikave të individuale.
4. Mbështetja Sociale dhe Emocionale për fëmijët me autizëm:
 - Aktivitetet e Programit: Zhvillimi kognitiv dhe gjuhësor te

	<p>fëmijët me autizëm/Ndihma në zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale të fëmijëve me autizëm duke përdorur metodologjinë ABA.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rezultatet e Pritshme: Ngritja e aftësive për të trajtuar sfidat kognitive dhe gjuhësore të fëmijëve me autizëm përmes ABA/Përmirësimi i aftësive për të përdorur strategji për zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale të këtyre fëmijëve
Përmbajtja:	<p>Përmbajtja e programit është strukturuar në mënyrë të gjerë për të përmbushur nevojat e profesionistëve që janë të përfshirë në trajnim. Fillimi i programit ofron një hyrje të detajuar mbi Autizmin, duke trajtuar temat si etiologjia, karakteristikat, shkaqet dhe prevalenca, duke arritur deri te roli i prindërve në trajtim. Ky segment siguron një bazë të fortë për njohuritë e pjesëmarrësve.</p> <p>Aktivitetet praktike përfshijnë ligjerata, prezantime, diskutime paneli, punë individuale, grupe, analiza rastesh dhe zgjidhje të problemeve. Këto aktivitete inkurajojnë pjesëmarrësit të aplikojnë njohuritë e fituara në situata reale dhe të ndajnë përvojën dhe praktikën e tyre me kolegët.</p> <p>Objektivat e programit synojnë rritjen e njohurive profesionale duke ofruar informacion dhe njohuri të përditësuara, prezantimin e metodave dhe strategjive të avancuara për zhvillimin funksional të fëmijëve me autizëm si dhe inkurajimin dhe aftësimin e profesionistëve për zbatimin e këtyre metodave në praktikë, me fokus Analizën e Aplikuar të Sjelles (ABA). Bashkëpunimi me prindërit dhe menaxhimi i sjelljeve të papërshtatshme gjithashtu përfshihen si elementë kyç në trajnim, për të siguruar një përmirësim të përgjithshëm të aftësive dhe njohurive të mësimit.</p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Metodologjia e përdorur gjatë ofrimit të programit trajnues është e karakterizuar nga një qasje holistike dhe interaktive, duke kombinuar disa metoda efektive të mësimit.</p> <p>- Ligjeratat dhe prezantimet do të përdoren për të sjellë një hyrje të detajuar në temat kryesore të trajnimit dhe për të krijuar një</p>

	<p>kornizë konceptuale për pjesëmarrësit. Diskutim panelet me kolegët kanë shërbyer për prezantimin dhe diskutimin e evidencave empirike mbi sfidat në përpilimin e një plani individual të mirëfillt dhe të përshtatshëm për fëmijët me novaja të veçanta arsimore, duke synuar përmirësimin e kuptimit mbi temat komplekse që tangojnë mësimdhënësit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Puna në grup do të përdoret me qëllim inkurajimi të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave midis pjesëmarrësve. Ky format ka për qëllim përmirësimin e aftësive të tyre për të aplikuar konceptet teorike në situata reale. - Përdorimi i rasteve studimore do të ndihmojë në paraqitjen e sfidave reale dhe skenarëve të ngjashëm me ato të përditshme në profesionin e tyre, duke synuar forcimin e aftësisë për të zgjidhur probleme specifike. - Aktivitetet e zgjedhjes së problemeve kanë qëllim për të inkurajuar pjesëmarrësit të identifikojnë dhe zgjidhin sfida të caktuara në punën e tyre, duke promovuar një qëndrim proaktiv dhe zgjidhje inovative. Metodologjia e programit është fokusuar në pjesëmarrjen aktive, duke përfshirë shkëmbimin e përvojave, diskutimet interaktive dhe situata praktike për të siguruar një përvojë të pasur dhe të aplikueshme. Për më tepër, qasja multidisiplinore dhe përfshirja e ekspertëve të fushës synon të kontribuojë në një trajnim holistik dhe të përshtatshëm për profesionistët që janë të përfshirë në punën e tyre me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.
Certifikimi	Se paku 80% pjesëmarrje në sesionet e planifikuara
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	Dr. Natyra Agani Destani, Dr. Ereblir Kadriu, Arbësa Uka, Genta Jahiu, Blerina Bytyqi, Ilirjana Mehmeti
Data e aplikimi	Dhjetor 2023

Titulli i Programit:	Planifikimi i mësimdhënies produktive
Titulli i organizatës:	QEHT "KONICA"
Tipi i programit:	Program Plotësues
Ofertuesi i programit:	QEHT "KONICA"
Adresa:	rr. Muharrem Fejza, p.n. Prishtinë
E-mail:	qeht.konica@gmail.com
Telefoni:	049 328 528
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr. 141 / 2024, date 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	26.02.2025
Numri dhe data e aprovimit të programit:	nr. 73/73, datë 10.06.2022
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	10.06.2024
Kohëzgjatja e programit(orë)	32
Përfituesit:	Mësimdhënësit e arsimit parauniversitar
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Çdo mësimdhënës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përcaktojë qëllimin e mësimit sipas nevojave të nxënësve; • Të për zgjedhë dhe organizojë përmbajtjen mësimore; • Të planifikojë orën mësimore bazuar në veprimtaritë dhe rezultatet e parashikuara; • Të ketë vizion të plotë dhe afatgjatë të qëllimeve mësimore;

	<ul style="list-style-type: none"> • Të përshtatë metodat mësimore krahas ritmit të materialit, mënyrës së paraqitjes, organizimit dhe menaxhimit të klasës; • Ta përvetësojë njohuritë për krijimin e strukturës për përmbajtjen e orës mësimore; • Të fitoj njohuri për paraqitjen e materialit në mënyrën më të përshtatshme që të përvetësohet nga nxënësit. • Përgatiten për zbatimin efektiv të vlerësimit të nxënësve sipas kurrikulës së bazuar në kometenca.
Përmbajtja:	<p><i>Përmbajtja e programit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Planifikimi i mësimdhënies produktive <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënësit e suksesshëm planifikojnë me sukses • Planifikimi dhe përgatitja • Njohuritë e mësimdhënësit si vendimmarrës; • Qëllimet dhe funksionet e planifikimit. • Përbërësit e planit ditor <ul style="list-style-type: none"> • Tërheqja e vëmendjes; • Komunikimi i objektivave; • Paraqitja e materialit. • Formimi i sjelljes së dëshirueshme <ul style="list-style-type: none"> • Sigurimi i komenteve dhe informacionit të ndërsjellë; • Vlerësimi i sjelljes. <p><i>Aktivitetet e praktikuarat:</i> Gjatë trajnimit, përveç pjesës teorike, mësimdhënësit do të angazhohen në aktivitete praktike dhe simuluese pas çdo teme kryesore. Gjithashtu, kandidatëve të trajnimit do t'u ofrohen teste të cilat kanë për qëllim testimin e njohurive të tyre lidhur me menaxhimin e klasës dhe disiplinën, si dhe do t'u ofrohen detyra përkatëse që kanë për qëllim përforcimin e njohurive të tyre lidhur me temat e ligjëruara.</p>
Metodat e realizimit të programit	<ul style="list-style-type: none"> • Ligjërime • Prezantim me Powerpoint • Shembuj praktikë përmes detyrave gjatë trajnimit; • Ushtrime • Aktivitete atraktive • Kombinim i materialeve tekst dhe video.
Certifikimi	PO
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	Vaxhide Spahiu
Data e aplikimi	

Titulli i Programit:	Plani individual i arsimit
Titulli i organizatës:	Qendra Burimore për mësim dhe këshillim “Xheladin Deda”
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Qendra Burimore për mësim dhe këshillim “Xheladin Deda”
Adresa:	Rruga Bill Clinton, nr. 183 Pejë
E-mail:	shvqb.peje@gmail.com
Telefoni:	+383 39 410 355
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	N/A
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	N/A
Numri dhe data e aprovimit të programit:	26.02.2024 Nr. 02/2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	26.02.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	Trajnimi zgjat 2 ditë (16 orë)
Përfituesit:	Ky trajnim është i paraparë për mësimdhënësit e niveleve fillor, mesëm i ultë dhe i mesëm i lartë në institucionet arsimore në Kosovë, në ato institucione që kanë, apo që do të pranojnë të regjistrojnë fëmijë të verbër dhe me dëmtime në të parë.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Trajnimi mbahet me pjesëmarrje direkte në grupe deri 20 persona
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Mësimdhënësit në qendër burimore dhe shkollat e rregullta aftësohen për hartimin dhe zbatimin e PIA për punë me të verbër dhe fëmijë me të parë të dobësuar

Përmbajtja:	<p>Programi është i dizajnuar për mësime të përbashkëta në shkollat e rregullta në Kosovë dhe përbëhet nga këto tema:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Nevoja për individualizimin e planit për FNVA 2. Përgjegjësia për hartimin e planit individual dhe puna në grup 3. Plani individual i arsimit udhëzimet për plotësim 4. Pjesa administrative 5. Pjesa pedagogjike 6. Pjesa rehabilituese 7. Planifikimi i tranzicionit 8. Roli i mësuesit në hartimin e PIA
Metodat e realizimit të programit	<p>Trajnimi mbahet me pjesëmarrje direkte në grupe deri 20 persona. Trajnimi është interaktiv dhe përmban pjesë teorike të prezantimeve dhe punën praktike individualisht dhe në grupe që bëhet nga pjesëmarrësit në trajnim. Një pjesë e trajnimit konsiston në punën praktike dhe ushtrime të hartimit të PIA, duke përfshirë sipas mundësive edhe administrimin dhe e një rasti dhe punë konkrete me dosjen e një fëmije.</p> <p>Grupet për trajnime krijohen në bazë në shkollë, apo në komuna, dhe preferohet të bëhen në bashkëpunim me DKA-të për mësuesit në nivel komuna, apo përmes Divizionit për Gjithëpërfshirje për grupe të kombinuara të mësuesve që duan të marrin aftësimin bazik në këtë fushë.</p>
Certifikimi	Certifikatë e trajnimit
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<p>Ahmet Mahmutaj, Profesor i edukatës fizike Enver Ulaj, Koordinator i Qendrës së trajnimeve; profesor, trajner Ilirjana Shehu, Ekspert i intervenimit të hershëm për fëmijët e verbër Ganimete Sejdiu, Mësime të përbashkëta Mahije Mahmutaj, Mësime të përbashkëta</p>
Data e aplikimit	06.12.2023

Titulli i Programit:	PLAYDAGOGY - Diskriminimi në bazë te Gjinisë
Titulli i organizatës:	PLAY International
Tipi i programit:	Program Plotësues
Ofertuesi i programit:	PLAY International
Adresa:	Rr. Agim Ramadani, 32, Prishtinë, 10000
E-mail:	vlorian.molliqaj@play-international.org
Telefoni:	+383 44 946 091
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	145/2024 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	145/2024 26.02.2027
Numri dhe data e aprovimit të programit:	3-1856 26.06.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	3-1856 21.06.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	17
Përfituesit:	Mësimdhënësit të nivelit të ulët (1-5)
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	120 (të ndarë në 5 grupe)
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Ky program trajnimi synon të pajis mësimdhënësit me njohuri dhe mjete për:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të ngritur vetëdijen e fëmijëve rreth diskriminimit dhe diskriminimit të bazuar në gjini, 2. Për të mbështetur nxënësit në njohjen e efekteve të diskriminimit dhe si të reagojnë dhe 3. Për të përkrahur sjellje më gjithëpërfshirëse tek nxënësit, që përkundër dallimeve, të gjithë kanë një vend në shkollë.

Përmbajtja:

Trajnimi ballë për ballë: Gjatë trajnimit mësimdhënësit do të përfitojnë njohuri për tema të ndryshme në lidhje me ambientin shkollor (diskriminimin dhe përfshirjen e të gjithëve). Mësimdhënësit do ta kenë mundësinë të reflektojnë dhe të ndajnë përvojën e tyre sa i përket këtyre temave. Ata do të pajisen me aftësi për të udhëhequr sesionet socio-sportive, përfshirë aftësitë bazike të animacionit të sportit, menaxhimit grupor, metodologjisë Playdagogy dhe udhëheqjes së debatit. Trajnimet po ashtu do të ofrojnë një mundësi për mësimdhënësit që të krijojnë një rrjet të kolegëve të angazhuar për ndryshim social përmes arsimit. Ata do të jenë në gjendje të takohen me mësimdhënës nga prejardhje të shumëllojshme dhe shkolla të ndryshme dhe të shkëmbejnë përvojën e tyre të mësimdhënies dhe përdorimin e sportit si një mjet arsimor.

Fusha e zbatimit të aktiviteteve sportive: Ndërsa zbatojnë sesionet Playdagogy me fëmijë nga shkollat e tyre, mësimdhënësit do të testojnë dhe përmirësojnë aftësitë e tyre gjatë situatave reale. Ata do të njoftohen edhe më shumë dhe do të ndjehen më rehat me temat e ndryshme të trajtuara gjatë sesioneve sportive. Duke qenë pjesëmarrës në aktivitetet e Playdagogy-së të zbatuara nga mësimdhënësit, fëmijët do të përmirësojnë njohuritë e tyre dhe do t'i vënë në dyshim sjelljet e tyre sa i përket temave në lidhje me rëndësinë e një mjedisi mësimor më paqësor dhe gjithëpërfshirës.

Metodat e realizimit të programit

Një kombinim i metodologjive të shumëllojshme janë përdorur për këtë program trajnimi:

- **Prezantimet interaktive** (sllajde në Power Point, pyetje-përgjigje, pyetësorë, etj.) përdoren për të prezantuar qëllimet dhe temën e trajnimit;
- **Ushtimet grupore dhe të vetë-reflektimit** (debate, lojë-rolesh, aktivitete simuluese, lojë tematike...) përdoren për të adresuar temën dhe për të nxitur si vetë-reflektimin ashtu edhe shkëmbimet ndërmjet bashkëmohatarëve. Ato synojnë të marrin në pyetje pjesëmarrësit për perceptimet, besimet dhe praktikatat e tyre, si dhe duke eksperimentuar situata dhe ndjenja të ndryshme (p.sh.: ndjenja e përjashtimit);
- **Praktika në fushë** përfaqëson rreth 40% të orëve të trajnimit dhe përdoret që pjesëmarrësit të përjetojnë lojërat Playdagogy (si një lojtar) si dhe duke praktikuar zbatimin e tyre (si lider) në shkolla;

	<ul style="list-style-type: none"> • Zbatimi në fushë hyn në funksion pas trajnimit fillestar ballë për ballë. PLAY u kërkon pjesëmarrësve të zbatojnë pesë sesione nga doracaku Playdagogy në fushë me fëmijët e shkollave/qendrave të tyre. Puna praktike është pjesë esenciale e trajnimit meqë iu mundëson pjesëmarrësve të përfitojnë aftësi gjatë situatave reale; • Vetë-vlerësimi dhe vlerësimi nga trajnerët i shtynë pjesëmarrësit që të reflektojnë për eksperiencat dhe performancën e tyre dhe i lejon ata të identifikojnë pikët pozitive dhe përcaktuesit për përmirësim. Pas çdo aktiviteti, të dyja palët trajneri dhe pjesëmarrësi plotësojnë një tabelë të vetë-vlerësimit të cilën ata do ta përdorin si bazë të diskutimit. Gjatë trajnimit fillestar ballë për ballë, trajnerët do ta prezantojnë tabelën dhe do të fillojnë zbatimin me grupin e trajnerëve.
Certifikimi	Për pajisje me certifikatë, pjesëmarrësit duhet të zbatojnë së paku 5 aktivitete në shkollat e tyre. Ata do të monitorohen të paktën një herë me vizitë përcjellëse nga trajnerët e PLAY. Trajnerët do të vëzhgojnë dhe mbështesin pjesëmarrësit ndërsa ata zbatojnë njërin nga sesionet socio-sportive të programit. Pas aktivitetit, pjesëmarrësit do të plotësojnë tabelën e vetë-vlerësimit dhe do të diskutojnë me trajnerët të cilët do të ndajnë vëzhgimet e tyre rreth atij sesioni dhe të ofrojnë këshilla për përmirësim. Pas çdo vizite pasuese, trajneri do ta plotësojë një tabelë të vlerësimit ku duhet të arrihen së paku 3 nga 4 pikë në kategoritë e formularit vlerësues.
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<ol style="list-style-type: none"> 1. Abide Ujkani 2. Edona Bllaca 3. Elira Hashani
Data e aplikimi	02.05.2024

Titulli i Programit:	PLAYDAGOGY- Diskriminimi në bazë të komunitetit
Titulli i organizatës:	Play International Kosova
Tipi i programit:	Program Plotësues
Ofertuesi i programit:	Play International Kosova
Adresa:	Agim Ramadani 32, 10000 Prishtina Kosova
E-mail:	vlorian.molliqaj@play-international.org
Telefoni:	+38344946091
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Play International Kosova 145/2024 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	145/2024 26.02.2027
Numri dhe data e aprovimit të programit:	58/2024 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	58/2024 26.02.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	17 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e nivelit fillor
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	120
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Mësimdhënësit zgjerojnë njohuritë e tyre në lidhje me praktikat e mira gjithëpërfshirëse; <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënësit përfitojnë njohuri dhe aftësi për të realizuar sesione socio-sportive; • Mësimdhënësit zbulojnë ose rrisin përdorimin e sportit si një mjet edukativ; • Mësimdhënësit forcojnë kapacitetet e tyre bashkëpunuese në mesin e profesionistëve;

	<ul style="list-style-type: none"> Fëmijët marrin pjesë në sesione të rregullta socio-sportive dhe përfitojnë njohuri dhe aftësi rreth rëndësisë së gjithëpërfshirjes në shkollë.
Përmbajtja:	<p>Trajnimi ballë për ballë: Gjatë trajnimit mësimdhënësit do të përfitojnë njohuri për tema të ndryshme në lidhje me ambientin shkollor (diskriminimin dhe përfshirjen e të gjithëve). Mësimdhënësit do ta kenë mundësinë të reflektojnë dhe të ndajnë përvojën e tyre sa i përket këtyre temave. Ata do të pajisen me aftësi për të udhëhequr sesionet socio-sportive, përfshirë aftësitë bazike të animacionit të sportit, menaxhimit grupor, metodologjisë Playdagogy dhe udhëheqjes së debatit. Trajnimet po ashtu do të ofrojnë një mundësi për mësimdhënësit që të krijojnë një rrjet të kolegëve të angazhuar për ndryshim social përmes arsimit. Ata do të jenë në gjendje të takohen me mësimdhënësit nga prejardhje të shumëllojshme dhe shkolla të ndryshme dhe të shkëmbejnë përvojën e tyre të mësimdhënies dhe përdorimin e sportit si një mjet arsimor.</p> <p>Fusha e zbatimit të aktiviteteve sportive: Ndërsa zbatojnë sesionet socio-sportive me fëmijë nga shkollat e tyre, mësimdhënësit do të testojnë dhe përmirësojnë aftësitë e tyre gjatë situatave reale. Ata do të njoftohen edhe më shumë dhe do të ndjehen më rehat me temat e ndryshme të trajtuara gjatë sesioneve sportive. Duke qenë pjesëmarrës në aktivitetet e Playdagogy-së të zbatuara nga mësimdhënësit, fëmijët do të përmirësojnë njohuritë e tyre dhe do t'i vënë në dyshim sjelljet e tyre sa i përket temave në lidhje me rëndësinë e një mjedisi mësimor më paqësor dhe gjithëpërfshirës.</p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Një kombinim i metodologjive të shumëllojshme janë përdorur për këtë program trajnimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> Prezantimet interaktive (sllajde në Power Point, pyetje-përgjigje, pyetësorë, etj.) përdoren për të prezantuar qëllimet dhe temën e trajnimit; Ushtrimet grupore dhe të vetë-reflektimit (debate, lojë-rolesh, aktivitete simuluese, lojë tematike...) përdoren për të adresuar temën dhe për të nxitur si vetë-reflektimin ashtu edhe shkëmbimet ndërmjet bashkëmoshatarëve. Ato synojnë të marrin në pyetje

	<p>pjesëmarrësit për perceptimet, besimet dhe praktikat e tyre, si dhe duke eksperimentuar situata dhe ndjenja të ndryshme (p.sh.: ndjenja e përjashtimit);</p> <ul style="list-style-type: none"> • Praktika në fushë përfaqëson rreth 40% të orëve të trajnimit dhe përdoret që pjesëmarrësit të përjetojnë lojërat Playdagogy (si një lojtar) si dhe duke praktikuar zbatimin e tyre (si lider) në shkollë; • Zbatimi në fushë hyn në funksion pas trajnimit fillestar ballë për ballë. PLAY u kërkon pjesëmarrësve të zbatojnë pesë sesione nga doracaku Playdagogy në fushë me fëmijët e shkollave/qendrave të tyre. Puna praktike është pjesë esenciale e trajnimit meqë iu mundëson pjesëmarrësve të përfitojnë aftësi gjatë situatave reale; • Vetë-vlerësimi dhe vlerësimi nga trajnerët i shtynë pjesëmarrësit që të reflektojnë për eksperiencat dhe performancën e tyre dhe i lejon ata të identifikojnë pikët pozitive dhe përcaktuesit për përmirësim. Pas çdo aktiviteti, të dyja palët trajneri dhe pjesëmarrësi plotësojnë një tabelë të vetë-vlerësimit të cilën ata do ta përdorin si bazë të diskutimit. Gjatë trajnimit fillestar ballë për ballë, trajnerët do ta prezantojnë tabelën dhe do të fillojnë zbatimin me grupin e trajnerëve.
Certifikimi	<p>Për pajisje me certifikatë, pjesëmarrësit duhet të zbatojnë së paku 5 aktivitete në shkollat e tyre. Ata do të monitorohen të paktën një herë me vizitë përcjellëse nga trajnerët e PLAY. Trajnerët do të vëzhgojnë dhe mbështesin pjesëmarrësit ndërsa ata zbatojnë njërin nga sesionet socio-sportive të programit. Pas aktivitetit, pjesëmarrësit do të plotësojnë tabelën e vet-vlerësimit dhe do të diskutojnë me trajnerët të cilët do të ndajnë vëzhgimet e tyre rreth atij sesioni dhe të ofrojnë këshilla për përmirësim. Pas çdo vizite pasuese, trajneri do ta plotësojë një tabelë të vlerësimit ku duhet të arrihen së paku 3 nga 4 pikë në kategoritë e formularit vlerësues.</p>
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<p>3 Trajner</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Abide Ujkani 2. Elira Hashani 3. Edona Bllaca
Data e aplikimi	13.12.2023

Titulli i Programit:	Praktika pedagogjike e bazuar në dëshmi
Titulli i organizatës:	EU KosEd
Tipi i programit:	Program themelor
Ofertuesi i programit:	EU KosEd
Adresa:	MASHTI, Kati IV
E-mail:	Robert.Blease@dai.com
Telefoni:	
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr. 130/2023 Datë: 06.03.2023
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	Nr. 129/2023 Datë: 06.03.2025
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr. 129/2023 Datë: 06.03.2023
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr. 129/2023 Datë: 06.03.2025
Kohëzgjatja e programit(orë)	48 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e Niveleve 1, 2 dhe 3, koordinatorët e cilësisë, drejtorë shkollash, zyrtarë të DKA-ve dhe Inspektorë të arsimit
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Programi ka si rezultate: <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimin e praktikës pedagogjike të mësimdhënësve duhe siguruar dëshmi për punën, reflektim dhe avancim të mësimdhënies; • Harmonizimin e instrumenteve, praktikave dhe qasjeve të vlerësimit të

	<p>nxënësve përmes formave të vlerësimit formativ;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgatitjen dhe zbatimin e materialeve praktike për mësimdhënës duke integruar të menduarit kritik e kreativ në mësimdhënie dhe mësimnxënie; • Zbatimin e qasjes gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese të mësimdhënësve të shkollës lidhur me planifikimin, vlerësimin formativ, punën praktike në klasë dhe vetëvlerësimin e reflektimin për të siguruar cilësi më të lartë të mësimdhënies dhe rezultate të larta të nxënësve.
Përmbajtja:	<p>Programi trajnues është organizur në tetë (8) module:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Moduli 1: Mësimdhënia reaguese • Moduli 2: Informata kthyesë efektive dhe vlerësimi • Moduli 3: Mësimnxënia e individualizuar • Moduli 4: Të nxënët e vetërregulluar • Moduli 5: Përfshirja e mësimit aktiv në praktikën pedagogjike • Moduli 6: Përfshirja e mësimit bashkëpunues në praktikën pedagogjike • Moduli 7: Të nxënët me nxënësin në qendër • Moduli 8: Formësimi aktiv i të nxënët nga nxënësit
Metodat e realizimit të programit	<p>Modulet e programit trajnues sigurojnë informacione bazike lidhur me tetë temat, ndërlidhjen e tyre me kërkesat kurrikulare si dhe mundësitë për zbatim të efektshëm në nivel shkolle e klase. Programi trajnues ofrohet sipas orarit të planifikuar nga shkolla, duke mos ndërhyrë në orarin e mësimit të rregullt.</p> <p>Qasja e përzgjedhur ofron mundësi që të gjithë mësimdhënësit e shkollës të jenë të përfshirë, dhe të gjithë së bashku, nën udhëheqjen e një trajneri/fasilituesi, të diskutojnë dhe provojnë ide e forma të ndryshme të zbatimit të temave në mësimdhënien e tyre.</p> <p>Kjo mënyrë e punës dhe e bashkëpunimit ndërmjet kolegëve të shkollës mundëson shtjellimin e temave të ndryshme profesionale me interes të përbashkët, konsultim jo formal dhe kolegial të mësuesve të nivelit fillor, si dhe mundësi të avancimit profesional të mësimdhënësve përmes aktiviteteve me bazë në shkollë.</p> <p>Gjithashtu, modulet mund të përdoren për të monitoruar dhe për të mbështetur mësimdhënësit tjerë gjatë zbatimit të kurrikulës në klasat/shkollat e tyre.</p>
Certifikimi	<p>Certifikata për pjesëmarrje dhe përfundim me sukses të programit dhe</p>

	kërkesave specifike të tij.
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<p>Programi ka 6 trajnerë kryesorë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Robert Blease 2. Osman Buleshkaj 3. Majlinda Gjellaj 4. Rinor Qehaja 5. Selim Mehmeti 6. Drilon Krasniqi <p>Gjithashtu, programi ofrohet edhe përmes ekipeve komunale të mësimit nëpërmjet qasjes me bazë në shkollë por të koordinuar dhe me mbështetje nga trajnerët kryesorë.</p>
Data e aplikimit	22.02.2023

Titulli i Programit:	Promovimi i qytetarisë globale dhe përgjegjesisë shoqërore përmes mësimdhënies së gjuhës angleze
Titulli i organizatës:	Shoqata Kosovare e Mësimdhënësve të Gjuhës Angleze- KETNET
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	Shoqata Kosovare e Mësimdhënësve të Gjuhës Angleze- KETNET
Adresa:	Rr. Xhorxh Bush, Nr.31-Fakulteti i Filologjisë PRISHTINË, 10000, Kosovë
E-mail:	ketnetinfo@gmail.com
Telefoni:	
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	/
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	/
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr. 130/2024, 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	26.02.2025
Kohëzgjatja e programit(orë)	Programi trajnues ka gjithsej 25 orë: 12 orë mësimi gjatë sesioneve të trajnimit, 3 orë gjatë Panairit të gjuhës dhe 10 orë gjatë realizimit të projekteve në orë të mësimi.
Përfituesit:	Mësimdhënësit e gjuhës angleze të shkollave të mesme të larta.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	15 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Si rezultat i këtij programi, mësimdhënësit do të mund të: <ul style="list-style-type: none"> - integrojnë shkathtësitë e shekullit 21 në mësimdhënien e tyre duke i aftësuar kështu nxënësit e tyre për tregun global ekonomik;

	- promovojnë të drejtat e njeriut gjatë mësimdhënies së tyre.
Përmbajtja:	<p>Programi ka për qëllim trajnimin e mësimdhënësve të gjuhës angleze të promovojnë të drejtat e njeriut, demokracinë, vlerat e qytetarisë globale dhe shkathhtësitë e shekullit 21. Duke trajtuar çështje dhe vlera të ndryshme globale siç janë: barazia dhe drejtësia përmes aktiviteteve të ndryshme leximi, shkrimi, të folurit dhe të dëgjuarit, nxënësit, qytetarë të së ardhmes, zhvillojnë strategji për të komunikuar në mënyrë të efektshme me kultura tjera, përvetësojnë përgjegjësitë e tyre ndaj të tjerëve, zhvillojnë ndjeshmërinë, mënyrën kritike dhe kreative të të menduarit dhe respektojnë vlerat e diversitetit dhe dialogut ndërkulturor.</p> <p>Pjesëmarrësit ndjekin 12 orë mësimi gjatë dy javëve. Atyre u kërkohet të punojnë (rreth 10 orë) me nxënësit e tyre në projekte të vogla lidhur me temat që ofrohen. Në bashkëpunim me nxënësit ata krijojnë një produkt final duke përdorur teknologjinë dhe kreativitetin. Ky produkt prezantohet gjatë javës së tretë të programit në atë që quhet: <u>“Panairi i gjuhës”</u> (rreth 3 orë).</p>
Metodat e realizimit të programit	Gjatë trajnimit do të përdoren metodologji bashkëkohore që nxisin të menduarit kritik të pjesëmarrësve si: metoda e të nxënësve aktiv (active learning), bashkëveprimi e mësimdhënia e diferencuar.
Certifikimi	Mësimdhënësit pajisen me certifikata pas përfundimit të suksesshëm të programit që nënkupton ndjekjen e të gjitha sesioneve, zhvillimin e projekteve me nxënës dhe prezantimin e punës së tyre në Panairin e gjuhës.
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	7 trajnerë: Blerta Mustafa, Zinaide Gruda, Yllkë Paçarizi, Faton Ratkoceri, Miranda Agaj, Rina Krasniqi, Shqipprojë Shala
Data e aplikimi	15.12.2023

Titulli i Programit:	Puna dhe përkrahja profesionale për fëmijët me vështirësi në të nxënë: Metodatat dhe strategjitë e avancuara për zhvillim funksional të nxënësve me nevoja të veçanta
Titulli i organizatës:	Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje – QPGJ - OJQ
Tipi i programit:	Puna dhe përkrahja profesionale për fëmijët me VËSHTIRËSI NË TË NXËNË: Metodatat dhe strategjitë e avancuara për zhvillim funksional të nxënësve me nevoja të veçanta
Ofertuesi i programit:	Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje - QPGJ
Adresa:	Veternik p.n., Prishtina, Kosova
E-mail:	info@qendraprofesionale.org
Telefoni:	+383 49 183 156
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	64/2024 – 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	64/2024 – 26.02.2025
Numri dhe data e aprovimit të programit:	64/2024 – 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	64/2024 – 26.02.2025
Kohëzgjatja e programit(orë)	20 orë
Përfituesit:	Përfituesit e programit përfshijnë një gamë të gjerë mësimeve nga të gjitha nivelet dhe shkollat parauniversitare, duke përfshirë edukatorët, shkolla fillore, të mesme të ulta dhe larta, gjimnaze dhe ato profesionale.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20 deri në 25 mësimeve për grup
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Programi i trajnimit synon të ofrojë rezultate të matshme dhe të qëndrueshme që kontribuojnë në përmirësimin e aftësive dhe njohurive të mësimeve për të trajtuar fëmijët me vështirësi në të nxënë. Këto rezultate lidhen ngushtë me qëllimet e programit dhe fushën prioritarë të përzgjedhur. Në vijim janë përshtatur aktivitetet e programit me rezultatet e pritshme:

	<p>1. Rritja e Njohurive Profesionale mbi vështirësitë në të nxënë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aktivitetet e Programit: Përfshirja në diskutime dhe analizat mbi vështirësitë në të nxënë. • Rezultatet e Pritshme: Pjesëmarrësit do të përfitojnë njohuri të thella rreth etiologjisë dhe karakteristikave të vështirësive në të nxënë, duke përfshirë disleksinë, ADHD-në, disgrafinë dhe problemet e procesimit të ngadaltë të informatave. <p>2. Kuptimi dhe Identifikimi i Metodave dhe Strategjive për zhvillimin e komunikimit :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aktivitetet e Programit: Përdorimi i strategjive të avancuara për zhvillimin e komunikimit dhe identifikimi i metodave efektive. • Rezultatet e Pritshme: Mësimdhënësit do të zhvillojnë aftësi për të identifikuar dhe trajtuar më mirë sfidat dhe karakteristikat e fëmijëve me vështirësi në të nxënë. <p>3. Zbatimi dhe Përshtatja e Metodave në pune me fëmijë me vështirësi në të nxënë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aktivitetet e Programit: Diskutim panel dhe bashkëpunimi me prindërit për zbatimin e metodave të përshtatura. • Rezultatet e Pritshme: Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të zbatueshin dhe përshtatin me sukses metodat e mësuara në praktikën e tyre shkollore, duke i përshtatur sipas nevojave individuale të fëmijëve me vështirësi në të nxënë. <p>4. Mbështetja Sociale dhe Emocionale për fëmijët me vështirësi në të nxënë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aktivitetet e Programit: Përqëndrimi në zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale të fëmijëve me vështirësi në të nxënë. • Rezultatet e Pritshme: Pjesëmarrësit do të zhvillojnë aftësi për të trajtuar sfidat kognitive dhe gjuhësore të fëmijëve, përmirësuar aftësitë e tyre sociale dhe emocionale.
Përmbajtja:	<p>Përmbajtja e programit është strukturuar në mënyrë të gjerë për të përmbushur nevojat e profesionistëve që janë të përfshirë në trajnim. Fillimi i programit ofron një hyrje të detajuar në vështirësitë në të nxënë, duke trajtuar temat si etiologjia, karakteristikat, shkaqet dhe prevalenca, duke arritur deri te roli i prindërve në trajtim. Ky segment siguron një bazë të fortë për njohuritë e pjesëmarrësve.</p>

	<p>Aktivitetet praktike përfshijnë ligjerata, prezantime, diskutime paneli, punë individuale, grupe, analiza rastesh dhe zgjidhje të problemeve. Këto aktivitete inkurajojnë pjesëmarrësit të aplikojnë njohuritë e fituara në situata reale dhe të ndajnë përvojën dhe praktikën e tyre me kolegët.</p> <p>Objektivat e programit synojnë rritjen e njohurive profesionale duke ofruar informacion dhe njohuri të përditësueshme, prezantimin e metodave dhe strategjive të avancuara për zhvillimin funksional të fëmijëve me vështirësi në të nxënë, si dhe inkurajimin dhe aftësimin e profesionistëve për zbatimin e këtyre metodave në praktikë. Bashkëpunimi me prindërit dhe menaxhimi i sjelljeve të papërshtatshme gjithashtu përfshihen si elementë kyç në trajnim, për të siguruar një përmirësim të përgjithshëm të aftësive dhe njohurive të profesionistëve në këtë fushë.</p>
<p>Metodat e realizimit të programit</p>	<p>Metodologjia e përdorur gjatë ofrimit të programit trajnuar është e karakterizuar nga një qasje holistike dhe interaktive, duke kombinuar disa metoda efektive të mësimin.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligjeratat dhe prezantimet do të përdoren për të sjellë një hyrje të detajuar në temat kryesore të trajnimit dhe për të krijuar një kornizë konceptuale për pjesëmarrësit. Diskutimet panele me kolegët kanë shërbyer për prezantimin dhe diskutimin e evidencave empirike mbi sfidat në të nxënë, duke synuar përmirësimin e kuptimit mbi temat komplekse. - Puna në grup do të përdoret me qëllim inkurajimi të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave midis pjesëmarrësve. Ky format ka për qëllim përmirësimin e aftësive të tyre për të aplikuar konceptet teorike në situata reale. - Përdorimi i rasteve studimore do të ndihmojë në paraqitjen e sfidave reale dhe skenarëve të ngjashëm me ato të përditshme në profesionin e tyre, duke synuar forcimin e aftësisë për të zgjidhur probleme specifike. - Aktivitetet e zgjedhjes së problemeve kanë qëllim për të inkurajuar pjesëmarrësit të identifikojnë dhe zgjidhin sfida të caktuara në punën e tyre, duke promovuar një qëndrim proaktiv dhe zgjidhje inovative. <p>Metodologjia e programit është fokusuar në pjesëmarrjen aktive, duke përfshirë shkëmbimin e përvojave, diskutimet interaktive dhe situata praktike për të siguruar një përvojë të pasur dhe të aplikueshme. Për më tepër, qasja multidisiplinore dhe përfshirja e ekspertëve të fushës synon të kontribuoj në një trajnim holistik dhe të përshtatshëm për profesionistët që janë të përfshirë me fëmijë me vështirësi në të</p>

	nxënë.
Certifikimi	Se paku 80% pjesemarrje ne sesionet e planifikuara
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	Dr. Natyra Agani Destani, Dr. Ereblir Kadriu, Arbesa Uka, Genta Jahiu, Blerina Bytyqi, Ilirjana Mehmeti
Data e aplikimi	Dhjetor 2023

Titulli i Programit:	Përdorimi dhe përshtatja e teknologjisë informative për të verbër
Titulli i organizatës:	Qendra Burimore për mësim dhe këshillim "Xheladin Deda"
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Qendra Burimore për mësim dhe këshillim "Xheladin Deda"
Adresa:	Rruga Bill Klinton, nr. 183 Pejë
E-mail:	shvqb.peje@gmail.com
Telefoni:	+383 39 410 355
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	N/A
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	N/A
Numri dhe data e aprovimit të programit:	26.02.2024 Nr. 02/2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	26.02.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	Trajnimi zgjat 18 orë (3 ditë të plota trajnimi)
Përfituesit:	Ky trajnim është i paraparë për mësuesit fillor, mësimdhënësit të teknologjisë informative niveli i mesëm i ultë dhe i mesëm i lartë në institucionet arsimore në Kosovë, në ato institucione që kanë, apo që do të pranojnë të regjistrojnë fëmijë të verbër dhe me dëmtime në të parë.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Trajnimi mbahet me pjesëmarrje direkte në grupe deri në 10 persona.
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Mësimdhënëset që kryejnë këtë trajnim: <ul style="list-style-type: none"> - Punojnë me fëmijë të verbër dhe shfrytëzojnë teknologjinë informative për të verbër - Mësojnë nxënësit e verbër se si të shfrytëzojnë teknologjinë informative për të mësuar dhe për t'u pavarësuar në jetë

	- Përgatitësin kushtet dhe mundësitë që ka shkolla për të lehtësuar mësimdhënien me nxënës të verbër
Përmbajtja:	<p>Programi “Përdorimi dhe përshtatja e teknologjisë informative për të verbër” është i dizajnuar për mësimdhënësit në shkollat e rregullta në Kosovë dhe përbëhet nga këto tema:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Teknologjia për të verbërit, mundësitë dhe përparësitë 2. Llojet e teknologjitë dhe shfrytëzimi i tyre 3. Teknologjia personale 4. Programet akustike 5. Specifikat dhe përdorimi i JAWS 6. Braille display 7. Krijimi i pakos mësimore të teknologjisë informative për nxënës
Metodat e realizimit të programit	<p>Trajnimi mbahet me pjesëmarrje direkte në grupe deri në 10 persona. Trajnimi është interaktiv dhe përmban pjese teorike të prezantimeve dhe demonstrimin praktik individual me pajisje dhe softuerë nga pjesëmarrësit në trajnim. Një pjesë e trajnimit konsiston në materialet që prezantohen dhe demontohen para pjesëmarrësve të trajnimit, duke përfshirë mjete pune, instrumente, metoda të cilat demonstrohen në punën konkrete me fëmijën. Grupet për trajnime krijohen në bazë shkolle ose komune, aty ku ka të regjistruar fëmijë të verbër për herë të parë, krijohet grupi i mësimdhënësve që punojnë direkt me të dhe trajnohen për punë me fëmijë të verbër. Trajnimet mund të bëhen edhe në bashkëpunim me DKA-të për mësuesit në nivel komuna, apo përmes Divizionit për Gjithpërfshirje për grupe të kombinuara të mësuesve që duan të marrin aftësimin bazik në këtë fushë.</p>
Certifikimi	Certifikatë e trajnimit
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	Isuf Ahmetaj, Profesor i teknologjisë Gani Gashi, Profesor
Data e aplikimi	06.12.2023

Titulli i Programit:	Përdorimi i TIK në edukim
Titulli i organizatës:	Qendra e Trajnimeve Albas - Kosovë
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	Qendra e Trajnimeve Albas - Kosovë
Adresa:	Rr."Bekim Femiu", Lakrishtë, Prishtinë
E-mail:	trajtime@albaskosova.com / albas_pr@yahoo.com
Telefoni:	+38344108887 / 045999332
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Numër 135/2024 Datë 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	Numër 135/2024 Datë 26.02.2025
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Numër ___/2024 Datë 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Numër ___/2024 Datë 26.02.2025
Kohëzgjatja e programit(orë)	24 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e arsimit parauniversitar
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	30 mësues
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Në fund të programit të trajnimit mësuesi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përdor teknologjinë në klasë: menaxhon grupet gjatë bashkëveprimit, komunikimit dhe shkëmbimit të materialeve; - strukturon informacionin, kupton, analizon, sintetizon dhe krijon ide të reja duke përdorur mjete teknologjike; - përvetëson mësimin ndërveprues përmes përdorimit të kuizeve, lojërave dhe kartave flash; - menaxhon një klasë virtuale, dërgon detyra dhe ndan materiale të dobishme, duke komunikuar me nxënësit dhe prindërit; - përdor platforma audiovizuale, duke e bërë kërkimin më të lehtë, duke krijuar lista për

	<p>tema të ndryshme, duke ndarë dhe futur video dhe lista për luajtje;</p> <ul style="list-style-type: none"> - motivon nxënësit përmes lojërave digjitale dhe kuizeve online. - zhvillon kompetenca të TIK -ut në lidhje me aplikimin e teknologjisë në mjedise të ndryshme arsimore, në mënyrë që të përmirësojë motivimin e nxënësve; - ndan praktikatat më të mira dhe transferon njohuritë dhe metodat për moshë të ndryshme të nxënësve; - zhvillon mjete (një lojë digjitale, një portofol elektronik, tregime digjitale) në lidhje me mënyrat e aplikimit të teknologjisë në arsim për grupmoshë të ndryshme. - aftësohet të përdorë e-learning; - njeh e zotëron konceptet bazë të të mësuarit digjital; - njeh lloje të ndryshme tools-e të rëndësishme për procesin e mësimit; - aftësohet të hapë një llogari personale për përdorimin e këtyre mjeteve online; - ndërton një material mësues konkret duke përdorur këto mjete online (pyetësorë, materiale informuese, produkte e projekte të ndryshme); - aftësohet të bashkëpunojë me partnerët në projekt përmes mjeteve digjitale etj. - njeh mënyrën e ndërtimit të tekstit digjital dhe dallon përparësitë e tij; - përdor një tekst digjital në procesin e mësimit dhe aftëson teknikisht nxënësit të shkarkojnë një tekst digjital të përdorin tools-e të ndryshme në procesin mësues për të konkretizuar njohuritë. - përshkruan konceptin e mësimit të kombinuar; - zhvillon strategji për të zbatuar mësimit të kombinuar në shkollë; - zhvillon mjete dhe metoda që mund të zbatohen gjatë mësimit të kombinuar; - zhvillon strategji për të ecur drejt një mësimi të kombinuar.
<p>Përmbajtja:</p>	<p>Përdorimi i mjeteve digjitale po kthehet në domosdoshmëri në procesin e përditshëm të mësimit në ditët e sotme. Vitet e fundit, kur përdorimi i mjeteve teknologjike, të tilla si video projektor, smart board, kompjutera, software, internet, tableta është rritur gjithnjë e më shumë, ka lindur nevoja për njohje e përdorim të thelluar edhe të tools-eve, që ndihmojnë t'i përdorim ato. Këto tools, si Prezi, Google Form, Answer Garden, Kahoot, Mentimeter, Sway, Edupuzzle, Padlet, Kizoa, Animoto, Survey , Canva , Micro: bit, Arduino, platforma digjitale Albas e-libër, lehtësojnë procesin e mësimit, e bëjnë më praktik e konkretizues dhe, njëkohësisht, i vijnë në ndihmë shkollës për të realizuar edhe aspekte të tjera të procesit edukativ, si pyetësorë online, informacione mbi gjendjen e shkollës, fokus-grupe të ndryshme, prezantime të ndryshme gjatë aktiviteteve shkollore etj. Fokusi i programit është zhvillimi i aftësive të mësuesit me kompetenca për përdorimin e Web-it për të motivuar nxënësit drejt zotërimit praktik të njohurisë; transferimit të njohurive me anë të metodave dhe zhvillimit të mjeteve të ndryshme në procesin e mësimit (lojë digjitale, portofol elektronik, tregime digjitale) për moshë të ndryshme të nxënësve; i përdorimit të tekstit digjital, i përdorimit të mësimit të kombinuar (blended learning) etj. Trajnimi u mundëson pjesëmarrësve të hartojnë e të zhvillojnë aktivitete dhe teknika konkrete për kontekstin e tyre mësues, në mënyrë që të përmirësojnë motivimin e nxënësve të tyre, për të rritur besimin e pjesëmarrësve në përdorimin e mjeteve të Web 2.0.</p> <p>Rëndësia e programit qëndron në nevojën e madhe që kanë mësuesit për t'u njohur,</p>

	<p>përshtatur dhe përditësuar me zhvillimin e gjithanshëm teknologjik dhe përdorimin e domosdoshëm në mësimdhënie e mësimnxënie si rezultat i zhvillimeve bashkëkohore. Ai krijon mundësi të eksplorimit dhe të vendosjes së këtyre njohurive në praktikë përmes moduleve të tilla si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Moduli: Përdorimi i mjeteve prezantuese Toolseve (digjitale) në procesin e mësimdhënies; 2. Moduli: Të mësuarit digjital (e-learning) dhe rëndësia e tij në mësimdhënie; 3. Moduli: Mësimdhënie e kombinuar (blended learning); 4. Moduli: Përfshirja e metodave të reja të mësimdhënies në mësimin në prezencë dhe online
Metodat e realizimit të programit	<p>Metodologjia e trajnimit mbështetet në metodologjitë bashkëkohore dhe me qasje interaktive, parimet dhe kërkesat e mësimdhënies inovative duke pasur parasysh përfshirjen aktive të pjesëmarrësve, qasjen e integruar, bashkëpunimin, iniciativën dhe rezultatet e të nxëniet me fokus kompetencat dhe rritjen e shkathësisë për përdorimin e TIK-ut në edukim.</p> <p>Disa nga metodat të cilat do të përdoren gjatë programit të trajnimit janë: <i>Leksioni</i> (në power point) dhe <i>materiale ilustruese të prezantuara me metodat audiovizuale, demonstrimi, veprimtari e pavarur individuale, punë me grupe</i> / “punë në çift”, <i>metoda sokratike</i> që përdoret pothuajse në secilën seancë.</p> <p>Çdo modul shoqërohet me detyra të cilat demonstrojnë shkallën e njohurive të marra nga pjesëmarrësit në secilin prej tyre.</p>
Certifikimi	<p>Certifikimi i pjesëmarrësve do të bëhet duke respektuar kriteret në vijim: Pjesëmarrja në trajnim min. 80% dhe realizimi me sukses i detyrave (portfolios) nga pjesëmarrësit, të dhëna nga trajneri/ja 2 ditë pas çdo moduli të zhvilluar (ditë trajnimi).</p>
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<p>Eliot Bytyçi; Eriksen Mersinllari; Aida Lumshi; Brunilda Borici; Dhurata Myrtollari; Nimete Arapi; Jehona Krasniqi Heta; Milinda Uka.</p>
Data e aplikimi	<p>15.12.2023</p>

Titulli i Programit:	Përgatitja dhe përdorimi i materialeve mësimore
Titulli i organizatës:	Instituti Pedagogjik i Kosovës
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	Instituti Pedagogjik i Kosovës
Adresa:	Rr. Lorenc Antoni nr. 38. Prishtinë, 10000
E-mail:	Lirije.Bytyqi@rks-gov.net
Telefoni:	038/212-645
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Instituti Pedagogjik i Kosovës është institucion i pavarur, publik, hulumtues, kërkimor shkencor i themeluar nga MASHT-i. Pozita juridike e IPK është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ Nr. 8/2017, datë 21.07.2017. Funksionet e Institutit Pedagogjik të Kosovës janë: analizat, hulumtimet, trajnimet, krahasimet dhe vlerësimet në fusha të ndryshme të arsimit në Kosovë.
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	/
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr. 23/24 Datë: 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	26.02.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	3 vite
Përfituesit:	Mësimdhënësit e Arsimit Fillor
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim është 20-25.
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Në përfundim të trajnimit secili pjesëmarrës: -Bënë dallimin mes burimeve dhe materialeve mësimore -Reflektton për rëndësinë e materialeve mësimore, -Vlerëson kriteret për përgatitje dhe përdorim të materialeve mësimore, -Përfshinë materialet mësimore në planifikimet mësimore,

	<p>-Përgatit materiale mësimore, -Përdor materialet mësimore gjatë punës me nxënës.</p>
<p>Përmbajtja:</p>	<p>Gjatë tri ditëve sa zgjatë trajnimi, temat kryesore që do të shqyrtohen janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ <u>Burimet dhe materialet mësimore;</u> Në kuadër të kësaj teme do të shqyrtohen: <ul style="list-style-type: none"> - Aspektet konceptuale lidhur me burimet dhe materialet mësimore; - Dallimet mes burimeve dhe materialeve mësimore; - Rëndësia e materialeve mësimore; - Llojet e materialeve mësimore. ❖ <u>Planifikimi i materialeve mësimore</u> Mësimdhënësit do të informohen dhe përgatiten për: <ul style="list-style-type: none"> - Rëndësia e përfshirjes së materialeve mësimore në planifikimet e mësimdhënësve - Kriteret për përzgjedhjen e materialeve mësimore, - Planifikimi i materialeve mësimore. ❖ <u>Përgatitja e materialeve mësimore</u> Mësimdhënësve do t'u ofrohen informacione të nevojshme dhe do të aftësohen për: <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e materialeve mësimore bazuar në kriteret; - Rëndësia e përfshirjes së nxënësve në përgatitjen e materialeve mësimore. <p>Përveç pjesëmarrjes në trajnim, mësimdhënësit angazhohen edhe me punë praktike në shkollë. Mësimdhënësit gjatë periudhës sa zgjat trajnimi, përgatisin planifikime për orë mësimore, përgatisin materiale mësimore në shkollë, përfshijnë nxënësit në përgatitjen e materialeve mësimore. Planifikimi dhe realizimi i këtyre aktiviteteve dokumentohet, përgatitet dosja e cila vlerësohet nga trajnerët e programit.</p> <p>Vlerësimi i dosjes së mësimdhënësve është edhe kriter vlerësimi për certifikim.</p>

Metodat e realizimit të programit	<p>Aktivitetet kryesore në kuadër të programit janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Trajnimi i mësimeve në shkollë, 2. Puna praktike e mësimeve në shkollë, <p>Trajnimi i mësimeve fokusohet në njohuri të përgjithshme për materialet mësimore, planifikimin, përgatitjen dhe përdorimin e tyre gjatë punës me nxënës.</p> <p>Në kuadër të punës praktike në shkollë përgatiten plane për orë mësimore, dokumentohet përgatitja dhe përdorimi i materialeve mësimore të cilat pastaj vlerësohen nga trajnerët e programit.</p>
Certifikimi	<p>Pjesëmarrësit e përfshirë në trajnim do të certifikohen për 60 orë pune. Numri i orëve do të fitohet përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrjes në trajnim (18 orë) - Përgatitjes së planifikimeve mësimore (12 orë), - Përgatitjes së materialeve dhe përdorimit praktik të tyre (20 orë), - Vlerësimit të dosjes me detyrat nga trajnimi (10 orë).
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<p>Për realizimin e trajnimit angazhohen dy trajnerë:</p> <p>Lirije Bytyqi Beqiri Afërdita Hajdari Hoxha</p>
Data e aplikimit	14.12.2023

Titulli i Programit:	PIA- Planifikimi sipas nevojave te nxënësit (nxënës me nevoja te veçanta). Hartimi i planit individual i arsimit
Titulli i organizatës:	Edukimi dhe Menaxhmenti në Kosovë
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	Edukimi dhe Menaxhmenti në Kosovë
Adresa:	Magjistralja Prishtinë- Ferizaj, kilometri 5-të, Cagllavicë 10000 Prishtinë
E-mail:	edumen.rks@gmail.com
Telefoni:	049-653-102
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr.115/2024 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	Nr.115/2024 26.02.2027
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr/115/2024 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr.115/2024 26.02.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	16 orë
Përfituesit:	Mësuesit e fillestar. Ky grupacion mësuesish kanë vështirësi të mëdha në hartimin e Planit Individual të Arsimit (PIA) për arsye të mungesës së përvojës mësimdhënëse, të marrjes së informatave të bollshme në terrenin shkollor, pasi dijet teorikë në universitet, jo gjithnjë janë të mjaftueshme, për të operuar me sukses me nxënës me aftësi dhe nevoja ndryshe dhe për të hartuar një plan individual arsimor në përshtatje me nevojat e tyre.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	15-25 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e	Programi i këtij trajnimi synon, të aftësojë mësime dhënësin për: 1. Mënyrën e hartimit të PIA në përputhje me nevojat e nxënësve

programit:	<ol style="list-style-type: none"> 2. Procesin e monitorimit dhe të rishikimit të tij. 3. Përshtatja e kurrikulës (përmbajtja e individualizuar) të lëndëve mësimore ose të fushave të aktiviteteve 4. Format e vlerësimit të fëmijës
Përmbajtja:	<p>Programi i trajnimit synon të rrënjosë tek mësimitdhënësit rëndësinë që ka trajtimi me një plan individual arsimor i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe të demonstrojë se qëllimi kryesor i PIA-s është që fëmija maksimalisht të përftojë nga procesi mësimor, bazuar në nevojat, mundësitë dhe potencialin e tij/saj. Për të arritur rezultatet e synuara, mësimitdhënësi duhet të përcaktojë, qëllime të qarta dhe të arritshme për fëmijën, bazuar në aftësitë e tij/saj. Mësimitdhënësi aftësohet në këtë trajnim që qëllimet të përcaktojë varësisht nga lënda apo fusha ku fëmija ka nevojë (lexim, shkrim, komunikim, përfshirje në lojëra që socializojnë fëmijët etj.). Trajnimi i demonstroi mësuesit se rezultatet e të nxënësve përkufizohen, si: “Deklarata që përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë një nxënës/se në fund të një klase, shkalle apo niveli”. Mësimitdhënësi në përfundim të trajnimit duhet të jetë i qartë se: Rezultatet e nxënësve duhet të caktohen në bazë të aftësive dhe prirjeve të fëmijës, e jo sipas kërkesave të lëndës në nivel të klasës.</p> <p>Programi ynë i trajnimit, "Hartimi i Planit Individual të Arsimit (PIA)," është hartuar në mënyrë të përpiktë për t'u përafëruar me kompetencat e përshkruara në kornizën strategjike për zhvillimin e mësuesve në Kosovë. Kjo nismë kujdeset për nivelet e ndryshme të karrierës së edukatorëve, mësimitdhënëseve duke siguruar një qasje të synuar për rritjen profesionale.</p> <p>Pikat kryesore të përmbajtjes: Programi thellohet në ndërlëkimet e formulimit të Planit Individual të Arsimit, duke përfshirë teorinë dhe metodologjinë më të fundit pedagogjike. Ai thekson përafërimit të strategjive arsimore me nevojat unike, duke promovuar gjithëpërfshirjen dhe përvojat e personalizuara të të mësuarit.</p> <p>Aktivitetet për arritjen e rezultateve: Punëtoritë dhe rastet studimore: Punëtoritë angazhuar lejojnë mësimitdhënësit të gërmojnë në skenarë të rasteve reale, duke përmirësuar aftësitë e tyre në hartimin e planeve efektive të edukimit individual.</p> <p>Sesionet e të nxënësve në bashkëpunim: Pjesëmarrësit angazhohen në të mësuarit bashkëpunues, duke ndarë praktikatat dhe përvojat më të mira për të pasuruar kuptimin e tyre për nevojat e ndryshme të nxënësve.</p>

	<p>Ligjërata të ekspertëve: Ekspertët e njohur ofrojnë njohuri mbi tendencat më të fundit arsimore, duke i udhëhequr mësime të mësimdhënësve në përafrimin e Planeve Individuale të Arsimit me qasjet pedagogjike në zhvillim.</p> <p>Zbatimi praktik: Mësuesit zbatojnë njohuritë e tyre përmes ushtrimeve praktike, duke siguruar një kuptim praktik të hartimit të planeve të personalizuara arsimore. Ky program jo vetëm që i pajis mësime të mësimdhënësve me aftësitë e nevojshme për hartimin e Planeve Individuale të Arsimit, por gjithashtu siguron zhvillimin e vazhdueshëm profesional të tyre në përputhje me kornizën strategjike të Kosovës. Përmes përmbajtjes së synuar dhe aktiviteteve eksperimentale, ne fuqizojmë edukatorët të përmirësojnë rezultatet e nxënësve dhe të kontribuojnë pozitivisht në peizazhin arsimor.</p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Në këtë trajnim do të përdoret si metodologji kryesore, metoda kooperuese dhe ndërvepruese mes trajnuesit dhe mësime të mësimdhënësve, e jetësuar në punën konkrete përmes hartimit të PIA (punë individuale dy orë).</p> <p>Në këtë trajnim do të ishte me interes edhe metoda demonstruese, në rast se do të kishim mundësinë të ndiqnim sesi zbaton PIA në klasë një mësime të mësimdhënësve që është trajnuar për këtë qëllim. Gjithsesi me rëndësi do të ishte edhe të dëgjohej mendimi dhe të shikohej nga ana e trajnerit sesi është hartuar konkretisht një PIA, për nxënësve në nevojë.</p>
Certifikimi	
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	4 Nriçim Mehmeti, Hatixhe Zogaj, Saranda Shatri, Armen Mustafa
Data e aplikimi	17.05.2024

Titulli i Programit	Përgatitja e edukatorëve për përkrahjen dhe zhvillimin e potencialit të fëmijëve përmes lojës dhe kreativitetit
Titulli i organizatës	INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
Tipi i programit:	Program themelor
Adresa:	Lorenc Anton nr. 38 - Pejton, Prishtinë
E-mail:	mevlude.aliu@rks-gov.net & zehrie.plakolli@rks-gov.net
Telefoni:	038212626 & 044413593 038213834 & 044162429
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr. 28/2024 Data: 26.02.2024
Data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Data: 26.02.2027
Kohëzgjatja e programit (orë)	58 orë
Përfituesit:	Eduktorët e Institucioneve Parashkollore nga komuna të ndryshme të Kosovës
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25 pjesëmarrës për një grup trajnimi

<p>Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:</p>	<p>Trajnimi ka për qëllim zhvillimin e kapaciteteve të edukatorëve për punë cilësore dhe kreative me fëmijë parashkollor, bazuar në teori dhe praktika të avancuara për zhvillimin e potencialit të fëmijëve parashkollor përmes lojës dhe kreativitetit.</p> <p>Rezultatet që pritën nga programi i trajnimit. Në përfundim të programit të trajnimit edukatorët pjesëmarrëse në trajnim do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojnë konstruktin shumëdimensional të lojës për zhvillimin e potencialit të fëmijëve; • Zhvillojnë plane mësimore që përfshijnë lojërat për t'i ndihmuar fëmijët që të jenë të suksesshëm në rutina; • Praktikojnë mësimin përmes lojës, kreativitetit dhe didaktikës; • Identifikojnë komponentë të mjedisit mësimor që i ndihmon fëmijët të ndihen të sigurt, të rehatshëm, të mirë pritur dhe të gatshëm për të mësuar dhe eksploruar; • Demonstrojnë strategjitë ndryshme për krijimin e një mjedisi pozitiv;
--	--

Titulli i Programit:	PIA për nxënësit me dëmtim dëgjimi
Titulli i organizatës:	Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim " Nene Tereza" Prizren
Tipi i programit:	Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim " Nene Tereza" Prizren
Ofertuesi i programit:	QBMK "Nënë Tereza" Prizren
Adresa:	Rr. " Hoxhë Tasini" nr.231, 20000, Prizren
E-mail:	1mustafmorina@gmail.com qbmkneneterezapz@gmail.com
Telefoni:	+38344191896
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr.1925 09.01.1951
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	/
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr.92/2024. 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr.92/2024. 26.02.2025.
Kohëzgjatja e programit(orë)	3 vjete
Përfituesit:	Në këtë program trajnimi planifikojmë të përfshijmë kandidatë-mësimdhënës e klaseve gjithëpërfshirëse, mësimdhënëse të cilet në klasat e tyre kanë nxënës me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe të folur, pastaj menaxher, zyrtar te këtyre shkollave, DKA Komunale të 7 regjioneve te Kosovës OJQ etj.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	15-20 kandidat
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Ky projekt do t' u ndihmojë personelit arsimor, paraprofesionistet, kujdestaret dhe profesionistet qe të aplikojn PIA per nxensit me aftesi te kufizuara degjim. PIA- është dokument qëllimi specifik i së cilës i referohet nevojave,

	<p>kërkësive dhe mundësive akceptuese të një nxënësi më paaftësi. PIA është dokument zyrtar pedagogjik i cili hartohet për fëmijët më aftësi të kufizuara arsimore për të cilin ekipi vlerësues dhe mbështetës i fushave të ndryshme zhvillimore ka marr vendim për arsimimin e fëmijës më nevojë të veçanta. Plani individual i arsimit shërben për planifikimin sistematik të edukimit, mësimdhënies, për mbështetjen dhe percjelljen e përparimit individual të fëmijës në mësim.</p>
Përmbajtja:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përgaditja e PIA- fazat e përgaditjes 2. Përpilimi i PIA-së 3. Punë në Grup (plotësimi i PIA-së) 4. Takimi i PIA-së 5. Vlerësimi i trajnimit 6. Demonstrimi i plotësimit të PIA-së 7. Punë praktike si të përgadisim PIA-në 8. Rishikimi dhe vlerësimi i PIA-së 9. Implementimi i PIA-së 10. Punë në grupe
Metodat e realizimit të programit	<p>Ligjërime interaktive (shkrim, shtjellim, demonstrim, ilustrim, konkretizim). Punë në grupe (përkrahje, keshillim, mbështetje). Prezentime (debat, bashkëbisedim, dialogim).</p>

<p>Certifikimi</p>	 <p>CERTIFIKATË</p> <p>Për z./zuj _____, që ka ndjekur trajnimin e organizuar nga QBMK "Nënë Tereza" me temën: "Hartimi dhe zbatimi i Planit Individual Arsimit për nxënësit me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe në të folur" në kohëzgjatje 16 orë.</p> <p>Trajnerët:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. _____ 2. _____ <p style="text-align: right;">Avni Rexha zëvendësues i drejtorit të DAP-MASHTI</p>
<p>Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve</p>	<p>3 Trajner:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mustafe Morina 2. Albulena Vejsa 3. Teuta Krasniqi
<p>Data e aplikimi</p>	<p>15.12.2024</p>

Titulli i Programit:	Qasja dhe Mësimdhënia e Diferencuar
Titulli i organizatës:	Edukimi dhe Menaxhmenti në Kosovë
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues *
Ofertuesi i programit:	Edukimi dhe Menaxhmenti në Kosovë
Adresa:	Magjistrallja Prishtinë- Ferizaj, kilometri 5-të, Cagllavicë 10000 Prishtinë
E-mail:	edumen.rks@gmail.com
Telefoni:	049-653-102
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr.115/2024 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	Nr.115/2024 26.02.2027
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr/115/2024 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr.115/2024 26.02.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	32 orë
Përfituesit:	Edukatorët të niveleve: ISCED:01 dhe (ISCED:02); Mësimdhënësit e licencuar me gradat e mësimdhënësit të karrierës, mësimdhënësit të avancuar, mësimdhënësit mentor dhe të mësimdhënësit të merituar; Kordinatorët e cilësise
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	15-30
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Zhvillojnë një të kuptuar më të thellë për parimet e mësimdhënies së diferencuar; <ul style="list-style-type: none"> Planifikojnë qasje të ndryshme në mësimdhënie të nevojshme për arritjen e rezultateve të dëshiruara për nxënësit e ndryshëm;

	<ul style="list-style-type: none"> • Demonstrojnë modifikimin e materialeve dhe detyrave mësimore si dhe përshtatjen e aktiviteteve mësimore nevojave grupore dhe individuale të nxënësve; • Argumentojnë përdorimin e programeve të individualizuara për nxënësit me vështirësi specifike në të nxënë apo për nxënësit e talentuar dhe me dhunti. <p>Zhvillojnë një të kuptuar të ndjeshëm ndaj karakteristikave të nxënësve dhe një qëndrim të shëndoshë ndaj punës së vet dhe ndaj nxënësve të cilëve ju shërbejnë, pavarësisht se sa sfidues ose të zgjuar mund të jenë ata.</p>
<p>Përmbajtja:</p>	<p>Kosova ka zhvilluar një qasje të integruar ndaj edukimit të fëmijëve me nevoja të veçanta, në të cilën kombinohen shumë natyrshëm procesi i edukimit, i kujdesit shëndetësor, i arsimimit dhe kujdesit profesional ndaj zhvillimit të tyre.</p> <p>Njëra ndër sfidat me rëndësi në mësimdhënien e sotme është aftësia për t'u përgjigjur në mënyrë pozitive dhe proaktive ndaj dallimeve ndërmjet nxënësve, pra ndaj diversitetit në klasë. Prandaj, përmes kësaj lënde do të adresohen çështjet e përmendura duke vënë theksin në mësimdhënien e diferencuar ose adaptive dhe në planin, përkatësisht programin e individualizuar për ata nxënës të cilët janë në rrezik për të dështuar në shkollimin e tyre. Mësimdhënia e diferencuar përcaktohet si një punë mësimore e cila përshtatet mbi bazën e karakteristikave dhe nevojave individuale të nxënësve. Të dhënat tregojnë se nëse zbatohet si duhet, mësimdhënia e diferencuar mund të ketë ndikim në përmirësimin e rezultateve të të nxënësve.</p> <p>Në programin "Qasja dhe edukimi i diferencuar", përmbajtja është kuruar me kujdes për të mishëruar një qasje dinamike dhe gjithëpërfshirëse ndaj të mësuarit. Kurrikula përfshin një gamë të larmishme materialesh mësimore, duke shfrytëzuar burimet multimediale, studimet e rasteve dhe ushtrimet ndërvepruese për t'iu përgjigjur preferencave të ndryshme mësimore.</p> <p>Përmbajtja është krijuar për të qenë e adaptueshme, duke adresuar nivele të ndryshme të aftësisë dhe duke siguruar që pjesëmarrësit të angazhohen me materialin me një ritëm të favorshëm për të kuptuarit e tyre. Aktivitetet brenda programit janë të strukturuar në mënyrë të menduar për të arritur rezultate specifike të të nxënësve.</p> <p>Metodologji të diferencuara të mësimdhënies, të tilla si projekte grupore bashkëpunuese, detyra të individualizuara dhe simulime praktike, përdoren për të përshtatur stile të ndryshme të të mësuarit. Kjo siguron që pjesëmarrësit jo vetëm të kuptojnë konceptet teorike, por gjithashtu të fitojnë njohuri praktike përmes të mësuarit nga përvoja.</p>

	<p>Qëllimi i këtij programi është t'i aftësojë pjesëmarrësit lidhur me atë që diferencimi mund të zbatohet përmes mënyrës së qasjes në mësimdhënie, përmbajtjes së kurrikulës, metodave të mësimdhënies, modifikimit të materialeve mësimore, organizimit të klasës, grupimit të nxënësve dhe ndërveprimit të mësimdhënësve me nxënësit individualë.</p> <p>Ato do të bëjnë një zhvillim të vazhdueshëm profesional. Mësimdhënësit tashmë në sistem, kanë nevojë për përmirësim të konsiderueshëm të cilësisë, njohurive dhe aftësive të tyre gjatë viteve të ardhshme, veçanërisht në lidhje me kërkesat e kurrikulit të ri dhe të didaktikës dhe metodikën aktuale. Kjo është një fushë në të cilën do të kontribuojmë pa çështjen sfiduese të qëndrueshmërisë</p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Zhvillimi i trajnimit do të udhëhiqet me moton e psikologut të shquar <i>Kurt Levinit</i>: “<i>Se teoria më e mirë është praktika e mirë , se praktika më e mirë është teoria e mirë</i>”. Gjatë trajnimit 40% e kohës do të jetë punë teorike dhe 60 % e kohës pjesëmarrësi do të bëjnë punë praktike. Në trajnim do të përdoren metodologjitë e më poshtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënia përmes zgjidhjes së problemeve • Mësimdhënia algoritmike • Mësimdhënie përmes përdorimit të TIK-t <p>Zhvillimi i Mendimit Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit, dhe</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënia autentike • Mësimdhënia kooperative dhe ndërvepruese
Certifikimi	
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	1 Saranda Shatri
Data e aplikimi	17.05.2024

Titulli i Programit:	Realizimi i kompetencave kyçe dhe ato të fushave të Arsimit Fillor, nëpërmjet rikonceptimit të procesit mësimor me në qendër nxënësin
Titulli i organizatës:	Qendra e Trajnimeve Albas - Kosovë
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	Qendra e Trajnimeve Albas - Kosovë
Adresa:	Rr."Bekim Femiu", Lakrishtë, Prishtinë
E-mail:	trajnime@albaskosova.com / albas_pr@yahoo.com
Telefoni:	+38344108887 / 045999332
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Numër 135/2024 Datë 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	Numër 135/2024 Datë 26.02.2025
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Numër 12/2024 Datë 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Numër 12/2024 Datë 26.02.2025
Kohëzgjatja e programit(orë)	24 orë
Përfituesit:	Ky program trajnon të gjithë mësimdhënësit e klasave arsimit fillor të të gjitha fushave, gjithashtu edhe studentëve, të cilët janë duke u përgatitur si mësimdhënës të ardhshëm.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	30 mësues
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Mësuesit me përvojë: - shtojnë larmishmërinë e metodave dhe teknikave bashkëkohore me në qendër nxënësin; - zvogëlojnë problematikat që dalin gjatë orës së mësimit nga nxënësit e pa interes, që nuk aktivizohen dhe kanë mangësi të mbartura apo të krijuara gjatë klasave në AF; - shtojnë objektivitetin e vlerësimit duke kombinuar vlerësimin për procesin e të nxënit me rezultatet e arritura;

	<ul style="list-style-type: none"> - reflektojnë për ecurinë e secilit nxënës në përfundim të tematikës/tematikave duke nxjerrë në pah arritjet apo dështimin dhe duke nxjerrë shkaqet për çdo rast; - nxiten për të luajtur rol në komunikimin me partnerët (kolegë e prindër) për të rritur ndikimin e përbashkët për rritjen e cilësisë në formimin e çdo nxënësi, sipas specifikave të tij. <p>Mësuesit e rinj dhe me më pak përvojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - qartësohen dhe demonstrojnë lidhjen ndërmjet përbërësve kryesorë të një procesi bashkëkohor me në qendër nxënësin; - kuptojnë e vlerësojnë problematikat e shfaqura nga nxënës të veçantë, të cilat lidhen me mospërfshirjen aktive të tyre në procesin e nxënies; - kuptojnë rëndësinë dhe rrisin aftësitë e tyre në menaxhimin e klasës; - aktivizohen në bashkëbisedimin profesional me kolegët dhe personelin mësimor e drejtues të shkollës, si dhe motivohen për zhvillimin e tyre individual profesional, kërkimin e burimeve për zgjerimin e informacioneve të larmishme, metodave për mësimdhënie e nxënie aktive; - u nxitet vetëbesimi dhe përgjegjshmëria profesionale për të qenë të suksesshëm në karrierën e tyre profesionale.
Përmbajtja:	<p>Programi i trajnimit synon të vendosë lidhje mes zotërimit të kompetencës kyçe dhe kompetencave lëndore duke krijuar një lidhje mes disa proceseve komplekse të mësimdhënies në arsimin fillor që nis me planifikimin e kurrikulës dhe metodave mësimore efikase për realizimin e tyre; vëzhgimin e kujdesshëm të mënyrës si mësojnë nxënësit dhe përshtatjes së metodologjisë së mësuesit në këtë kontekst; përcaktimi i rezultateve të të nxënësve dhe vlerësimi i tyre; reflektimi mbi realizimin me sukses të procesit mësimor.</p> <p>Programi është hartuar duke synuar përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në arsimin fillor duke u përshtatur në aspektin praktik me nevojat e nxënësve. Ai karakterizohet nga trajtime konkrete bazuar në: efektin e strategjive dhe teknikave të qarta mësimore gjatë punës didaktike me nxënësit; formimin e të kuptuarit shkencor përmes ideve dhe përvojave personale të nxënësi; zhvillimin e kompetencave të nxënësve që shfaqen vetëm në situata reale të cilat kërkojnë njohuri dhe aftësi të qëndrueshme të mësuesit, si dhe lidhje ndër-lëndore duke ndërthurur kompetencat kyçe me rezultatet e të nxënësve.</p> <p>Programi i trajnimit përbëhet nga 4 module të cilat konsistojnë në:</p> <p>1.Moduli: <i>Ndërlidhja e kompetencave kyçe me rezultatet e të nxënësve në fushat “Gjuhë dhe komunikim”, “Matematikë”, “Shkencat e natyrës”, “Shoqëria dhe mjedisi”, “Teknologjia dhe informacioni”;</i></p> <p>2. Moduli: <i>Rëndësia e përdorimit të teknologjisë në mësimdhënien AF.</i></p> <p>3.Moduli <i>Puna praktike dhe situata konkrete në realizimin e kurrikulës në Arsimin Fillor</i></p> <p>4.Moduli: <i>Ndërtimi i aftësive të të lexuarit</i></p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Metodologjia e trajnimit mbështetet në metodologjitë bashkëkohore dhe me qasje interaktive, parimet dhe kërkesat e mësimdhënies inovative duke pasur parasysh përfshirjen aktive të pjesëmarrësve, qasjen e integruar, bashkëpunimin, iniciativën dhe rezultatet e të</p>

	<p>nxënit me fokus kompetencat dhe rritjen e shkathtësive për mësimdhënie efikase.</p> <p>Disa nga metodat të cilat do të përdoren gjatë programit të trajnimit janë: <i>Leksioni (në power point) dhe materiale ilustruese të prezantuara, metodat audiovizuale, demonstrimi, veprimtari e pavarur individuale, punë me grupe</i> / “punë në çift”, metoda sokratike që përdoret pothuajse në secilën seancë. Seancat praktike të grupeve përmbajnë metodologji të përqendruar te nxënësit, në mënyrë që mësimdhënësit të familjarizohen me metodat edhe nga këndvështrimi i nxënësit.</p>
Certifikimi	<p>Certifikimi i pjesëmarrësve do të bëhet duke respektuar kriteret në vijim: Pjesëmarrja në trajnim min. 80% dhe realizimi me sukses i detyrave (portfolios) nga pjesëmarrësit, të dhëna nga trajneri/ja 2 ditë pas çdo moduli të zhvilluar (ditë trajnimi).</p>
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<p>Florinda Tarusha; Albërie Rraci Sejdiu; Yllka Behluli; Nexhmije Allkja; Njomza Emini; Albesë Kryeziu; Arbnesha Polloshka Shehu.</p>
Data e aplikimit	<p>15.12.2023</p>

Titulli i Programit:	Rinia në punë
Titulli i organizatës:	Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
Adresa:	Rr. "Qëndresa", nr.48, Matiçan, Prishtinë
E-mail:	office@kec-ks.org
Telefoni:	038/244-257, lok. 109
Numrat dhe data e akreditimit:	Nr. 108/2024 Data: 26.02.2024
Kohëzgjatja e programit(orë)	Programi i trajnimit është tre-ditor i përbërë nga gjithsej 12 sesione. Secili sesion zgjatë 90 minuta dhe fokusohet në gjashtë temat kryesore të modulit 'siguria në punë', duke shfrytëzuar materialet e këtij programi (power point, fletat e punës, etj.).
Përfituesit:	Grupi i synuar i programit të trajnimit janë kryesisht mësime të fushës 'Jeta dhe puna' dhe 'Shoqëria dhe mjedisi', por nuk përjashtohen as mësime të fushave të tjera mësimore, të cilët janë të angazhuar në shkallë 4 dhe 5 të kurrikulës.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20-25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Në përfundim të trajnimit pritet nga pjesëmarrësit që të: <ul style="list-style-type: none"> • Kuptojnë se të gjithë punëtorët mund të lëndohen, sëmuren ose të humbin jetën në punë; • Kuptojnë se lëndimet dhe sëmundjet që lidhen me punën janë të parashikueshme dhe mund të parandalohen; • Identifikojnë rreziqet në punë dhe parashikojnë efektin e tyre të mundshëm në një vend pune; • Përshkruajnë mënyrat më të mira për t'i adresuar rreziqet në vendin e punës; • Identifikojnë urgjencat në punë dhe zgjedhin mënyrat më të mira për t'i adresuar ato; • Jenë të vetëdijshëm për të drejtat dhe përgjegjësitë e punëdhënësve dhe

	<p>punëtorëve sa i përket sigurisë dhe shëndetit në punë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjejnë burime të informacioneve për sigurinë dhe shëndetin në punë; • Demonstrjnë forma të komunikimit efektiv me të tjerët për zgjidhjen e problemeve të sigurisë dhe shëndetit në punë – përfshirë komunikimin me njerëzit me autoritet dhe punëdhënësit e tyre.
Përmbajtja:	<p>Kurrikuli RINIA NË PUNË – Diskutim mbi sigurinë, përfshinë planet e detajuara për gjashtë njësi mësimore themelore dhe katër njësi plotësuese. Temat kryesore që duhet të mbulohen në njësitë mësimore përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lëndimet e punëtorit të ri • Identifikimi rreziqeve • Përmirësimi i sigurisë në punë • Emergjencat në punë • Të drejtat dhe përgjegjësitë e punëtorëve • Ndërmarrja e veprimit parandalues dhe reaguese
Metodat e realizimit të programit:	<p>Trajnimi 3-ditor ka gjithsej 12 sesione. Do të ketë sesione plenare dhe punë në grupe, varësisht nga aktivitetet. Përveç kësaj, në mes të ditës dytë dhe tretë janë 3-4 javë që pjesëmarrësit t’i realizojnë njësitë mësimore me nxënës në shkollë. Pasi t’i kenë përzgjedhur njësitë mësimore nga moduli ‘siguria në punë’ (këtë do ta vendosin në sesionin e fundit të ditës së dytë të trajnimit), kandidatët do të realizojnë me nxënës në shkollë së paku tri nga dhjetë njësitë mësimore nga programi ‘rinia në punë’, varësisht nga lënda që e mbajnë apo preferenca e tyre për aktivitete jashtë-kurrikulare. Është e preferueshme që ata t’i zbatojnë të gjitha mësimet e programit me nxënës, nëse për këtë e gjejnë hapësirën kohore në programin shkollor. Nëse kanë interesim, ata mund të realizojnë edhe aktivitete ekipore, ku mund të integrohen çështje nga fusha të ndryshme mësimore të ndërlidhura me punën e fëmijëve. Gjatë tërë kësaj periudhe pjesëmarrësit do të mbledhin evidenca siç janë, planet dhe analizat për aktivitetet e realizuara me nxënës, fleta pune, foto të aktiviteteve, etj., për ta kompletuar dosjen e tyre si mësimdhënës.</p> <p>Materialet e punës janë fleksibile dhe mësimdhënësit mund t’i përshtatin ato për nivelin, respektivisht shkallën kurrikulare kur zhvillohet moduli, si dhe për fushën kurrikulare në kuadër të së cilës zhvillohet moduli. Mësimdhënësit po ashtu mund të zgjedhin shembuj dhe skenarë të tjerë të vendeve të punës që mund të jenë tipik për komunitetin ku vepron shkolla dhe për nevojat e nxënësve me të cilët zhvillohet ky modul.</p> <p>Gjatë periudhës së realizimit të aktiviteteve, kandidatët do të mbështeten dhe</p>


	mentorohen nga trajnerët e kursit. Evidencat / portfoliot për realizimin e aktiviteteve do të dorëzohen një javë para ditës së tretë, për vlerësim dhe plotësime eventuale. Pastaj ato do të prezantohen në ditën e tretë të trajnimit, dhe do të diskutohen me pjesëmarrësit e tjerë.
Certifikimi:	<p>Për t'u certifikuar si trajnerë për programin 'Rinia në punë', në fund të punëtorisë tre ditore do të realizohet vlerësimi i kandidatëve. Trajnerët do të certifikohen duke u kredituar me gjithsej me 32 orë pedagogjike, varësisht se si bëhet kalkulimi, me orë të plotë 60 minutëshe, apo me orë pedagogjike 45 minutëshe.</p> <p>Kalkulimi i pikëve për licencim: 32 orë = 8 orë pedagogjike x 3 ditë trajnimi + 4 orë pedagogjike për zbatim të njësive në shkollë + 4 orë pedagogjike për reflektim dhe diskutim të dokumenteve / çështjeve.</p>
Trajnerë:	17 trajnerë
Data e aplikimit	15.12.2023

Titulli i Programit:	Sistemet e Menaxhimit të Mësimit (SMM)
Titulli i organizatës:	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GMBH
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	GIZ, Zyra në Kosovë
Adresa:	Rr. Arkitekt Karl Gega nr. 38 10000 Prishtinë
E-mail:	giz-kosovo-buero@giz.de
Telefoni:	+383 38 233 002 100
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr. 134/2024 16.01.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr. 134/2024 16.01.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	30.00 ore
Përfituesit:	Mësimdhënësit dhe trajnerë e AAP-së
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20 persona
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Disa nga rezultatet e pritshme: <ul style="list-style-type: none"> - Te përshkruaj teorinë dhe konceptet përkatëse pedagogjike në lidhje me mësimin elektronikë - Krahasojnë skenarë, formate, mjete dhe aplikime të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënies digjitale

	<ul style="list-style-type: none"> - Te hartojnë e – koncepte didaktike për mësimdhënien dhe te nxënit me media digjitale - Te planifikojnë, zhvillojnë dhe vlerësojnë veprimtaritë mësimore me media digjitale - Te njohin bazat e përdorimit të mediave digjitale - Te përdorin mjete digjitale të mësimit dhe komunikimit - Te zhvillojnë materiale mësimore digjitale për të komunikuar me nxënësit online
Përmbajtja:	<p>Modulet e trajnimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Bazat në e-mësim 2. Metodatat digjitale dhe e-didaktike 3. Veglat e mediave digjitale 4. Komunikimi online 5. Krijimi i materialeve me media digjitale 6. Te mësuarit digjital dhe mediat sociale në arsim
Metodat e realizimit të programit	Trajnimet duhet të mbahen në forme fizike në sallat e trajnimit të pajisura me kompjuter dhe internet. Trajnimi implementohet me prezantime ushtrime dhe diskutime të hapura rreth temave. Një pjesë e trajnimeve dhe ushtrimeve po ashtu realizohet në online dhe trajnimin e vet-mësuar.
Certifikimi	Certifikim
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	Jürgen Kosemund Jan Naumann Melanie Schall Vivian Harberts Driton Berisha
Data e aplikimi	23.11.2023

Titulli i Programit:	Shkolla për te gjithë -II- Gjithë përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe te folur
Titulli i organizatës:	Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim " Nene Tereza" Prizren
Tipi i programit:	Trajnime për mësimdhënës fillestar, mësimdhënës i karrierës, mësimdhënës i avancuar, mësimdhënës mentor, mësimdhënës i merituar, edukator, DKA, OJQ
Ofertuesi i programit:	QBMK "Nënë Tereza" Prizren
Adresa:	Rr. " Hoxhë Tasini" nr.231, 20000, Prizren
E-mail:	
Telefoni:	+38344191896
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr.1925 09.01.1951
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	/
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr.92/2024. 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr.92/2024. 26.02.2027.
Kohëzgjatja e programit(orë)	Tri (3) vjete
Përfituesit:	Në këtë program trajnimi planifikojmë të përfshijmë kandidatë: mësimdhënës e klasave gjithëpërfshirëse, mësimdhënës të cilët në klasat e tyre kanë nxënës me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe të folur, pastaj menaxher, zyrtar te këtyre shkollave, DKA Komunale të 7 regjioneve te Kosovës OJQ etj.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	15-20 kandidat

Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Ky projekt do t' u ndihmojë personelit arsimor i cili punon më nxënësit më aftësi të kufizuara dëgjimi, që nxënësve më aftësis së kufizuar t'iu qasen në menyre profesionale, me çka do të ngritet cilësia në mësidhenje dhe arritshmëria e nxënësve në procesin arsimor dhe edukativ,</p> <p>Projekti është fokusuar në ngrit e niveli te performancës të personelit arsimor në aspektin e mësimdhënies për nxënësve më aftësi të kufizuar dëgjimi,</p> <p>Ngritja e kapaciteteve pranuese për nxënësve me aftësi të kufizuar dëgjimi ne shkollat inkluzive.</p>
Përmbajtja:	<ul style="list-style-type: none"> * Qasja arsimore ndaj nxenseve me aftësi të kufizuara dëgjim *Mësimdhënia inkluzive në klasat inkluzive *Strategjit e edukimit inkluzive *Strategjitë lehtësuese për qasjës në arsimimin inkluzive *Mësimdhënia produktive për fëmijët me aftësi të kufizuara dëgjimi *Shkaqet e shurdhërimit-ETIOLOGJIA-Dëmtimi i mekanizmit të dëgjimit *Fëmijët me dëmtim dëgjimi *Qasja metodike për fëmijët me aftësi të kufizuara dëgjimi. *Fëmijët me aftësi të kufizuara dëgjimi-zhvillimi gjuhësor dhe kognitiv. *Shurdhësia dhe gjysëm shurdhësia *Deprivimi shqisor-dëgjimit, reflektimi në zhvillimin arsimor-edukativ, *Klasifikimi i dëmtimit të dëgjimit-qasja arsimore *Efektet e dëmtimit të dëgjimit në avansimin, zhvillimin e gjuhës dhe nivelit arsimor-edukativ, *Shkalla Flexer-1993-Rosher-1995. *Modelet e arsimimit-edukimit për fëmijët me aftësi të kufizuar dëgjimi dhe të folur-gjysëmshurdhër *Metodat e komunikimit më fëmijët me aftësi të kufizuar dëgjimi dhe të folur, shurdhër dhe gjysem shurdhër, *Strategjitë e qasjës për nxënësit me aftësi të kufizuar dëgjimi dhe të folur shurdhër dhe gjysem shurdhër. *Alfabeti i gjuhës së shenjave

	<p>*Bilingualizmi, *Demonstrimi praktik i teorive të mësimdhënjes për fëmijët me paaftësi dëgjimi dhe në të folur. *Përgaditja e materialeve alternative për nxënësit me aftësi të kufizuara dëgjimi, * Vlerësimi i trajnimit dhe punës së trajnereve nga pjesmarrësit.</p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Ligjërimi interaktiv (skjarime, shtjellim, demonstrim, ilustrim, konkretizim). Pune ne grupe (perkrahje, keshillim, mbeshtetje). Prezentime (debat, bashkebisedim, dialogje).</p>
Certifikimi	
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<p>4 Trajner:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mustafe Morina 2. Albulena Vejsa 3. Shyqerije Bytyqi 4. Sali Nuhiu
Data e aplikimi	15.12.024.

Titulli i Programit:	Të gatshëm për të mësuar
Titulli i organizatës:	Save the Children Kosova
Tipi i programit:	Program plotësues
Ofertuesi i programit:	Save the Children Kosova
Adresa:	Filip Shiroka 27, Prishtinë Kosovë
E-mail:	scik@savethechildren.org
Telefoni:	+383 38 551 691
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	50/2021 30.08.2021
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	
Numri dhe data e aprovimit të programit:	137/2024 16.01.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	16.01.2025
Kohëzgjatja e programit(orë)	Programi i trajnimit është katër-ditor, me gjithsej 5 orë trajnimi për një ditë = 20 orë trajnimi.
Përfituesit:	Edukatoret e nivelit parashkollor dhe parafillor
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pas përfundimit të programit, të trajnimit, pritet që edukatoret të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> - Njohin ndikimin dhe metodologjinë e lojës për të mësuar shkathtësistë bazë për fëmijët e moshës 3-6 vjec; - Të njohin ndikimin e mësimit të bazuar ne lojë; - Të njohin shkathtësitë e shkrim-leximit dhe matematikës në moshën

	<p>e hershme;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të njohin komponentet dhe praktikat e programit të Kujdesit dhe Zhvillimit në Fëmijëri të Hershme; - Zhvillimi i shkathtësive të edukatoreve në fasilitimin dhe ligjërimin e të gjitha aspekteve të pakos së trajnimit dhe përdorimin e metodologjive të ndryshme për të mundur angazhimin aktiv të fëmijëve. <p>Të njohin komponentet e shkathtësive të shkrim-leximit të hershëm të cilat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të folurit dhe të dëgjuarit - T'i kuptojmë shkronjat e shtypit - Mësojmë për librat - Mësojmë alfabetin - Kuptojmë fjalët dhe tingujt <p>Të njohin komponentet e shkathtësive të matematikës së hershme të cilat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Numrat dhe numërimi - Modelet - Renditja dhe klasifikimi - Krahasim dhe matjet - Gjeometria.
Përmbajtja:	<p>Programi i trajnimit për “Të gatshëm për të mësuar” (Ready to Learn) përmban informacione relevante për fushën / tematikën, tema diskutimi, si individuale po ashtu në grup, dhe ushtrime e aktivitete grupore në funksion të përkrahjes së qasjes interaktive përgjatë trajnimit dhe synimeve për gjithëpërfshirje të edukatoreve. Të gjitha këto dimensione, parashikohet që të ndihmojnë dhe përkrahin edukatorët me njohuritë dhe praktikat që i marrin në kuadër të këtij trajnimit, të jenë në gjendje t'i kenë parasysh dhe t'i aplikojnë me fëmijët që vijnë qendrat me bazë në komunitet.</p> <p>Objektivi i përgjithshëm i këtij materiali të trajnimit është të ofrohen trajnime të strukturuar dhe efektive katër-ditore për të pajisur edukatorët me mjete të dobishme dhe efektive për zhvillimin e shkathtësive të shkrim-leximit dhe matematikës së hershme të fëmijëve të vegjël. Si pjesë e qasjes “Të gatshëm për të mësuar”, edukatorët trajnohen se si t'i përdorin materialet e udhëzuesit me kartat e aktiviteteve, me lojra dhe objekte të përditshme (si p.sh. elementet e kuzhinës) për të numëruar dhe klasifikuar</p>

Metodat e realizimit të programit	gjëra. Programi i trajnimit do të ketë qasje të kombinuar dhe përmes metodologjisë sasiore matë qëndrimet dhe perceptimet e edukatoreve lidhur me temën, para fillimit të trajnimit dhe pas përfundimit, ndërsa nga aspekti cilësor (brainstorming – stuhi mendimesh, punë në grupe, aktrimi i lojërave diskutimet nga përmbajtja e trajnimit; ushtrimet dhe rastet studimore e bashkëbisedimet në grupe të vogla lidhur me temën) do të mundësojnë adresimin e përmbajtjeve kryesore që janë pjesë integrale e qëllimit të trajnimit dhe objektivave specifike. Secila ditë e trajnimit zgjat përafërsisht 5 orë. Ditët e trajnimit mund të mbahen të gjitha përnjëherë ose të mbahen gjatë një periudhe brenda një muaji ose më tepër. Rezultatet më të mira zakonisht arrihen kur të katër ditët zbatohen në formë të 4 ditëve të trajnimit. Trajnimet përsëritëse mund të mbahen bazuar në nevojat specifike të vendit. Para- dhe pas-testi është dizajnuar dhe përdoren për të matur perceptimet dhe kompetencat paraprake të edukatoreve, përfshirë dhe shqetësimet e tyre lidhur me metodologjinë e trajnimit, si dhe perceptimet e po të njëjtave aspekte pas trajnimit.
Certifikimi	Certifikatë e pjesëmarrjes
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	1. Adelina Hajrullahu
Data e aplikimi	26.04.2023

Titulli i Programit:	Të mësuarit përmes teknologjisë - përdorimi i programeve aplikative
Titulli i organizatës:	QEHT "KONICA"
Tipi i programit:	Program Plotësues
Ofertuesi i programit:	QEHT "KONICA"
Adresa:	rr. Muharrem Fejza, p.n. Prishtinë
E-mail:	geht.konica@gmail.com
Telefoni:	049 328 528
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr. 141/2024, date 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	26.02.2025
Numri dhe data e aprovimit të programit:	nr. 75/75, datë 10.06.2022
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	10.06.2024
Kohëzgjatja e programit(orë)	32
Përfituesit:	Mësimdhënësit e arsimit parauniversitar
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Në fund të këtij programi mësimdhënësit do të jeni në gjendje të: <ol style="list-style-type: none"> 1. Ta praktikojnë mësimdhënien përmes përdorimit të teknologjisë; 2. Të krijojnë projekte për lëndët mësimore përmes programeve aplikative; 3. Të familjarizohen me metodologjinë dhe zbatimin e TIK në mësimdhënie; 4. Të krijojnë teste dhe mësimet në formë elektronike; 5. T'i zotërojnë shkakthtësitë e komunikimi online.

Përmbajtja:	<p>Programi i trajnimit të mësimdhënësve <i>Të mësuarit përmes teknologjisë – përdorimi i programeve aplikative</i> përbëhet nga 6 module të cilat realizohen në 2 ditë trajnimi. Secili modul, përfshinë edhe detyra dhe këshilla praktike të zbatimit të teknologjisë në mësimdhënie. Moduli i shtatë përfshin pjesën e monitorimit.</p> <p>Dita e parë e trajnimit:</p> <p>Moduli 1: Teknologjia në mësimdhënie; Moduli 2: Mësimi i bazuar në projekte përmes teknologjisë Moduli 3: Mësimi me zgjedhje – përgatitja e projekteve shkollore</p> <p>Dita e dytë e trajnimit:</p> <p>Moduli 4: Puna me aplikacioni dhe krijimi i projekteve; Moduli 5: Të mësuarit përmes teknologjisë dhe mësimi online Moduli 6: Komunikimi online</p> <p>Dita e tretë e trajnimit:</p> <p>Moduli 7: Në këtë modul përfshihet pjesa e monitorimit.</p>
Metodat e realizimit të programit	<ul style="list-style-type: none"> • Ligjërime • Prezantime me Powerpoint • Shembuj praktikë përmes detyrave gjatë trajnimit; • Ushtrime • Aktivitete atraktive • Kombinim i materialeve tekst dhe video.
Certifikimi	PO
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	Ersan Hamdiu
Data e aplikimit	

Titulli i Programit:	Trajnimi i mësimdhënësve për edukim në karrierë
Titulli i organizatës:	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	GIZ, Zyra në Kosovë
Adresa:	Rr. Arkitekt Karl Gega nr. 38 10000 Prishtinë
E-mail:	giz-kosovo-buero@giz.de
Telefoni:	+383 38 233 002 100
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr. 135/2024 16/01/2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr. 135/2024 16.01.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	36.00 orë
Përfituesit:	Mesimdhënësit e shkollave të mesme të ulëta
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Disa nga rezultatet e pritshme nga përfituesit e trajnimit: <ul style="list-style-type: none"> - Të kuptojnë procesit teknikat e edukimit në karrierë se si nxënësit mund të zhvillojnë vetë ndërgjegjësimin e tyre dhe të identifikojnë llojin e punës apo të trajnimit të cilit i përshtaten më së miri. - Të kenë njohuri mbi nevojën që nxënësit të zhvillojnë përgjegjësinë dhe të jenë zot të vendimeve të tyre nëpërmjet proceseve të përdorura në edukimin në karrierë. - Te përmirësojnë njohuritë dhe informatat për të kuptuar tregun e punës, që ti mbështesin nxënësit në mënyrë më efektive në marrjen e vendimit për karrierë.
Përmbajtja:	Programit të trajnimit “Edukimi në karrierë”. është të zhvilluar me mbështetjen e GIZ bazuar në modelin pesë-hapësh të orientimit në karrierë, i cili ndahet në këta hapa në vijim:

	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetë-ndërgjegjësimi 2. Informacioni në lidhje me profesionet 3. Shkolla dhe shtigjet e karrierës 4. Takimet reale 5. Vendimmarrja në karrierë <p>Dhe është ndare ne dy module trajnimi: Moduli 1 : Vetë-ndërgjegjësimi dhe Informacione në lidhje me profesionet Moduli 2: Opsionet e shkollimit dhe karrierës, Takimet Reale dhe Vendimi për zgjedhjen e profesionit</p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Programi i trajnimit organizohet në formë të 2 moduleve, moduli i parë do të jetë 3-ditor - Vetë-ndërgjegjësimi dhe Informacione në lidhje me profesionet, ndërsa moduli i 2-të do të jetë 2-ditor të cilat zhvillohen - Opsionet e shkollimit dhe karrierës, Takimet Reale dhe Vendimi për zgjedhjen e profesionit. Koha në mes të mbajtjes së moduleve duhet të jetë së paku 3-4 javë.</p> <p>Numri i orëve të trajnimit është 36 orë, të cilat janë të organizuara përmes 30 orëve të trajnimit të drejtpërdrejtë dhe 6 orë angazhim për detyra praktike.</p>
Certifikimi	Certifikim
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<ol style="list-style-type: none"> 1. Muhamet Ujkani 2. Mirlinda Bunjaku 3. Hekuran Azemi 4. Edison Kasumaj 5. Shukrije Bytyqi 6. Elidiana Budini 7. Mentor Mani 8. Milazim Avdylaj 9. Blerim Zymberi 10. Jeta Jusufi Xhelili 11. Gentian Jetishi 12. Nehat Duraku 13. Sebahate Reçica Sopjani 14. Visar Gjaka 15. Violeta Hyseni
Data e aplikimit	23.11.2023


Titulli i Programit:	Trajnimi i mësimdhënësve për kompetencë digjitale
Titulli i organizatës:	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GMBH
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	GIZ, Zyra në Kosovë
Adresa:	Rr. Arkitekt Karl Gega nr. 38 10000 Prishtinë
E-mail:	giz-kosovo-buero@giz.de
Telefoni:	+383 38 233 002 100
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr. 136/2024 16/01/2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr. 136/2024 16.01.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	40.00 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e shkollave të mesme të ulëta
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të zotërojnë kompetenca të avancuara në fushën e kompetencës digjitale. Ata do të jenë në gjendje të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara në mënyrë efektive në kontekstin e mësimdhënies dhe të nxënit.</p> <p>Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të përdorin teknologjinë digjitale në mënyrë të përshtatshme për të krijuar, përpunuar dhe prezantuar materiale mësimore të diversifikuara, duke përfshirë tekst, grafika, audio, video dhe teknologji të tjera të përshtatshme për mësimin. Ata do të jenë në gjendje të planifikojnë dhe të zhvillojnë një kurs ose një aktivitet mësimor duke përdorur modele të avancuara si modeli ADDIE (Analizo, Dizajno, Zhvillo, Implemento, Vlerëso).</p> <p>Pjesëmarrësit do të jenë të aftë të identifikojnë dhe të përdorin burime digjitale të</p>

	<p>përshtatshme dhe materiale mësimore në internet. Ata gjithashtu do të jenë në gjendje të krijojnë materiale mësimore të bazuar në tekst, si dhe videove mësimore, duke përdorur mjete dhe softuer të specializuar.</p> <p>Pjesëmarrësit do të mësojnë metodat dhe strategjitë për të fuqizuar nxënësit nëpërmjet mjeteve dhe programet e të mësuarit elektronik</p> <p>Ata do të jenë në gjendje të integrojnë metoda të diversifikuara vlerësimi dhe të aplikojnë procese të vlerësimit efektive për të matur përparimin e nxënësve dhe për të mbështetur rritjen e tyre.</p> <p>Në përgjithësi, pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të krijojnë një mjedis mësimor të avancuar digjital, të përdorin teknologjinë në mënyrë efektive dhe të ofrojnë një përvojë të pasur dhe të përfshirë për nxënësit e tyre, duke i përgatitur ata për të jetuar dhe për të punuar në një botë digjitale të ndryshme.</p>
Përmbajtja:	<p>Moduli 1: Mësimdhënia dhe të nxënit</p> <p>Moduli 2: Burimet Digjitale</p> <p>Moduli 3: Fuqizimi i Nxënësve</p> <p>Moduli 4: Vlerësimi</p> <p>Moduli 5: Angazhimi profesional dhe lehtësimi i kompetencave digjitale të nxënësve</p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Programi i trajnimit organizohet në formë të 5 moduleve ,ku secili moduli do të jetë 1-ditor - Koha në mes të mbajtjes së moduleve duhet të jetë së paku 1 javë.</p> <p>Numri i orëve të trajnimit është 40 orë, të cilat janë të organizuara përmes 27 orëve të trajnimit të drejtpërdrejtë dhe 13 orë angazhim për detyra praktike.</p>
Certifikimi	Certifikim
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<ol style="list-style-type: none"> 1. Durim Balaj 2. Kreshnik Gjoklaj 3. Nora Namani-Musa 4. Ardit Islami 5. Emin Hoxha 6. Ilmi Bunjaku 7. Kosovare Rrahimi 8. Miranda Kryeziu 9. Nuhi Dema 10. Mensur Lohaj 11. Rushit Jeta

	12. Shpetim Kastrati 13. Shqipe Dobra 14. Besart Vllahinja
Data e aplikimit	23.11.2023

Titulli i Programit:	Trajnimi i Avancuar "Shkolla për të gjithë – I - (Gjithë përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe te folur"
Titulli i organizatës:	Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim" Nene Tereza" Prizren
Tipi i programit:	Trajnime për mësimdhënës fillestar, mësimdhënës i karrierës, mësimdhënës i avancuar, mësimdhënës mentor, mësimdhënës i merituar, edukator, DKA, OJQ edukator, DKA, OJQ...
Ofertuesi i programit:	QBMK "Nënë Tereza" Prizren
Adresa:	Rr. " Hoxhë Tasini" nr.231, 20000, Prizren
E-mail:	1mustafmorina@gmail.com qbmknenereterezapz@gmail.com
Telefoni:	+38344-191-896
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr.1925 09.01.1951
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	/
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr.92/2024 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr.92/2024 26.02.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	3 vjete
Përfituesit:	Në këtë program trajnimi planifikojmë të përfshihen kandidatë-mësimdhënësë e klasave gjithëpërfshirëse, (dhomave burimore) klasave të bashkangjitura, mësimdhënësë të cilët në klasat

	<p>e tyre kanë nxënës me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe të folur, menaxheret e shkollave të cilët në shkollë kanë klasa gjithëpërfshirëse, DKA Komunale të 7 regjioneve të Kosovës.</p> <p>“Investimi në filozofin e arsimit inkluziv është investim për një të ardhëmeri më të mirë dhe më prosperuese për fëmijët me aftësi të kufizuar dëgjimi dhe në të folur”.</p> <p>Trejnimi do të organizohet në shtatë regjionet e Kosovës. Ngritja e kapaciteteve në arsimin gjithëpërfshirës</p>
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	15-20 kandidat
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Ky projekt do t’u ndihmojë personelit arsimor i cili punon me nxënësit me aftësi të kufizuara dëgjimi, që nxënësve me aftësisë së kufizuar t’iu qasen në menyre profesionale, me çka do të ngritet cilësia në mësidhenje dhe arritshmëria e nxënësve në procesin arsimor dhe edukativ,</p> <p>Projekti është fokusuar në ngrit e niveli të performancës të personelit arsimor në aspektin e mësimdhënies për nxënësve me aftësi të kufizuar dëgjimi,</p> <p>Ngritja e kapaciteteve pranuese për nxënësve me aftësi të kufizuar dëgjimi në shkollat inkluzive.</p>
Përmbajtja:	<p>1.Histori e shkurtër mbi edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara</p> <p>1.2. Edward Befring, Edukator Norvegjez</p> <p>1.3. Edukimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë</p> <p>1.4.Historiku i shkollimit për të shurdhër</p> <p>a.Politikat e MASHT-it lidhur me arsimin gjithëpërfshirës</p> <p>b.Arsimi gjithëpërfshirës</p> <p>c.Qasja ndaj nx. të shurdhërit</p> <p>4.1. Kultura e të shurdhërve</p> <p>2. Metodatat e komunikimit për personat me dëmtime në të dëgjuar</p> <p>2.1. Faktorët e rëndësishëm</p> <p>3. Gjuha e shenjave kosovare, e njohur edhe si GjShK</p> <p>3. 1. Historia dhe statusi i gjuhës së shenjave</p> <p>4. Strategjitë e përgjithshme të mësimdhënies për nxënësit me</p>

<p>Metodat e realizimit të programit</p>	<p>dëmtime në të dëgjuar</p> <p>5. Strategjitë e përgjithshme</p> <p>Ligjërimi interaktiv (skjarime, shtjellim, demonstrim, ilustrim, konkretizim). Pune ne grupe (perkrahje, keshillim, mbeshtetje). Prezentime (debat, bashkebisedim, dialogje).</p> <p>Rezultatet:</p> <p>Ky projekt do t'u ndihmojë personelit arsimor i cili punonë më nxënësit më aftësi të kufizuara dëgjimi, që nxënësve më aftësis së kufizuar t'iu qasen në menyre profesionale, me çka do të ngritet cilësia dhe arritshmëria e nxënësve në procesin arsimor dhe edukativ.</p> <p>Projekti është fokusuar në ngrit e niveli të performancës të personelit arsimor në aspektin e mësimdhënies për nxënësve më aftësi të kufizuar dëgjimi,</p> <p>Ngritja e kapaciteteve pranuese për nxënësve me aftësi të kufizuar dëgjimi.</p>
<p>Certifikimi</p>	 <p>CERTIFIKATË</p> <p>Për z/znj _____ që ka ndjekur trajnimin e organizuar nga QBMK "Nënë Tereza" me temë: "Shkolla për të gjithë - Gjithëpërfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe në të fjalë" në kohëzgjatje 40 orë.</p> <p>Trajnerët: 1. _____ 2. _____</p> <p>Avni Rexha zëvendësues i drejtorit të DAP-MASHTI</p>
<p>Trajner sa trajner,</p>	<p>3 Trajner:</p>

emrat e trajnerëve	1.Mustafe Morina 2.Albulena Vejsa 3.Sali Nuhiu
Data e aplikimi	15.12.2024.

Titulli i Programit:	Teaching 21st Century Skills in the English Classroom
Titulli i organizatës:	Shoqata Kosovare e Mësimdhënësve të Gjuhës Angleze- KETNET
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	Shoqata Kosovare e Mësimdhënësve të Gjuhës Angleze- KETNET
Adresa:	Rr. Xhorxh Bush, Nr.31-Fakulteti i Filologjisë PRISHTINË, 10000, Kosovë
E-mail:	ketnetinfo@gmail.com
Telefoni:	
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr. 129/2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	/
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr. 129/2024, 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	26.02.2025
Kohëzgjatja e programit(orë)	Në total, programi ka 18 orë trajnimi: 16 orë të trajnimit si dhe 2 orë angazhimi për përmbushjen e detyrave për ditën e dyë të trajnimit.
Përfituesit:	Përfituesit e programit të trajnimit janë mësimdhënësit e gjuhës angleze të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar, në institucione publike dhe private. Po ashtu, përfitues të programit janë edhe mësimdhënësit para shërbimit/mësimdhënës të rinj.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	15 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Përmes metodave bashkëkohore të mësimdhënies, pjesëmarrësit do të njoftohen me strategji dhe aktivitete që i ndihmojnë ata të krijojnë orë mësimore që kanë për qëllim të krijojnë nxënës që janë komunikues efektivë, mendimtarë kritikë dhe kreativë, qytetarë të përgjegjshëm, nxënës të suksesshëm, kontribues produktivë,

	<p>dhe individë të shëndoshë. Më specifikisht, si rezultat i ndjekjes së programit, pjesëmarrësit do të mund të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • aplikojnë strategji të ndryshme të mësimdhënies me nxënësin në qendër në orët e tyre mësimore, për të promovuar shkathtësitë e shekullit 21; • ndihmojnë studentët të mësojnë në mënyrë autonome gjatë orëve mësimore; • akomodojnë stile të ndryshme të mësimnxënies në orët e tyre mësimore; • aplikojnë mësimdhënien e diferencuar (diferencim të përmbajtjes, produktit dhe procesit); • analizojnë dhe identifikojnë strategji të ndryshme që zhvillojnë mendimin kritik dhe kreativ të nxënësve; • adaptojnë tekstet shkollore ashtu që të zhvillojnë të menduarit kritik dhe kreativ të nxënësve; • identifikojnë strategjitë përmes së cilave mund të zhvillojnë kompetencat digjitale të nxënësve të tyre; • vlerësojnë dhe analizojnë mënyrat se si mund të zhvillojnë shkathtësitë komunikuese të nxënësve të tyre duke pasur kujdes të veçantë në mënjanimin e komenteve negative, gjuhës urrejtëse dhe paragjykit; • analizojnë elementet e të menduarit kritik sipas taksonomisë së Bloomit dhe të adaptojnë përmbajtjen e orëve të tyre mësimore që të përfshihen të gjitha nivelet e kësaj taksonomie.
<p>Përmbajtja:</p>	<p>Programi është trajnim dy-ditor me aktivitete të dizajnuara me qëllim të njoftimit të mësimdhënësve me strategji dhe metoda që mund të përdorin për zhvillimin e kompetencave të nxënësve. Temat kyçe të këtij trajnimi janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënia me nxënësin në qendër • Gjithëpërfshirja dhe mësimdhënia e diferencuar • Mësimdhënia kreative • Kompetenca digjitale (Digital citizenship) • Nxitja e të menduarit kritik • Edukimi mediatik (media literacy) • Shkathtësitë prezantuese • Demo: Krijimi i aktiviteteve që promovojnë shkathtësitë e shekullit 21 <p>Në mënyrë që trajnimi të jetë sa më frytdhënës dhe i përshtatshëm për mjedisin e mësimdhënies në Kosovë, gjatë temës së fundit mësimdhënësve u ipet një ekstrakt i librave të gjuhës angleze që përdoren në institucione publike arsimore. Detyra e mësimdhënësve është që të krijojnë aktivitete rreth ekstrakteve nga librat dhe duke i lidhur ato aktivitete me një nga temat e diskutuara gjatë trajnimit. Gjithashtu, si kriter për krijimin e aktiviteteve është që ata të bëjnë ndërlidhjen me kompetencat</p>

	që do të zhvillohen si rezultat i orës mësimore të krijuar nga ta.
Metodat e realizimit të programit	Gjatë trajnimit do të përdoren metodologji bashkëkohore që nxisin të menduarit kritik të pjesëmarrësve si: metoda e të nxënësve aktiv (active learning), bashkëveprimi e mësimdhënia e diferencuar.
Certifikimi	Certifikimi bëhet vetëm për ata mësimdhënës që ndjekin të gjitha orët e trajnimit.
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	7 trajnerë: Blerta Mustafa, Zinaide Gruda, Yllkë Paçarizi, Faton Ratkoceri, Miranda Agaj, Rina Krasniqi, Shqiprojë Shala
Data e aplikimi	15.12.2023

Titulli i Programit:	Trajnimi për orientim dhe mobilitet
Titulli i organizatës:	Qendra Burimore për mësim dhe këshillim “Xheladin Deda”
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Qendra Burimore për mësim dhe këshillim “Xheladin Deda”
Adresa:	Rruga Bill Klinton, nr. 183 Pejë
E-mail:	shvqb.peje@gmail.com
Telefoni:	+383 39 410 355
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	N/A
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	N/A
Numri dhe data e aprovimit të programit:	26.02.2024 Nr. 02/2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	26.02.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	Trajnimi zgjat 6-8 orë (një ditë trajnimi)
Përfituesit:	Ky trajnim është i paraparë për mësimdhënësit e niveleve fillor, mesëm i ultë dhe i mesëm i lartë në institucionet arsimore në Kosovë, në ato institucione që kanë, apo që do të pranojnë të regjistrojnë fëmijë të verbër dhe me dëmtime në të parë. I njëjti mbahet edhe për asistentët e fëmijëve, mësuesit mbështetës, mësuesit në dhomat burimore, prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve që kanë të bëjnë me fëmijën e integruar nga shkolla speciale në një shkollë të rregullt.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Trajnimi mbahet me pjesëmarrje direkte në grupe deri në 20 persona
Rezultatet e pritura	Mësimdhënëset që e kryejnë këtë trajnim:

ose objektivat e programit:	<ul style="list-style-type: none"> - Punojnë me fëmijë të verbër dhe ua mësojnë teknikat e orientimit dhe lëvizshmërisë (mobilitetit) në institucionet e tyre fillore dhe të mesme - Njohin dhe shfrytëzojnë pajisjet dhe mjetet që shërbejnë për orientimin e personave të verbër - Njohin teknikat e orientimit dhe përdorimit të shkopit të bardhë <p>Ndihmojnë stafin e shkollave ku punojnë për punën me personat e verbër dhe përshtatjen e një ambienti të sigurt</p>
Përmbajtja:	<p>“Trajnimi për orientim dhe mobilitet” është i dizajnuar për mësimdhënësit në shkollat e rregullta në Kosovë dhe përbëhet nga këto tema:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Orientimi i personave të verbër dhe përshtatja e ambientit të sigurt në shkollë 2. Orinetimi në hapësirën e brendshme dhe të jashtme 3. Shfrytëzimi i shkopit të bardhë 4. Teknikat e orientimit 5. Mjetet e orientimit dhe shfrytëzimi i tyre
Metodat e realizimit të programit	<p>Trajnimi mbahet me pjesëmarrje direkte në grupe deri në 20 persona. Trajnimi është interaktiv dhe përmban pjese teorike të prezantimeve dhe punën praktike individualisht dhe në grupe që bëhet nga pjesëmarrësit në trajnim. Një pjesë e trajnimit konsiston në materialet që prezantohen dhe demontohen para pjesëmarrësve të trajnimit, duke përfshirë mjete e orientimit, shfrytëzimi i tyre, teknika të cilat demonstrohen në punën konkrete me fëmijën.</p> <p>Grupet për trajnime krijohen në bazë në shkollë, në atë shkollë ku regjistrohet një fëmijë i ri i verbër për herë të parë, krijohet grupi i mësimdhënësve që punojnë direkt me të dhe trajnohen për punë me fëmijë të verbër. Trajnimet mund të bëhen edhe në bashkëpunim me DKA-të për mësuesit në nivel komuna, apo përmes Divizionit për Gjithpërfshirje për grupe të kombinuara të mësuesve që duan të marrin aftësimin bazik në këtë fushë.</p>
Certifikimi	Certifikatë e trajnimit
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	Ahmet Mahmutaj, Profesor i edukatës fizike Arbër Graboci, Profesor i edukatës fizike Mahie Mahmutaj, Mësimdhënëse shkathtësitë për jetën
Data e aplikimi	06.12.2023

Titulli i Programit:	Trajnim për Mësimdhënës në Arsim Gjithëpërfshirës
Titulli i organizatës:	OJQ Autizmi Flet
Tipi i programit:	Program Plotësues
Ofertuesi i programit:	OJQ Autizmi Flet
Adresa:	Rr. Luan Haradinaj 21/8, kati 2, nr. 4, Prishtinë 10000, Kosovë
E-mail:	autizmiflet@hotmail.com
Telefoni:	+383 44 889 498
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	Nr. 31/2024 Dt. 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	Nr. 31/2024 Dt. 26.02.2027
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr. 31/2024 Dt. 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr. 31/2024 Dt. 26.02.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	24 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e shkollave publike të Kosovës ku përfshijnë: mësimdhënës fillestar, mësimdhënës i karrierës, mësimdhënës i avancuar, studentë / praktikantë.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20 pjesëmarrës për një grup të trajnimit
Rezultatet e pritura ose objektivat e	Në kuadër të këtij Programit, synohet të arrihen objektiva të qarta në fushën e arsimit gjithëpërfshirës për të nxitur

<p>programit:</p>	<p>përfshirjen dhe mbështetjen e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe nga komunitetet e cenushme. Objektivat specifike të programit përfshijnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Arsimi Gjithëpërfshirës: Çfarë do të thotë, strategjitë e provuara dhe shembujt <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënësit të kuptojnë dhe përshkruajnë konceptin e arsimit gjithëpërfshirës dhe përfitimet e tij. • Të identifikojnë fëmijët me nevoja të veçanta dhe të kuptojnë përparësitë e arsimit gjithëpërfshirës në klasë. 2. Strategji gjithëpërfshirëse në klasë <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënësit të përdorin metoda të ndryshme mësimore të përshtatura për nxënësit. • Të adaptojnë përmbajtjen kurrikulare për fëmijët me nevoja të veçanta dhe të përdorin Planin Individual të Arsimit (PIA). 3. Aplikimi i modelit universal për të mësuar <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënësit të përdorin metoda të ndryshme që mbështesin nevojat e nxënësve, duke përfshirë mënyra të shumta të përfaqësimit të përmbajtjes dhe përshtatje për fëmijët me nevoja të veçanta. 4. Mbështetja dhe komunikimi <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënësit të ngritin aftësitë komunikative efektive me nxënësit dhe prindërit, si dhe të informojnë prindërit për përparimin e nxënësve përmes takimeve të rregullta.
--------------------------	--

	<p>5. Klima në klasë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të krijojnë një klimë pozitive dhe mbështetëse në klasë që ndihmon në rritjen akademike dhe mirëqenien e nxënësve, veçanërisht atyre me nevoja të veçanta dhe nga komunitetet e cënueshme. <p>6. Ngacmimet në shkolla</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të dallojnë shenjat e ngacmimit, të krijojnë një ambient të sigurtë për nxënësit dhe të punojnë për të parandaluar diskriminimin në shkolla. <p>7. Roli i Asistentëve në klasë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të kuptojnë dhe të mbështesin rolin e asistentëve në klasë, të bashkëpunojnë ngushtë me mësimdhënësit dhe të ndihmojnë në zbatimin e Planit Individual. <p>8. Përmirësimi i diversitetit në klasë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të kuptojnë rëndësinë e diversitetit, të përdorin metodologji të përshtatshme mësimore dhe të krijojnë një kurrikulë që fokusohet në diversitet. <p>9. Zhvillimi profesional</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të motivohen për zhvillim profesional, të ndajnë eksperiencat dhe të përdorin metodologji të ndryshme për të promovuar arsimin gjithëpërfshirës.
<p>Përmbajtja:</p>	<p>Programi i trajnimit për arsim gjithëpërfshirës realizohet në formë të 5 moduleve me kohëzgjatje 3 ditore, ku gjithsej përmban 24 orë. Të gjitha modulet janë krijuar në materiale bazë të cilat ndahen me pjesëmarrës si dhe në PowerPoint prezantime në gjuhën shqipe dhe serbe.</p>

	<p>Programi përmban 5 module për Arsim Gjithëpërfshirës:</p> <p>Moduli 1: Edukimi Inkluziv</p> <p>Moduli 2: Komunikimi me fëmijë dhe Komunikimi me prindër</p> <p>Moduli 3: Klima në klasë dhe mjedisi mësimor</p> <p>Moduli 4: Ngacmimi në shkolla</p> <p>Moduli 5: Roli i asistentëve në klasë</p>
<p>Metodat e realizimit të programit</p>	<p>Programi i trajnimit është strukturuar për të përmbushur objektivat e sipërpërmendura përmes një sërë aktivitetesh praktike dhe teorike, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Punë grupore për të ndihmuar pjesëmarrësit të kuptojnë dhe zbatojnë strategjitë gjithëpërfshirëse në praktikë. • Prezantime dhe diskutime mbi tema relevante për të ofruar një kuptim të thellë të arsimit gjithëpërfshirës dhe metodave të tij. • Shembuj të ilustruar dhe ndarja e eksperiencave për të demonstruar përfitimet praktike të arsimit gjithëpërfshirës. • Video materiale dhe diskutime për të ofruar shembuj konkretë dhe për të inkurajuar diskutime mbi praktikën më të mirë. • Aktivitete të bazuara në lojë për të inkurajuar pjesëmarrje aktive dhe të kuptuarit praktik të koncepteve. • Aktivitete që inkurajojnë pjesëmarrje aktive për të siguruar që të gjithë pjesëmarrësit të jenë të angazhuar dhe të kontribuojnë në diskutimet dhe

	<p>mësimet.</p> <p>Këto aktivitete janë të dizajnuara për të siguruar që pjesëmarrësit të kenë mundësinë të praktikojnë dhe të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë trajnimit, duke arritur kështu objektivat e programit në mënyrë efektive.</p>
Certifikimi	<p>Ky trajnim përmban testin preliminar dhe atë përfundimtar mbi njohuritë e fituara gjatë trajnimit dhe në fund certifikimin.</p> <p>Mësimdhënësi/ja duhet ti plotësojë kriteret e certifikimit si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Të ketë së paku 90% pjesëmarrje në trajnim; 2) Të ketë pjesëmarrje aktive në diskutime në së paku 2 tema të caktuara brenda sesionit; 3) Të japë kontribut në realizimin e aktiviteteve grupore apo individuale; 4) Të përfundojë me sukses 70% të testit përfundimtar.
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<p>Të gjithë trajnerët e përfshirë në program nga Autizmi Flet kanë ndjekur trajnimin për trajnerë për Edukim Gjithëpërfshirës dhe janë certifikuar nga Programi i Edukimit Varianty të organizatës People In Need nga Republika Çeke. Vlen të theksohet se trajnerët e angazhuar kanë përgatitje profesionale dhe përvojë si trajnerë në organizata të ndryshme të shoqërisë civile dhe institucione publike.</p> <p>Në total janë të përfshirë shtatë (7) trajnerë, të cilat janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Violetë Hyseni, 2. Njomza Emini Matoshi 3. Blerinë Hajdini Pajaziti

	<ol style="list-style-type: none">4. Anesa Cuca5. Dhurata Prokshi6. Albesë Kryeziu7. Majlinda Krasniqi
Data e aplikimi	15.12.2023

Titulli i Programit:	Udhëheqja e Institucioneve Arsimore në Kosovë (UIAK)
Titulli i organizatës:	Kosovo Center for International Cooperation (KCIC)
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	Kosovo Center for International Cooperation (KCIC)
Adresa:	Rr. "Martirët e Gjilanit", nr. 17, 60000, Gjilan
E-mail:	trainings.kcic@gmail.com
Telefoni:	048 177 320 apo 044 177 320
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	153/2024 26 shkurt 2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	153/2024 26 shkurt 2025
Numri dhe data e aprovimit të programit:	71/2024 26 shkurt 2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	71/2024 26 shkurt 2025
Kohëzgjatja e programit(orë)	168 orë
Përfituesit:	Të gjithë punëtorët arsimorë
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	15 - 25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pjesëmarrësit që do të ndjekin këtë program trajnues pritet që të i arrijnë rezultatet themelore si në vijim: <ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillojnë të kuptuarit bazik për natyrën e ndryshimit në arsim, 2. Fitojnë dije që do të lehtësojë ngritjen e praktikave të udhëheqjes, 3. Kuptojnë thelbin se çka është edukimi cilësor, 4. Kuptojnë dhe dinë rolin e rëndësishëm të drejtorëve të shkollave, 5. Identifikojnë sfidat e sigurimit të arsimit të cilësisë së lartë për të gjithë fëmijët në Kosovë,

	<ol style="list-style-type: none"> 6. Kuptojnë rolin qendror të mësimdhënies dhe nxënies, 7. Njoftohen me rolin udhëheqës të menaxhimit arsimor për edukim cilësor në shkollë, 8. Fillojnë të identifikojnë dhe kuptojnë sfidat specifike në shkollën e tyre, 9. Udhëheqjen e procesit të kërkimeve duke respektuar ndryshimet e obligueshme, 10. Zbatojnë rregulloret e shkollës në tërësi duke bërë ndërlidhjen e të gjitha grupeve të interesit; 11. Rritja e bashkëpunimit të kujdestarit në komunikime me prindër dhe mënyra e udhëheqjes së takimeve; 12. Identifikimi i sfidave dhe gjetja e zgjidhjeve të përshtatshme për gjithë përfshirje të nxënësve; 13. Aplikimi i formave të plotësimit, mirëmbajtjes dhe ruajtjes së dokumentacionit pedagogjik;
Përmbajtja:	<p>Programi i propozuar Trajnues “Udhëheqja e Institucioneve Arsimore në Kosovë (UIAK)”, përmban shtatë (7) seminarët vijuese:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Arsimi në Kosovë dhe gjithëpërfshirja në arsim – Baza ligjore; 2. Mësimdhënia cilësore dhe mësimnxënia; 3. Përgatitja dhe menaxhimi i projektit; 4. Plani zhvillimor i shkollës; 5. Kujdestaria e klasës dhe aktivet profesionale – Komunikimi dhe bashkëpunimi në shkollë; 6. Udhëheqja dhe menaxhimi i personelit dhe 7. Administrimi i dokumentacionit shkollor dhe organizimi i takimeve. <p>Secili seminar do të zgjasë tri ditë dhe çdo ditë trajnimi vlerësohet me 8 orë angazhim. Në tërësi pra, ky Program Trajnues zgjat 21 ditë të plota respektivisht 168 orë trajnimi.</p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Ky program trajnues është planifikuar të mbahet në salla të përshtatshme të trajnimit, pra me prezencë të përhershme fizike të pjesëmarrësve në trajnim me mundësi të realizimit të ditëve të caktuara në opsionin online, pra përmes platformave elektronike. Temat e zbërthyer në Manualin e Trajnimit, që i bashkëngjitet këtij aplikacioni, sa i përket metodologjisë, bazohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligjërata dhe komente të shkurta gjate diskutimeve – për të nxitur pjesëmarrësit. • Informata kthyesë ose reagimet e pjesëmarrësve – duke u përgjigjur ose duke ofruar sugjerime apo komente sipas nevojës.

	<ul style="list-style-type: none"> • DVD-te, video sekuenca - Pjese te shkurta dhe te zgjedhura mire nga DVD ose video mund ti ilustrojnë qeshjet për diskutim te mëtejme apo prezantime lidhur me studime te rastit për punën e mëtutjeshme te grupit. • Loja e roleve ne grupe - iu mundëson pjesëmarrësve qe ti praktikojnë aftësi dhe ti përjetojnë aktivitetet, duke ofruar përvoja te mira te situatave jetësore reale dhe ti mësojnë konceptet. • Puna grupore, ne çifte, grupe te vogla ose te mëdha - Ilustron çështjen duke iu mundësuar pjesëmarrësve qe ti shërbejnë idetë përvojat dhe pikëpamjet si dhe ta thellojnë kuptimin e tyre te detyrës dhe temës se grupit punues • Seanca plenare - këtu shkëmbehen informatat dhe qëndrimet ne një grup te tere, pjesëmarrësit mund te inkurajohen qe te kontribuojnë duke parashtruar komentet, reagime ose pyetje • Prezantimi i detyrave - individuale dhe grupore; • Përgatitja e dosjes - që është edhe njëri nga kriteret e certifikimit të pjesëmarrësve në trajnim.
Certifikimi	<p>Për të siguruar cilësinë e programit trajnues aplikohen këto kuota të vlerësimit të trajnimit, të cilat duhet të i sigurojë vijuesi i trajnimit, në mënyrë që të konstatohet se me sukses e ka përfunduar këtë Program Trajnimi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vijueshmëria e pjesëmarrësit në trajnim duhet të jetë së paku 90% e ditëve të trajnimit ose shprehur në ditë, së paku 19 ditë nga 21 sa janë në kuadër të Programit Trajnues 2. Angazhimi gjatë punëtorive në trajnim, sipas seminareve 3. Prezantimi i detyrave konkrete/ studime rasti dhe dosja e pjesëmarrësve. Të obligueshme janë: <ul style="list-style-type: none"> • Përgatitja e Planit Zhvillimor të Shkollës (PZhSh) në të cilën punon vijuesi trajnimit • Përgatitja e një Projekt-propozimi bazuar në një problem të identifikuar brenda shkollës ku punon vijuesi i trajnimit • Përgatitja e planit vjetor, dymujor dhe javor për Kujdestarinë e klasës, bazuar në Kornizën Kurrikulare të Kosovës. 4. Dosja e përgatitur mirë, që kontrollohet nga trajneri në ditën e fundit të trajnimit.
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<p>Gjithsej janë shtatë trajnerë, bartës të aktiviteteve trajnuese:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ajet Brajshori

	<ol style="list-style-type: none">2. Zana Zeqiri3. Nehat Duraku4. Faik Sahiti5. Diana Qarkagjija6. Esfere Sherifi dhe7. Drita Curri
Data e aplikimi	26 shkurt 2024 - 26 shkurt 2025

Titulli i Programit:	Vështirësitë në të nxënë - përkufizimi, identifikimi dhe përkrahja arsimore
Titulli i organizatës:	Eko - Protection
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	Eko - Protection
Adresa:	Rr. Isa Kastrati – Prishtinë
E-mail:	arbenzabeli@gmail.com
Telefoni:	049-541-053 - 044-415-558
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	152/2024 Data: 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	152/2024 26.02.2027
Numri dhe data e aprovimit të programit:	88/2024 - 26.02.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	88/2024 – 26.02.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	32 orë.
Përfituesit:	Përfituesit e drejtpërdrejtë: Drejtorët e shkollave, zëvendës drejtorët, pedagogët, psikologët, mësuesit klasorë, mësuesit lëndorë, mësuesit mbështetës, mësuesit e klasave të bashkangjitura si dhe asistentë për nxënës me nevoja të veçanta.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25 - 30 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Nga ky trajnim presim që të identifikojnë terminologjinë dhe konceptet e arsimit gjithëpërfshirës, largimin e paragjyqimeve për nxënës apo personat me nevoja të veçanta arsimore, mësojnë se si ti përkufizojmë, identifikojmë vështirësitë në të nxënë dhe me e rëndësishmja si ti ofrojmë përkrahje dhe përkujdesje nxënësve me

	<p>vështirësi në të nxënë.</p> <p>Trajnimi specifik i argumentit të vështirësive në të nxënë, tejkalimit të vështirësive në mënyrë profesionale me fëmijët me vështirësi në sjellje, zhvillim të vonuar, probleme me shkrim, lexim dhe hiperaktiv.</p> <p>Pjesëmarrësit do të pajisen me njohuri të reja për organizimin dhe planifikimin individual të punës me nxënës me vështirësi në të nxënë, respektimi i individualitetit të secilit nxënës sipas kërkesave të tyre;</p> <p>Nga informatat e fituara nga trajnimi pjesëmarrësit do të informohen se si të menaxhojmë klasën aty ku ka nxënës me nevoja të veçanta arsimore, krijimi i klimës së përshtatshme brenda klasës, respektimi i individualitetit dhe përfshirja në aktivitete të shkollës të secilit pavarësisht vështirësisë së tij/saj.</p> <p>Pjesëmarrësit do të informohen rreth identifikimit, përkufizimit dhe trajnimit arsimor të nxënësve me vështirësi në të nxënë.</p> <p>Ofrimi i informatave specifike për pjesëmarrësit për stilet, strategjitë dhe metodologjitë e përshtatshme për tejkalimin e suksesshëm të situatave të vështira me punën me fëmijë/nxënës me vështirësi në të nxënë.</p>
Përmbajtja:	<p>Hyrje në arsimin gjithëpërfshirës, vështirësitë në të nxënë si: Disleksia, Disgrafia, Diskalkulia, dispraksia dhe ADHD (Çrregullimi i vëmendjes dhe Hiperaktiviteti) dhe për secilën vështirësi në të nxënë kemi përkufizimin, identifikimin dhe ofrimin e mbështetjes për këta nxënës.</p> <p>Programi i trajnimit përfshin 4 ditë trajnimi nga 8 orë: që do të thotë se, çdo pjesëmarrës ka 24 orë trajnim direkt dhe 8 orë punë praktike – pjesëmarrësit që përfundojnë detyrën praktike,</p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Metodologjia e realizimit të programit trajnues do të jetë një gërshetim i punës në grupe dhe individuale, përmes disa veprimtarive, siç janë: <i>studim rasti, strategji reflektimi dhe strategji veprimi.</i></p> <p>Shumicën e aktiviteteve do të kryhen praktikisht gjatë programit trajnues.</p> <p>Ndërsa, në ditën e fundit pjesëmarrësit do të përgatisin një studim rasti duke treguar stilet dhe strategjitë se si t'i trajtojnë vështirësinë në të nxënë, rrugët e parandalimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes për këta nxënës.</p>
Certifikimi	<p>Pjesëmarrësit do të certifikohen sipas vijueshmërisë (mbi 80%) dhe sipas përfundimit të suksesshëm të detyrave.</p>
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	<p>Dott. Mag. Arben Zabeli Mr. Vullnet Ramadani Prof. Nehat Duraku Mr. Vjollca Osmani Mr. Minushe Sefa</p>

	Mr. Hatixhe Zogaj Mr. Fatime Demolli Dr. Bujar Thaçi Dr. Lon Laska Mr. Burim Sylejmani Mr. Verim Sylejmani Mr. Ardita Voca Prof. Mergime Kuçi
Data e aplikimi	14.12.2023

Titulli i Programit:	Vlerësimi përmbledhës i nxënësve: Hartimi i testit
Titulli i organizatës:	Instituti Për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA) – Fakulteti I Edukimit - UP
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	Instituti Për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA) – Fakulteti I Edukimit - UP
Adresa:	Fakulteti i Edukimit Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Rr. Agim Ramadani, nr. 350, 10000 Prishtinë, Kosovë
E-mail:	blerim.saqipi@uni-pr.edu
Telefoni:	+ 383 38 22 92 01
Aprovimi i Organizatës, numri dhe data e aprovimit	/
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të organizatës:	/
Numri dhe data e aprovimit të programit:	Nr. 139/2024 Datë: 16.01.2024
Numri dhe data e skadimit të afatit të aprovimit të programit:	Nr. 139/2024 Datë: 16.01.2027
Kohëzgjatja e programit(orë)	32 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësve të klasave 1-12 të të gjitha fushave, gjithashtu edhe studentëve, të cilët janë duke u përgatitur si mësimdhënës të ardhshëm.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	15-25 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<ul style="list-style-type: none"> • Definojnë vlerësimin përmbledhës dhe rolin e tij; • Dallojnë elementet themelore, llojet dhe format e vlerësimit përmbledhës; • Krahasojnë vlerësimin përmbledhës me vlerësimin formues; • Përdorin procedurat standarde të hartimit të një testi për vlerësim përmbledhës; • Hartojnë teste vlerësuese duke dalluar nivelet sipas Taksonomisë së rishikuar të Blumit; • Ndërtojnë strukturën e testit – tabelën e specifikimeve të testit;

	<ul style="list-style-type: none"> • Shkruajnë lloje të ndryshme të pyetjeve sipas rregullave të përcaktuara; • Realizojnë, për të njëjtën kërkesë/pyetje, kalimin nga një nivel taksonomie në një tjetër; • Matin treguesit kryesorë të pyetjeve në përbërje të një testi përmbledhës; • Bëjnë lidhjen ndërmjet rezultateve mësimore me kompetencat e përcaktuara për shkallë të kurrikulës dhe përcaktojnë metodën e vlerësimit; • Planifikojnë vlerësimin përmbledhës bazuar në RNF dhe RNL të ndërlidhura me kompetencat sipas KK; • Realizojnë një vlerësim të drejtë, të saktë dhe të besueshëm, transparent dhe të paanshëm; • Zbatojnë vlerësimin përmbledhës si mjet për motivimin e nxënësve për të arritur kompetencat e synuara; • Përdorin rezultatet e vlerësimit për të marrë vendime për nxënësit, metodologjinë e mësimdhënies dhe kurrikulën; • Raportojnë vlerësimin përmbledhës para nxënësve, prindërve dhe të akterë ve të tjerë;
Përmbajtja:	<p>Llojet e vlerësimeve të nxënësve dhe roli i vlerësimit përmbledhës në procesin e mësimdhënies. – Format dhe parimet e vlerësimit. Aspektet e përgjithshme kulturore dhe gjuhësore të përmbajtjes.</p> <p>Zhvillimi i testit dhe lidhja e pyetjeve/kërkesave me rezultatet e të nxënësve për fushë dhe kompetenca për shkallë. - Tabela e testit, procedurat standarde të hartimit të një testi, pikëzimi dhe kthimi i pikëve në notë. Hartimi i pyetjeve sipas Taksonomisë së Blumit për nivelet e dijes, përmirësimi i pyetjeve, përmbajtja e testit. Llojet e pyetjeve, udhëzime të të shkruarit të pyetjeve, pyetjet me plotësim, pyetjet me alternativë, pyetjet me shoqërim, pyetjet me prezantim grafik, pyetjet me përgjigje të strukturuar, rregullat e shkrimit të tyre. Problemet, struktura e zgjidhjes së tyre. Hartimi i pyetjeve/kërkesave dhe lidhja e tyre me rezultatet e të nxënësve për fushë dhe kompetencën për shkallë.</p> <p>Analiza e testit/pyetjeve. - Analiza e pyetjeve, vështirësia e pyetjes, diskriminimi i pyetjes, shpeshësia e alternativës.</p>
Metodat e realizimit të programit	<p>Mësimdhënie interaktive</p> <p>Punë grupe</p> <p>Punë praktike e bazuar në kontekst</p> <p>Qasja e punës do të jetë e bazuar në ngritjen e debateve.</p>
Certifikimi	Po.
Trajner sa trajner, emrat e trajnerëve	10 trajner

Naser Zabeli Arlinda Bytyqi - Damoni Majlinda Zhitija - Gjellaj Vjollca Ahmedi Hatixhe Ismaili Fatbardha Zogaj-Rekaj Shpetim Kastrati Dijana Qarkagjija Fadil Latifi Edi Puka
--

Titulli i Programit:	Vlerësimi i nxënësve sipas kurrikulës bazuar në kompetenca
Titulli i organizatës:	QEHT "KONICA"
Tipi i programit:	Program THEMELOR
Ofertuesi i programit:	QEHT "KONICA"
Adresa:	rr. Muharrem Fejza, p.n. Prishtinë
E-mail:	qeht.konica@gmail.com
